



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE TË SHA “PORTI DETAR”
SARANDË**



**RAPORT I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË NË
PORTIN DETAR SHA SARANDË.**

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	HYRJA	
	a. Objektivat dhe qëllimi.....	2
	b. Identifikimi i çështjes.....	2
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	2
	d. Përgjegjësitë e audituesve.	2
	e. Kriteret e vlerësimit.	3
	f. Standardet e auditimit.	3
II.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT	4
III.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	5
	Pika 1 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”.	5
	Pika 2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	8
	Pika 3 “Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar”.	11
	Pika 4 “Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve. Rekrutimet dhe largimet nga puna”.	18
	Pika 5 “Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve”.	31
	Pika 6 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për menaxhimin e aktiveve materiale, procedurat e ndjekura për inventarizimet, nxjerrjen jashtë përdorimi si dhe asgjësimin e tyre”.	53
	Pika 7 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve, zbatimin e kontratave të punimeve civile, mallra dhe shërbime si dhe të ngarkim-shkarkimit”.	59
	Pika 8 “Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël”.	86
	Pika 9 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve dhe zbatimi i detyrimeve të ndërsjellëta”.	97
	Pika 10 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”.	100
IV.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	108
V.	ANEKSE	109
VI.	DOKUMENTE SHOQËRUESE	110



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, funksionon si Shoqëri me kapital 100% shtetëror. Aksionari i vetëm i kësaj shoqërie Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Shoqëria është krijuar dhe funksionon bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Shoqëria drejtohet me dy nivele.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është rregullshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2022. Cilësia e shërbimeve dhe siguria ndaj përdoruesve të shërbimeve portale si për pasagjerë ashtu dhe për transport mallrash.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga. Pagesat e realizuara për këshillin mbikëqyrës. Të ardhurat e realizuara, si dhe realizimi i shpenzimeve. Janë audituar pothuajse të gjitha procedurat e prokurimit me vlera të larta si dhe disa procedura me blerje të vogël për vitet objekt auditimi 2018 deri 2022.

Disa nga gjetjet kryesore paraqiten si më poshtë:

Gjetja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nëpërmjet bankës, janë kryer transfertat në favor të shoqërisë D.C Shkodër, në shumën 13,544,581 lekë, 3 transfertat nga Banka “C”. Shuma e mësipërme është likuiduar bazuar në 3 vendime të Asamblesë, si më poshtë:</p> <p>a) Vendimi i Asamblesë nr.49, datë 19.06.2019 “Për kalim fondi” ku është vendosur kalimi i fondit 1,778,079 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore proporcionalisht për 6 punonjës.</p> <p>b) Vendimi i Asamblesë nr.62, datë 30.07.2019 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 9,766,502 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për përbalimin e detyrimeve sipas shkresës nr.31 Prot., datë 23.07.2017 të Administratorit të shoqërisë.</p>	Transfert fondesh në kundërshtim me ligjin	E Lartë	<ol style="list-style-type: none">1. Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të kërkojnë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar) kthimin në llogari të Portit Detar SHA Sarandë, të shumës 13,544,581 lekë, shumë kjo e miratuar në mënyrë të kundraligjshme nga Aksionari Mazhoritar dhe përfituar nga Shoqëria “D.C” Shkodër në vitin 2020, për detyrimet e pagave ndaj punonjësve të saj.2. Ministria e Financave, në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar të SHA “Porti Detar” Sarandë, të nxjerr përgjegjësitë, lidhur me efektin negativ të krijuar në buxhetin e SHA “Porti Detar” Sarandë, në shumën 13,544,581 lekë, të konstatuar nga KLSH si pasojë e 3 vendimeve të kundraligjshme, të marra nga Asambleja e SHA “Porti Detar” Sarandë, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike.3. Ministria e Financave, Drejtoria e Inspektimit Financiar, të ushtrojë kontroll në shoqërinë “D.C” Shkodër, mbi destinacionin e përdorimit të fondit 13,544,581 lekë dhe përfituesve duke bërë me dije Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi rezultatet e kontrollit nga Drejtoria e Inspektimit Financiar. Gjithashtu, të përcillet në KLSH, edhe lista emërore e përfituesve si dhe pozicionet e tyre përkatëse, në shoqërinë “D.C” Shkodër.



	<p>c) Vendimi i Asamblesë nr.3, datë 09.01.2020 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 2,000,000 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore deri në muajin Mars 2020.</p> <p>Referuar Vendimeve të Asamblesë, nga Drejtoria e Portit Detar Sarandë, janë nxjerrë Urdhërat e Brendshëm nr.64, datë 24.06.2019, nr.82, datë 08.08.2019 dhe nr.2, datë 14.01.2020 për kalimin e fondit sipas vendimeve të Asamblesë. Në vendimet e Asamblesë citohet baza ligjore neni 102, pika 4 Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë Porti Detar Sarandë dhe aksionarit mazhoritar të shoqërisë “D.C” Shkodër.</p> <p>Transferimi i shumës në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër (sot e privatizuar), është kryer në kundërshtim me Kreun I “Asambleja e Përgjithshme”, nenin 135, pika 4, të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statutin e shoqërisë, miratuar në 15.06.2012, Kreun III “Asambleja e Përgjithshme”, nenin 11, “Të drejtat dhe detyrimet”, në të cilat nuk ka të përcaktuar transferim fondesh për shpenzime, duke mos marrë në analizë situatën ekonomike të shoqërisë SHA “Porti Detar” Sarandë, e cila në vitet 2020-2021 ka paraqitur vështirësi financiare.</p>			
--	--	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

<p>2</p>	<p>Investimet për vitin 2018, janë realizuar në masën 72 %, për vitin 2019 janë realizuar në masën 30.8 %, për vitin 2020 janë realizuar në masën 73.5 %, për vitin 2021 nuk janë realizuar megjithëse janë programuar në vlerën 6,200 mijë lekë dhe për vitin 2022 janë realizuar në masën 29.7 %. Niveli i ulët i realizimit të investimeve flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese për realizimin e investimeve të programuara. Programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, megjithëse ka ndjekur procedurat dhe afatet përcaktuar në udhëzimin përkatës, nuk ka pasqyruar tregues të harmonizuar mirë midis tyre dhe nuk ka pasur planifikim të saktë të treguesve ekonomikë dhe financiar të bazuar në rezultatet e viteve paraardhëse si edhe në mundësitë reale të shoqërisë. Shoqëria në aspektin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i programit dhe detyrimet e tjera tregtare dhe ato mbështetëse, nuk ka bërë një punë të vlerësueshme në realizimin e tyre, niveli i realizimit të shpenzimeve duhej ndjekur me përgjegjësi si për zërat me devijime nga plani ashtu edhe për shpenzimet të cilat janë në masën 100% me planifikimin, pasi shpenzimet duhet të kryhen vetëm për qëllime të domosdoshme të aktivitetit.</p>	<p>Mbi hartimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar.</p>	<p>E mesme</p>	<p>Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Programim Investimeve dhe Teknikës, të marrin masa për hartimin e programeve ekonomike bazuar në treguesit e realizuar në vitet e mëparshëm, në mundësitë dhe kapacitetet reale të shoqërisë dhe analizave ekonomike, të nivelit të investimeve, nivelit të shpenzimeve, numrit të punonjësve, etj, zëra të cilët duhen rishikuar dhe analizuar referuar uljes së volumit të punës, pasi shoqëria nuk kryen përpunim mallrash por vetëm pasagjerë, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara për drejtimin e shoqërisë.</p>
<p>3</p>	<p>Nga viti 2018 - 2022, baza ligjore e përdorur për përcaktimin e niveleve referuese të pagave për pozicionet e punëve mbështetëse, janë Vendimet nr. 589, datë 17.07.2013 dhe nr. 717, datë 23.06.2009. Kjo bazë ligjore përdoret për përcaktimin e niveleve referuese të pagave në</p>	<p>Mbi strukturën organizative dhe pagat</p>	<p>E mesme</p>	<p>Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për përcaktimin në strukturë të nivelit arsimor të çdo kategorie punonjësish sipas kërkesave të vendit të punës, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe realizimin e objektivave të shoqërisë në nivele cilësore.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

<p>institucionet buxhetore dhe “Portit Detar” SHA Sarandë, nuk është institucion buxhetor, pra në këto kushte nuk mund të përdorë lidhjet e përcaktuara në këtë legjislacion pasi vendimet nuk korrespondojnë me natyrën e shoqërisë. Struktura dhe niveli i pagave paraqitet me pozicione pune për 49 të punësuar, Struktura jep të dhëna në vlerë për shtesën për vjetërsi e cila i korrespondon personave të punësuar në shoqëri. Nga auditimi i kontratave individuale të punës nga viti 2018-2022, rezulton se për personat objekt auditimi aktualisht të punësuar pranë Portit Detar Sarandë, nuk janë përcaktuar në kontratë të gjithë elementët përbërës të pagës por vetëm paga bruto e punonjësit. Për vitin 2021, janë miratuar 8 punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), me pozicion pune sanitare dhe punonjës për sistemim arkive (kërkesë e DPA dhe Forcës së Sigurisë). Punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), nuk janë miratuar me akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës, por janë miratuar me vendimet e miratimit të Planit të Zhvillimit dhe buxhetit vjetor të shoqërisë. Viti 2021, rezulton me tejkalim 4-5 punonjës, si pasojë e rekrutimit të punonjësve me kontratë në periudhën e verës. Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune, po kështu edhe struktura e miratuar me vendimin nr.20, datë 28.12.2022, përveç nivelit arsimor nuk pasqyron kërkesat mbi profesionin sipas vendit të punës, niveli</p>			
---	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	arsimor është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune dhe për forcën e sigurisë ku kërkohet sipas udhëzimit.			
4	Për periudhën objekt auditimi, është larguar nga puna z. G.XH, me detyrë prerës biletash. Ky punonjës ka hapur proces gjyqësor për të cilin është marrë 1 vendim i formës së prerë në vitin 2019, për dëmshpërblim në shumën 556,300 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar për shoqërinë.	Mbi largimet e padrejta nga puna.	E mesme	1. Këshilli Mbikqyrës i Portit Detar SHA Sarandë, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive nga Strukturat Drejtuese, lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve. 2. Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.
5	Për vitin 2019, me Urdhrin e Brendshëm nr. 122, datë 14.12.2020, Drejtori i SHA “Portit Detar” Sarandë, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 20, datë 11.10.2019 dhe vendimit të Asamblesë nr.17874, datë 15.10.2020 ka vendosur shpërndarjen e shpërblimit për punonjësit e shoqërisë në vlerën e një page mujore pas daljes së rezultatit vjetor të vitit 2019. Drejtoria e Shoqërisë ende nuk ka shpërndarë masën e shpërblimit si pasojë e mbylljes nga Pandemia Covid-19.	Mbi shpërndarjen e shpërblimeve.	E mesme	Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrin masa që shpërndarja e shpërblimeve për punonjësit të kryhet në bazë të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë, me qëllim motivimin e punonjësve për arritjen e rezultateve pozitive në punë, respektimin e kërkesave të Kodit të Punës duke ndikuar në rritjen e performancës pozitive të treguesve ekonomiko-financiar të shoqërisë.
6	Gjendja e llogarisë sintetike “Të drejta të arkëtueshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 43,955,522 lekë, e cila përbëhet nga: -Gjendja e llogarisë “Klientë” në vlerën 15,493,546 lekë, e cila përbëhet nga 71 klientë të krijuar për më shumë se një vit ku pjesën më të madhe e zënë detyrimet e klientëve në vitet e kaluara prej 10,223,646 lekë. -Gjendja e llogarisë “Të tjera të arkëtueshme”, në fund të vitit 2021 është në vlerën 28,461,979 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pjesa më e madhe e kërkesave	Mbi llogaritë e arkëtueshme	E mesme	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori Ekonomik, të marrin masa duke ndjekur procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të të tretëve ndaj shoqërisë, si “Klientë” në vlerën 15,493,546 lekë dhe “të drejtave të tjera të arkëtueshme” në vlerën 28,461,979 lekë (rimbursim TVSH dhe detyrimi i shoqërisë “D.C” Shkodër), me qëllim mbledhjen e të ardhurave dhe përmirësimin e situatës financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p>përfaqëson detyrimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve për rimbursimin e tatim fitimit të parapaguar në vlerën 5,967,917 lekë, 2,879 lekë ndalesë për diferencë page, në vlerën 13,544,581 lekë, përfaqëson kalimin e fondit nga Porti Detar SHA Sarandë, në llogarinë e shoqërisë “D.C” Shkodër, si edhe vlerën 8,946,602 lekë që i përket TVSH së mbartur për tu rimbursuar prej vitit 2014 e pasqyruar në llog 445 “TVSH për tu marrë”. Vlera e llogarisë 445, nga 8,946,602 lekë në fund të vitit 2022 është rritur me 496,496 lekë. Vlera e TVSH për tu rimbursuar deri në fund të vitit 2022, është 9,433,098 lekë. Me gjithë korespodencat e vazhdueshme me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Sarandë, kjo vlerë ende nuk është rimbursuar.</p>			
7	<p>Nga auditimi i zbatimit të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, rezultoi se për periudhën objekt auditimi, Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, nuk ka ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin në rregulloren e shoqërisë të miratuar me vendimin nr. 6, datë 28.04.2016 të Këshillit Mbikëqyrës, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku si parësore është caktimi i nëpunësit autorizues, neni 8, pika 2, si dhe atij zbatues, neni 12. Në shoqërinë Porti Detar SHA Sarandë, nga Administratori i Shoqërisë, nuk është caktuar ende nëpunësi autorizues dhe zbatues, e konstatuar kjo gjetje edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së.</p>	<p>Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.</p>	<p>E mesme</p>	<p>Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masat e duhura për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.</p>
8	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale të nevojshme për mbrojtje</p>	<p>Mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik</p>	<p>E mesme</p>	<p>Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masat që në të ardhmen në procedurat e prokurimit, njësia e prokurimit ti referohet minimumi tre</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p><i>personale dhe higjeno-sanitare për mbrojtje nga Covid-19</i>” zhvilluar në vitin 2020, me vlerë kontrate 4,920,000 lekë me TVSH, u konstatua se:</p> <p>1. Sasitë e materialeve për mbrojtjen personale anti Covid nuk ishin nxjerrë në bazë të nevojave reale të Shoqërisë. Konkretisht, janë kërkuar 5000 copë Maska të thjeshta kirurgjikale, 2500 copë Maska mbrojtëse Kn95 FFP2 dhe 11000 copë Doreza mbrojtëse. Sasitë e mësipërme janë të ekzagjëruara krahasuar me nevojat e një stafi të reduktuar por mbi të gjitha edhe për arsye të mos kryerjes së aktivitetit të transportit detar për shkak të situatës të shkaktuar nga Covid-19. Vlera prej 2,925,600 lekë me TVSH që korrespondon me vlerën e materialeve të mësipërme, konsiderohet si vlerë e investuar në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës së fondeve publike.</p> <p>2. Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit, nuk u konstatua dokumentacioni i plotë lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit të procedurës. Përlllogaritja e vlerës së fondit limit për procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm nuk i referohet mesatares së 3 ofertave të marra nga tregu por Njësia e Prokurimit është bazuar për nxjerrjen e fondit limit vetëm tek 1 ofertë ekonomike.</p>			<p>ofertave të tregut dhe në të njëjtën kohë, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja e sasive të mallrave që do të prokurohen, duke i krahasuar ato me të dhënat reale të Shoqërisë me qëllim shmangien e investimeve me pasoja negative financiare në të ardhmen.</p>
9	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve me objekt “<i>Ndërtimi i tualeteve në kalatë</i>” sipas kontratës me datë 17.02.2020, të lidhur midis OE “A&P” SHPK dhe Portit Detar SHA Sarandë, u</p>	<p>Mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik</p>	<p>E mesme</p>	<p>Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 405,427.2 lekë, nga “A&P” SHPK, si vlerë që i përket</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p>konstatuan mangësi në zëra punimesh dhe konkretisht:</p> <p><u>-Punime ndërtimi:</u></p> <p>1. Nr. 24, An 2.404/1, Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë, në vlerën 73.905 lekë pa TVSH.</p> <p>2. Nr. 28, An 2.209, Ulluk shkarkimi me llamarinë xingat në vlerën 1.701 lekë pa TVSH.</p> <p><u>-Punime elektrike:</u></p> <p>3. Nr. 16, An 2.a-133, Ndriçues elektrik tavanor 1x 18 Ë, copë 5, në vlerën 7.250 lekë pa TVSH.</p> <p>4. Nr. 22, An, Zëri F.V Aparat matës për EE, elektronik i përdorshëm me kartë në vlerën 150,000 lekë pa TVSH.</p> <p>5. Nr. 23, An, Zëri Aparat matës për ujin elektronik i përdorshëm me kartë (përfshi lexuesin elektronik) në vlerën 105,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Vlera totale e punimeve të pa kryera, është 405,427.2 lekë.</p>			<p>zërave të punimeve të situacionuar dhe likujduar por të pa kryer nga OE.</p>
10	<p>Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019 dhe objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri: Nr.28, An 2.404/1, “Bojë hidroplastike importi, cilësia e I-rë” me vlerë 361,680 lekë me TVSH. Si rezultat, vlera totale e punimeve të pa kryera është 361,680 lekë.</p>	<p>Mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik</p>	<p>E mesme</p>	<p>Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 361,680 lekë, nga “N” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likujduar por të pa kryer nga OE.</p>
11	<p>Kontrata midis OE “A&P” SHPK dhe PDS SHA, me objekt “Kabinë elektrike 20 kV”, vlerë 5,773,914 lekë me TVSH, është lidhur në datën 21.06.2019 dhe me afat 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Nga auditimi në terren i punimeve të kryera, u konstatua se kablli i aluminit AL 20 kV x 240/25mm iz.XLPE, ishte më i shkurtër se gjatësia e</p>	<p>Mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik</p>	<p>E mesme</p>	<p>Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 116,640 lekë, nga “A&P” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likujduar por të pa kryer nga OE.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p>“Blerje materiale elektrike”, etj, të zhvilluara në për periudhën objekt auditimi, në praktikat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua mungesë dokumentacioni dhe argumentimi lidhur me nevojat reale të Portit Detar SHA Sarandë për sasi të mallrave ose materialeve të prokuruar. Në kërkesat e bëra në hartimin e nevojave ishte përllogaritur dhe fondi limit në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.</p>			
13	<p>Në zbatim të nenit 15, shkronja “j” të ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, Porti Detar SHA Sarandë, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 205 Prot., datë 26.03.2018, lidhur me marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm ku cilësohet se është nxjerrë urdhri respektiv nga administratori i shoqërisë për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH, është hartuar plani i veprimit, plani i cili është miratuar me vendimin nr. 9, datë 18.05.2018 nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë. Në zbatim të pikës “2”, të nenit 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, Porti Detar SHA Sarandë, nuk i ka kthyer përgjigje KLSH-së brenda afatit 6 mujor, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.</p>	<p>Mbi raportimin nga subjekti për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.</p>	<p>E mesme</p>	<p>Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masa që në të ardhmen, të raportohet pranë KLSH-së brenda afateve të përcaktuara mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas përcaktimeve ligjore.</p>

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1080/1 Prot., datë 11.01.2023,



miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.01.2023 deri më datë 10.03.2023, në subjektin “Porti Detar” SHA Sarandë, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2022, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” me përbërje:

A.T, përgjegjës grupi

M.B, audituese

G.P, auditues

Q.M, auditues

J.B, auditues

a. Titulli: Raport mbi Auditimin e Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë së Aktivitetit të “Porti Detar” SHA, Sarandë.

b. Marrësi: “Porti Detar” SHA, Sarandë, me Administrator z. A.Q.

c. Objektivat dhe qëllimi: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që “Porti Detar” SHA, Sarandë, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë shoqërisë. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore si dhe nëse u është shërbyer udhëtarëve dhe anijeve që ankorohen në port sipas standardeve që kërkohen. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).

d. Identifikimi i çështjes: Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim: Shoqëria ka si qëllim dhënien e shërbimeve portale për mjetet detare, krijimin e kushteve për pasagjerët që hyjnë dhe dalin nga porti, si dhe krijimin e kushteve dhe respektimin e kontratave me subjekte që përdorin kalatat e portit, duke garantuar edhe sigurinë portuale.

f. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

g. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së. Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji



nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit; Ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”; etj. VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 i Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë; etj.

h. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 - *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)*
- ISSAI 400 *(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).*
- Kodi etik i KLSH.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, funksionon si Shoqëri me kapital 100% shtetëror. Aksionari i vetëm i shoqërisë, është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Shoqëria është krijuar dhe funksionon bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Shoqëria drejtohet me dy nivele. Këshilli Mbikëqyrës funksionon sipas përcaktimeve në ligjin e mësipërm, statutin e shoqërisë, VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 të METE, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”. Administrator i Shoqërisë është z. A.Q, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë dhe konkretisht z. S.K (zgjedhur kryetar), z. A.M dhe znj. A.L.

Shoqëria ka si qëllim krijimin e kushteve dhe sigurisë për lëvizjen e pasagjerëve dhe mallrave. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është rregullshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga data 01.06.2014 deri me datë 30.09.2017. Cilësia e shërbimeve dhe siguria ndaj përdoruesve të shërbimeve portale si për pasagjerë ashtu dhe për transport mallrash.

Qëllimi i auditimit është hartimi i projektraportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të shoqërisë.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga. Pagesat e realizuara për këshillin mbikëqyrës. Të ardhurat e realizuara, si dhe realizimi i shpenzimeve. Janë audituar mbi 50 % të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë dhe të vogël për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2022.



III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

-Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara me Raportin Përfundimtar nga KLSH, në Portin Detar SHA Sarandë me shkresën nr.1044/8, datë 02.03.2018.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 16 masa organizative.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, janë rekomanduar 8 masa për vlerën totale prej 5,140,224 lekë, nga të cilat janë pranuar 8 masa, është zbatuar plotësisht 1 (një) masë, dhe janë në proces zbatimi 7 (shtatë) masa.

c. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 7 (shtatë) masa me vlerë 2,706,889 lekë, janë pranuar të gjitha rekomandimet por nuk kanë filluar arkëtimet pasi institucioni është akoma në procese gjyqësore. 1 (një) masë shpërblim dëmi është realizuar plotësisht.

Në zbatim të nenit 15 shkronja “j” të ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, Porti Detar SHA Sarandë, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 205 Prot., datë 26.03.2018 “Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” për secilën masë. Është nxjerrë urdhri respektiv nga administratori i shoqërisë për zbatimin e detyrave të lëna. Është hartuar plani i veprimit në zbatim të detyrave për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH plan i cili është miratuar me vendimin nr. 9 datë 18.05.2018 nga Këshilli Mbikqyrës i Portit Detar SHA Sarandë. Në zbatim të pikës “2” të nenit 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, Porti Detar SHA Sarandë, nuk i ka kthyer përgjigje KLSH-së brenda afatit 6 mujor, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Titulli i Gjetjes:	Mos respektimi i afateve ligjore për raportimin pranë KLSH-së lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna.
Situata:	Në zbatim të nenit 15, shkronja “j” të ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, Porti Detar SHA Sarandë, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 205 Prot., datë 26.03.2018, lidhur me marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm ku cilësohet se është nxjerrë urdhri respektiv nga administratori i shoqërisë për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH, është hartuar plani i veprimit, plan i cili është miratuar me vendimin nr. 9, datë 18.05.2018 nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë. Në zbatim të pikës “2”, të nenit 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, Porti Detar SHA Sarandë, nuk i ka kthyer përgjigje KLSH-së brenda afatit 6 mujor, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.
Kriteri:	Pika “2” e nenit 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.
Ndikimi/Efekti:	Mos respektimi i ligjit të KLSH-së.
Shkaku:	Mos njohja e mirë e ligjeve dhe rregullave të KLSH-së.
Rëndësia:	E Mesme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masa që në të ardhmen, të raportohet pranë KLSH-së brenda afateve të përcaktuara mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas përcaktimeve ligjore.
--------------------	--

2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

“Porti Detar” SHA, Sarandë është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror. Pronari themelues dhe Aksionari i vetëm i shoqërisë, është Ministria përgjegjëse për ekonominë. Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë, përpunimin e Anijeve, Trageteve, pasagjerëve, mallrave, shërbimeve portuale për të gjitha mjetet lundruese, ndërtime, menaxhim dhe ruajtje të objekteve si dhe koordinimin e aktiviteteve brenda territorit të portit.

Shoqëria “Porti Detar” SHA, Sarandë ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, të Statutit si dhe të Rregullores së Brendshme të saj, miratuar me ndryshime të fundit me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.18, datë 30.12.2021. Shoqëria ka si qëllim krijimin e kushteve dhe sigurisë për lëvizjen e pasagjerëve dhe mallrave.

Gjatë periudhës objekt auditimi, ka dalë një akt nënligjor, që ka prekur drejtpërdrejt pasuritë dhe veprimtarinë e kësaj shoqërie, konkretisht:

-VKM nr.515, datë 01.07.2020 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, për dhënien me koncesion/partneritet publik privat të portit turistik dhe të shërbimeve “M. L.” ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës së Ekonomisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “K. G.” SHA & “E.-AL-IT” SHPK. Pronësia e këtij Porti i ka kaluar këtij bashkimi operatorësh me proces-verbal nr.263/1 Prot., datë 24.07.2020.

Administrator i Shoqërisë është z. A.Q, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë dhe konkretisht, për vitin 2018 z. S.K (zgjedhur kryetar), z. A.M dhe znj. A.L deri në Korrik 2018 pasi është zëvendësuar nga z. F.Sh me vendimin e asamblesë me nr. 101, datë 13.07.2018 dhe nr. 11983 Prot., nënshkruar nga Ministri z. A.A. Për vitin 2019 z. S.K (zgjedhur kryetar), z. A.M dhe z. F.Sh. Për vitin 2020, z. S.K (zgjedhur kryetar) deri në Qershor 2020 pasi është zëvendësuar nga z. D.D, z. A.M deri në Gusht 2020 pasi është zëvendësuar nga znj. I.Dh dhe z. F.Sh deri në Korrik 2020 pasi është zëvendësuar nga znj. N.C. Për vitin 2021 z. D.D (zgjedhur kryetar), znj. N.C dhe znj. I.Dh. Për vitin 2022, z. D.D (zgjedhur kryetar) deri në fund të muajit Janar 2022 pasi është zëvendësuar nga znj. G.P, por edhe kjo është deri në muajin Mars 2022 pasi është zëvendësuar nga znj. R.K, znj. I.Dh deri në muajin Maj 2022 pasi është zëvendësuar nga z. I.Xh dhe znj. N.C.

Nga auditimi me zgjedhje sipas viteve objekt auditimi, rezultoi se për vitin 2020, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë 19 vendime si më poshtë:

Nr vendimit	Data	Objekti
1	02.04.2020	Marrja e dy punonjësve sezonalë
2	19.06.2020	Miratimi i fondit për masat anticovid
3	04.08.2020	Miratimi i strukturës organizative të shoqërisë
4	04.08.2020	Miratimi i strukturës së pagave të shoqërisë
5	04.08.2020	Miratimi i fondit të pagave të shoqërisë
6	04.08.2020	Miratimi i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë
7	23.09.2020	Miratimi i Statutit të ri të Shoqërisë
8	23.09.2020	Miratimi i pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2019
9	23.09.2020	Miratimi për shtyrje afati për një punonjës sezonal
10	23.09.2020	Njohja e kalatës së re si aset
11	31.10.2020	Struktura organizative e shoqërisë
12	30.10.2020	Struktura e pagave e shoqërisë
13	30.10.2020	Ndryshimi i fondit të Pagave të Shoqërisë
14	30.10.2020	Rregullorja e brendshme e shoqërisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

15	10.11.2020	Miratimi i tarifave sekondare të shoqërisë
16	17.12.2020	Miratimi i programit ekonomik për vitin 2021
17	17.12.2020	Miratimi i nxjerrjes jashtë përdorimit
18	17.12.2020	Miratimi i marrjes në punë të një punonjësi sezonal
19	17.12.2020	Miratimi i kodit të sjelljes dhe etikës

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Për vitin 2021, Këshilli Mbikqyrës ka marrë 19 vendime si më poshtë:

1	10.03.2021	Vendim për kalimin e zyrave në Terminal në funksion të administratës
2	02.06.2021	Miratimi i pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2020
3	02.06.2021	Miratimi i strukture organizative të shoqërisë
4	02.06.2021	Miratimi i strukture së pagave të shoqërisë
5	02.06.2021	Miratimi i rregullores së brendshme të shoqërisë
6	02.06.2021	Miratimi i listës së materialeve për nxjerrje jashtë përdorimit për vitin 2020
7	02.06.2021	Miratimi i ndryshimit të tarifave
8	16.06.2021	Vendim për planin e shpenzimeve të vitit 2021
9	27.07.2021	Vendimi për miratimin e planit të masave për sezonin turistik
10	27.07.2021	Vendim për miratimin e Raportit të ecurisë dhe drejtimit të brendshëm të shoqërisë
11	27.07.2021	Te miratoje punësimin e dy punonjësve sezonalë biletaprerës
12	06.10.2021	Miratimi i dhenies me qera 4 zyra për Degen Doganore Sarandë
13	06.10.2021	Miratimi i ndihmës ekonomike për z.E.H
14	05.11.2021	Vendimi për dhenie me qera të godinës në Bunec
15	30.12.2021	Vendimi për miratimin e Programit Ekonomik për vitin 2022
16	30.12.2021	Vendimi për miratimin e Struktura Organizative të Shoqërisë për 2022
17	30.12.2021	Vendimi për miratimin e Struktura së Pagave për 2022
18	30.12.2021	Vendimi për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shoqërisë
19	30.12.2021	Vendimi për marrjen në punë të punonjësve sezonalë

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Për vitin 2022, Këshilli Mbikqyrës ka marrë 24 vendime si më poshtë:

1	17.10.2022	Vendim për znj.G.P
2	30.03.2022	Vendim për znj.R.K
3	07.04.2022	Vendime për ndryshime në Programin Ekonomik 2022
4	09.06.2022	Vendimi për dhenien me qera të zyrave në Terminalin e Pasagjereve
5	09.06.2022	Vendimi për miratim tarifë për ankorimin e jahteve
6	09.06.2022	Vendimi për miratimin e planit të masave për sezonin turistik 2022
7	01.07.2022	Miratimi i Struktura Organizative të Shoqërisë
8	01.07.2022	Miratimi i struktura së pagave
9	01.07.2022	Miratimi i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë për 2022
10	01.07.2022	Miratimi i tarifës për mjetet lundruese të sekuestruara nga Policia dhe Prokuroria
11	18.07.2022	Miratimi i pasqyrave financiare të shoqërisë për 2022
12	18.07.2022	Miratimi i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të shoqërisë për 2021
13	18.07.2022	Miratimi i Raportit të Ecurisë të Shoqërisë, dhe Drejtimit të Brendshëm për vitin 2022
14	22.09.2022	Riemerimi i znj V.C si anetare e Keshillit Mbikqyrës
15	22.09.2022	Miratimi i Tarifës së shtetit për Agjensinë detare dhe turistike
16	22.09.2022	Miratimi i Tarifave për mjetet lundruese
17	22.09.2022	Miratimi i ndihmës ekonomike për punonjësin Plarent Shehu
18	22.09.2022	Miratimi i masës së shpërblimit për punonjësit sipas rastit
19	28.12.2022	Miratimi i Programit ekonomik për vitin 2023
20	28.12.2022	Miratimi i Struktura Organizative të Shoqërisë për vitin 2023
21	28.12.2022	Miratimi i struktura së pagave minimale-maksimale
22	28.12.2022	Miratimi i struktura së pagave mujore të punonjësve të shoqërisë
23	28.12.2022	Miratimi i rregullores së brendshme të shoqërisë
24	28.12.2022	Miratimi për marrjen në punë të punonjësve sezonalë

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Struktura organizative e “Portit Detar” SHA Sarandë, është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës dhe konkretisht me Vendimin nr.5, datë 07.04.2019 për periudhën Prill 2019 deri në Nëntor 2020, me numër të përgjithshëm të punonjësve 49. Kjo strukturë është ndryshuar gjatë vitit 2020 me Vendim nr.3, datë 03.08.2020, me numër të përgjithshëm të punonjësve me 56 punonjës. Referuar situatës së pandemisë Covid-19, pezullimit të aktivitetit të linjave ditore ndërkombëtare si dhe anijeve dhe trageteve dhe për të patur një organizim më të mirë të punës, nga strukturat menaxhuese të portit është kërkuar ndryshimi i strukturës së miratuar dhe ulja e numrit të punonjësve në strukturë nga 59 në 49 punonjës. Këshilli Mbikqyrës me Vendimin nr.11, datë 30.10.2020 ka miratuar ndryshimin e strukturës dhe numrin e punonjësve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Ndryshimi i strukturës është shoqëruar me ndryshimin e fondit të pagave miratuar në Programin Ekonomik të miratuar për vitin 2020 nga 48.000 mijë lekë në 31.900 mijë lekë, ndryshim i miratuar me vendimin nr.12, datë 30.10.2020. Struktura organizative për vitin 2020 është e përbërë nga 3 Degë, 1 Sektor dhe 2 Zyra, gjithsej me 49 punonjës.

3. Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomik-financiar.

Për zbatimin e kriterëve në planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë mbi hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e shoqërisë
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.
- Statuti i Shoqërisë
- Programet e miratuara dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit
- Realizimi i shpenzimeve me planifikimet.
- Zbatimi i kriterëve në programim, mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", në mendimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi hartimin dhe zbatimin e programeve ekonomike;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Programi ekonomik dhe financiar për vitet 2018-2022,

Projekt programet e zhvillimit ekonomik për vitet 2018-2022, janë hartuar mbi bazën e treguesve të vitit paraardhës dhe realizimit të pritshëm të vitit aktual. Projekt programi i çdo viti është hartuar nga Drejtoria e Shoqërisë dhe pasi është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës është paraqitur për mendim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe për miratim nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në udhëzimin nr.315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” si dhe në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Për hartimin e programit ekonomik, strukturat drejtuese të shoqërisë janë mbështetur në:

- analizën e treguesve ekonomik-financiarë të realizuar në vitin e mëparshëm;
- në objektivat e zhvillimit të shoqërisë;
- në politikat e ndjekura për zhvillimin e biznesit dhe turizmit në rajonin e jugut;
- në shfrytëzimin e mundësive dhe kapaciteteve të shoqërisë, etj.

Tabela nr. 1 Planifikimi dhe realizimi i treguesve ekonomik dhe i të ardhurave nga perpunimi i mallrave dhe udhetareve

Nr	EMERTIMI	Njësia	VITI 2018			VITI 2019			VITI 2020		
			Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Volumi i punës (mallra)	Ton	10,000	39,300	393	25,000	100,626	402.5	92,000	38,060	41.3
2	Pasagjer te përpunuar gjithesej	pasagjere	420,000	482,216	114.8	490,000	516,188	105.3	506,000	5,589	1.1
a	- Te imbarkuar	“	210,000	242,418	115.4	245,000	258,561	105.5	256,000	2,868	1.1
b	- Te disimbarkuar	“	210,000	239,798	114.2	245,000	257,627	105.2	250,000	2,721	1.1
	TOTAL te ardhura	000/lek	107,600	124,378	115.6	122,000	133,970	109.8	135,000	9,026	6.7

Nr	EMERTIMI	Njësia	VITI 2021			VITI 2022		
			Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

									%
	Volumi i punës (mallra)	Ton	-	-	-	-	-	-	-
1	Pasagjer te përpunuar gjithsej	pasagjere	300,000	64,202	21.4	310,000	366,154	118.1	
a	- Te imbarkuar	“	150,000	32,604	21.7	155,000	184,677	119.1	
b	- Te disimbarkuar	“	150,000	31,598	21	155,000	181,477	117	
	TOTAL te ardhura	000/lek	72,000	22,519.7	31.3	76,000	91,228.3	120	

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Për vitin 2018, pasi është përgatitur programi nga shoqëria, me shkresën nr.1048 Prot., datë 21.12.2017, të shoqëruar më mendimin e MTI, me shkresën nr. 3005/1 Prot., datë 05.02.2018 dhe Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 05.12.2017, është miratuar nga METE me shkresën nr. 19228/1, datë 22.02.2018, programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2018. Treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të programuar dhe të realizuar për vitin 2018, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2 “Programi dhe realizimi i treguesve ekonomikë dhe financiar për 2018” në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	129,839	148,187	114.13
2	Shpenzime gjithsej	87,074	96,051	110.3
3	Investime gjithsej	12,700	9,180	72
4	Numri i punonjësve	49	51	104
5	Paga mesatare mujore	54,421	50,825	93.4
6	Fondi i pagave	32,000	31,105	97.2

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Treguesit sintetik sipas programit ekonomik për vitin 2018 në %, tregojnë për një vit me realizim të treguesve kryesor ekonomik dhe konkretisht në transportin e mallrave dhe pasagjerëve realizimi i të ardhurave gjithsej është në masën 115.6 %, të ardhura këto të realizuara nga dy burimet kryesore si më poshtë:

- Realizimi i volumit të punës në sektorin e mallrave ka qenë në masen 393%. Ku nga 10,000 ton të planifikuar janë realizuar 39,300 ton. Këtu volumin kryesor e zënë eksportet (inerte) në masën 29,150 ton.
- Realizimi i pasagjereve gjithsej imbarkim + disimbarkim ka qenë në masën 114.8%, ose nga 420000 pasagjerë të planifikuar, ky zë është realizuar në 482216 pasagjerë. Nga keta:
 - ✓ Pasagjerë të imbarkuar nga 210,000 të programuar, janë realizuar 242,418, ose 115.4 %,
 - ✓ Pasagjerë të disimbarkuar nga 210,000 të programuar, janë realizuar 239,798, ose 114.2 %,
 - ✓ Investimet janë realizuar në masën 72 %, pra ka një mosrealizim në masën 28 %.

Nuk është realizuar prokurimi për ndërtimin e tualeteve.

Shpenzimet janë realizuar në masën 110.3%, me një tejkalim prej 10.3%, i cili vjen nga ndryshimet në kursin e këmbimit.

- Realizimi i të ardhurave sipas burimit të krijimit, për vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3 “Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2018”. në mijë lekë
(dega e përpunimit të anijeve dhe trageteve)

Nr	Treguesit	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	107,600	124,378	115.6
a	<i>Nga përpunimi i anijeve</i>	<i>2,500</i>	<i>5,174.3</i>	<i>206.9</i>
b	<i>Nga përpunimi i trageteve</i>	<i>95,600</i>	<i>110,484.6</i>	<i>115.5</i>
c	<i>Të ardhura të tjera (sherbime portuale)</i>	<i>9,500</i>	<i>8,719.1</i>	<i>91.8</i>

Siç shihet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2018, Sigurimi i “të ardhurave gjithsej” në masën 115.6 % është si rezultat i realizimit të të Ardhurave në veçanti nga zëri “te ardhurat nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

përpunimi i anijeve” të cilat janë realizuar në masën 206.9 %, dhe nga zëri “përpunimi i trageteve” realizuar në masën 115.5 %.

Të ardhurat nga përpunimi i pasagjerëve me tragetet e linjës dhe ato turistike, përbëjnë zërin kryesor të sigurimit të të ardhurave të kësaj shoqërie në masën 80% (kjo ka bërë që aktiviteti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë të kalojë nga përpunimi i mallrave në atë të pasagjerëve). Ndërsa zëri “të ardhura të tjera” (shërbime portuale), është realizuar në masën 91.8 %, këto janë të ardhurat nga akostimi në kalatë i të gjitha anijeve.

Zëri shërbime portuale është realizuar në mjete lundruese, si dhe nga shërbime të tjera portuale si furnizimet me ujë, energji, etj, në masën 91.8%. Mosrealizimi i të ardhurave në këtë zë është ndikuar nga mos akostimi i trageteve turistike në kalatë. Në shumicën e rasteve ato kanë qëndruar në radë, për arsye të sigurisë teknike (gjatësia e tyre ishte mbi parametrat teknik që lejon akostimin e tyre në kalatën e kruizeve).

Për vitin 2019, pasi është përgatitur programi nga shoqëria, me shkresën nr.945 Prot., datë 19.12.2018, të shoqëruar më mendimin e MTI, me shkresën nr. 15205/3 Prot., datë 15.01.2019 dhe Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 19.12.2018, është miratuar nga METE me shkresën nr. 22446/1 Prot., datë 11.02.2019, programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2019. Treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të programuar dhe të realizuar për vitin 2019, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2 “Programi dhe realizimi i treguesve ekonomikë dhe financiar për 2019” në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	144,007	152,554	133.8
2	Shpenzime gjithsej	117,360	118,931	101.3
3	Investime gjithsej	34,950	10,794	30.8
4	Numri i punonjësve	49	54	110.2
5	Paga mesatare mujore	63,945	57,289	89.6
6	Fondi i Pagave	37,600	37,123	98.7

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Treguesit sintetik për vitin 2019, janë realizuar dhe tejkaluar në një nivel të kënaqshëm, dhe konkretisht në transportin e mallrave dhe pasagjerëve, që është edhe burimi kryesor i të ardhurave të kësaj shoqërie, realizimi i të ardhurave është në masën 109.8%. Realizimi i të ardhurave është rezultat i realizimit të treguesve të punës si më poshtë:

- Në përpunimin e mallrave nga 25000 ton të planifikuar janë përpunuar 100626 ton. ose në masën 402,5%. Edhe për këtë vit, peshën kryesore e kanë zënë eksportet e inerteve në masen 79950 ton.
- Në përpunimin e pasagjerëve nga 490000 pasagjerë të planifikuar, janë realizuar 516188 pasagjerë, ose në masën 105.3 %. Specifikuar kjo:
 - ✓ Pasagjerë të imbarkuar nga 245000 të programuar, janë realizuar 258561, ose 105.5 %,
 - ✓ Pasagjerë të disimbarkuar nga 245000 të programuar, janë realizuar 257627, ose 105.2 %

Realizimi i të ardhurave sipas burimeve të krijimit, për vitin 2019 paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 3 “Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2019”. në mijë lekë
(dega e përpunimit të anijeve dhe trageteve)

Nr	Treguesit	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	122,000	133,970	109.8
a	Nga përpunimi i anijeve	3,000	11,155.1	371.8
b	Nga përpunimi i trageteve	109,000	113,827.3	104.4
c	Të ardhura të tjera (shërbime portuale)	10,000	8,987.6	89.8



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Siç shihet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2019, realizimi i të ardhurave sipas zërave është si më poshtë:

“të ardhurat nga përpunimi i anijeve” janë realizuar në masën 371.8 %, ky zë edhe pse ka një tejkalim të konsiderueshëm, përbën rreth 8% të të ardhurave të kësaj shoqërie.

“të ardhurat nga përpunimi i trageteve” janë realizuar në masën 104.4 %, këto janë të ardhura të arkëtuara nga përpunimi i pasagjerëve dhe zënë 85% të të ardhurave gjithsej të kësaj shoqërie.

“të ardhura të tjera” realizimi është në masën 89.8 %, këto janë të ardhura nga zënia e kalatës e të gjitha mjeteve lundruese (ky mosrealizim ka ardhur pasi pjesa dërmuese e trageteve të mëdha cruiz kanë qëndruar në radën e portit dhe nuk janë akostuar në kalatë).

Investimet janë realizuar në masën 30.8 %, pasi nuk është realizuar investimi me objekt “Rikualifikimi i kalatës” në shumën 30 milionë lekë, për vonesë në pajisjen me leje ndërtimi.

Numri i punonjësve është tejkaluar në masën 10.2% dhe shpenzimet në masën 1.3%.

Në planifikimin e të ardhurave gjithsej strukturat drejtuese nuk janë bazuar në arritjet e vitit 2018.

Për vitin 2020, pasi është përgatitur programi nga shoqëria, me shkresën nr.888 Prot., datë 24.12.2019, të shoqëruar me mendimin e MTI, me shkresën nr.1422/2 Prot., datë 24.02.2020 dhe Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 18, datë 23.12.2019, është miratuar nga METE me shkresën nr.4251/1 Prot., datë 18.03.2020, programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2020. Treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të programuar dhe të realizuar për vitin 2020, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2 “Programi dhe realizimi i treguesve ekonomikë dhe financiar për 2020” në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	153,150	29,801	19.45
2	Shpenzime gjithsej	128,606	94,010	73
3	Investime gjithsej	36,480	26,824	73.5
4	Numri i punonjësve	69	44	63.7
5	Paga mesatare mujore	57,143	64,833	113
6	Fondi i Pagave	48,000	34,232	71.3

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Treguesit sintetikë për këtë vit, krahasuar me ato të programit ekonomik janë realizuar në përqindje të ulët. Kjo pasi dega e përpunimit të anijeve dhe trageteve që është edhe dega kryesore që siguron të ardhurat e kësaj shoqërie i ka realizuar të ardhurat në masën 6.7 %.

Faktorët e këtij mosrealizimi janë si më poshtë:

- Realizimi i volumit të punës në sektorin e mallrave për vitin 2020 ka qenë 38060 ton mallra nga 92000 ton të programuar, ose realizuar në masën 41.3 %.

Ky volum pune i përket periudhës nga 1 janar - 24 korrik 2020, datë në të cilën Porti i Limionit, aseti i vetëm i kësaj shoqërie ku përpunohen mallrat nga anijet tregtare, i ka kaluar firmës koncensionare.

Edhe pse të ardhurat nga përpunimi i mallrave zënë rreth 8% të të ardhurave të përgjithshme të portit, ndërprerja e këtij aktiviteti ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave në total.

Të ardhurat nga përpunimi i mallrave nga 11040 mijë lekë të programuara, janë realizuar 5253.8 mijë lekë, ose në masën 47.5 %.

Kalimi i Portit të Limionit firmës koncensionare, ka ndikuar direkt në këtë mos realizim.

Përpunimi i mallrave është kryer 7 muaj, nga 12 muaj për të cilën është programuar.

- Realizimi i përpunimit të pasagjerëve.
Për vitin 2020, transporti i pasagjerëve në linjën Sarandë - Korfuz - Sarandë, është kryer për periudhën **1 Janar - 14 Mars 2020**. Pas kësaj date në kuadër të masave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Të gjithë treguesit rezultojnë të pa realizuar si rezultat i pandemisë Covid-19, por nga strukturat drejtuese nuk janë marrë masa për ndryshimin e programit ekonomik.

Për vitin 2021, pasi është përgatitur programi nga shoqëria, me shkresën nr.463 Prot., datë 17.12.2020, të shoqëruar më mendimin e MTI, me shkresën nr. 518 Prot., datë 14.01.2021 dhe Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 17.12.2020, është miratuar nga METE me shkresën nr. 697/1 Prot., datë 10.02.2021, programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2021. Treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të programuar dhe të realizuar për vitin 2021, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2 “Programi dhe realizimi i treguesve ekonomikë dhe financiar për 2021” në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	91,350	115,521	126.7
2	Shpenzime gjithsej	91,275	97,090	109
3	Investime gjithsej	6,200	-	-
4	Numri i punonjësve	49	52	106
5	Paga mesatare mujore	59,523	55,943	94
6	Fondi i Pagave	35,000	34,909	99.74

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Treguesit sintetikë për vitin 2021, janë realizuar në nivele të ulta. Efektet e pandemisë Covid-19 kanë ndikuar që të ardhurat e siguruara nga dega e përpunimit të anijeve dhe trageteve të jenë realizuar në masën 31.3%.

Kjo për arsye sepse burimet kryesore prej të cilave porti realizon të ardhurat janë ndërprerë, si më poshtë:

-Aktiviteti i transportit të udhëtarëve dhe automjeteve me tragetet e linjës Sarandë-Korfuz-Sarandë është bllokuar deri me 30 qershor 2021, diktuar kjo nga përhapja e pandemisë në nivele të larta në të gjithë vendin.

-Janë anuluar të gjitha prenotimet e bëra nga agjensitë detare për tragetet turistike cruiz që do të përpunoheshin në portin e Sarandës në vitin 2021.

-Numri i jahteve të përpunuara u përgjysmua, pasi pjesa dërmuese e tyre akostohej në Portin e Limionit, i cili nuk është aset i portit Sarandë pas kalimit të tij koncesionarit.

-Rifillimi i aktivitetit të përpunimit të pasagjerëve me 1 korrik 2021, vetëm për tragetet e linjës Sarandë - Korfuz - Sarandë, me numër të reduktuar të pasagjerëve në bord në masën 30% kjo si masë mbrojtëse ndaj përhapjes së Covid-19, Sars, Cov 2 dhe Omicron.

Përpunimi i pasagjerëve ka vazhduar normalisht gjatë periudhës 1 Korrik - 15 Tetor, datë në të cilën nga pala greke është pezulluar përsëri transporti i pasagjerëve nga porti i Sarandës drejt portit të Korfuzit për arsye të një greve të punonjësve të shëndetësisë në portin e Korfuzit (Aktiviteti ka rifilluar në 1 Nëntor 2021).

Për këtë periudhë kohe, nga data 1 korrik - 31 dhjetor 2021, janë këta tregues pune:

- Në përpunimin e pasagjerëve gjithësej nga 300000 të programuar janë realizuar 64202, ose në masën 21.4 %, e specifikuar kjo:
 - ✓ Pasagjerë të imbarkuar nga 150000 të programuar, janë realizuar 32604, ose 21.7%,
 - ✓ Pasagjerë të disimbarkuar nga 150000 të programuar, janë realizuar 31598, ose 21 %.

Për vitin 2021, janë përpunuar 12 tragete turistike të tonazhit të mesëm dhe të vogël, me numër të reduktuar të pasagjerëve.

Realizimi i të ardhurave sipas burimeve të krijimit, për vitin 2021 paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr. 3 “Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2021”. në mijë lekë
(dega e përpunimit të anijeve dhe trageteve)

Nr	Treguesit	Programi	Realizimi	%
----	-----------	----------	-----------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

1	Të ardhura gjithsej	72,,000	22,519.7	31.3
a	<i>Nga përpunimi i trageteve</i>	<i>6,000</i>	<i>15,935.1</i>	<i>23.8</i>
b	<i>Të ardhura të tjera (sherbime portuale)</i>	<i>5,000</i>	<i>6,584.6</i>	<i>131.6</i>

Të ardhurat gjithsej janë realizuar në masën 31.3%.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2021, sigurimi i “të ardhurave gjithsej” është si rezultat i realizimit të të ardhurave nga zërat “përpunimi i trageteve” në masën 23.8 %, ku përfshihet përpunimi i pasagjerëve nga tragetet e linjës dhe tragete turistike.

Përpunimi është kryer në periudhën korrik-dhjetor, me kapacitet të reduktuar të pasagjerëve në bord.

Zëri të “ardhura te tjera” realizuar në masën 131.6 %, ku përfshihen të ardhurat nga zënia e kalatës nga të gjitha mjetet lundruese. Në një nivel të kënaqshëm është realizuar përpunimi i mjeteve të tjera turistike si jahte, veliera, skafe rreth 725 të këtij lloji që kanë arritur realizimin dhe tejkalimin e këtij zëri.

Për këtë vit nuk janë realizuar investime.

Shpenzimet janë tejkualuar me 9%, pasojë kursi i këmbimit, pasi zërat analitikë nuk paraqiten me tejkalim por të realizuar në masën 100%.

Strukturat drejtuese nuk kanë marrë masa për hartimin e programit ekonomik-financiar, referuar situatës së krijuar nga ndërprerjet e vazhdueshme nga pandemia, por kanë programuar treguesit si në një vit normal pune pa u bazuar në treguesit e arritur në periudhat e mëparshme si edhe nuk kanë korrigjuar treguesit sipas kapaciteteve dhe mundësive, për të arritur në rezultate pozitive.

Për vitin 2022, pasi është përgatitur programi nga shoqëria, me shkresën nr. 376 Prot., datë 30.12.2021, të shoqëruar më mendimin e MTI, me shkresën nr. 1488 Prot., datë 11.02.2021 dhe Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 30.12.2021, është miratuar nga METE me shkresën nr. 23519/1 Prot., datë 23.03.2022, programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2022. Treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të programuar dhe të realizuar për vitin 2022, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2 “Programi dhe realizimi i treguesve ekonomikë dhe financiar për 2022” në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	91,146	114,520	125.6
2	Shpenzime gjithsej	89,035	101,070	113.5
3	Investime gjithsej	19,800	5,900	29.7
4	Numri i punonjësve	49	48	80
5	Paga mesatare mujore	59,523	58,321	98
6	Fondi i Pagave	35,000	33,593	96

Burimi i të dhënave: Dokumente të SHA “Porti Detar” Sarandë

Treguesit sintetikë për vitin 2022, tregojnë përmirësim të dukshëm në çdo zë. Aktiviteti i punës në Portin e Sarandës ka hyrë në fazën normale pas rreth 2 vite ndërprerje nga pandemia. Niveli i të ardhurave nga aktiviteti kryesor është realizuar në masën 120%, si rezultat i realizimit të treguesve të punës si më poshtë:

Realizimi i pasagjerëve gjithsej imbarkim+disimbarkim nga 310000 pasagjerë të planifikuar është realizuar 366154 pasagjerë ose 118.1% specifikuar si më poshtë:

- ✓ Pasagjerë të imbarkuar nga 155000 të programuar, janë realizuar 184677, ose 119.1%.
- ✓ Pasagjerë të disimbarkuar nga 155000 të programuar janë realizuar 181477, ose 117%.

Pjesën më të madhe në përpunimin e pasagjerëve e zenë turistët ditor të ardhur me tragetet e linjës Sarandë-Korfuz-Sarandë në grupe turistike me lista të mbyllura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Ky fluks i madh turistësh ditor, ka plotësuar numrin e pasagjerëve të krijuar nga anulimi i ardhjes së trageteve cruiz.

Realizimi i të ardhurave sipas burimeve të krijimit, për vitin 2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3 “Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2022”. në 000 lekë

Nr	Treguesit	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	76,000	91,228	120
a	Nga përpunimi i trageteve	69,000	82,923	120
b	Të ardhura të tjera (shërbime portuale)	7,000	8,305	119

Siç shihet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2022, Sigurimi i “të ardhurave gjithsej” është si rezultat i realizimit të të ardhurave nga zërat “përpunimi i trageteve” në masën 120.2 %, ku përfshihet përpunimi i pasagjerëve me tragetet e linjës dhe atyre turistike.

Këtë vit pavarësisht anulimit të ardhjes së trageteve të mëdha Cruis, Porti ka përpunuar 101 tragete turistike të kapaciteteve të mesme dhe të vogla nga të cilat edhe 11 cruiz.

Po kështu, për vitin 2022 janë përpunuar 767 jahte, veliera, etj, pavarësisht kapaciteteve të limituara që ka porti për akostimin në kalatë të mjeteve të vogla lundruese turistike.

Në zërin të “ardhura të tjera” realizuar në masën 118.6 %, përfshihen të ardhurat nga akostimi në kalatë të gjitha mjeteve lundruese si edhe nga shërbimet e tjera portuale si furnizimi me ujë, energji, shërbime mjedisore, etj.

Investimet janë realizuar në masën 29.7 %, nivel i ulët i realizimit të investimeve që flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese për realizimin e investimeve të programuara.

-Programi ekonomik dhe financiar për vitet 2018-2022, nuk është përgatitur bazuar në rezultatet e arritura në vitin paraardhës si edhe në nivelin ekonomik financiar të shoqërisë për të realizuar investimet e parashikuara, niveli i ulët i realizimit të investimeve tregon se parashikimet në programin ekonomik nuk janë të sakta dhe nuk janë kryer referuar rezultateve të arritura një vit më parë dhe analizave ekonomike për drejtimin e shoqërisë. Këto rezultate flasin për një punë të dobët të strukturave drejtuese në realizimin e objektivave të përcaktuara.

-Nuk kryhet bashkërendimi i punës së degëve e specialistëve brenda stafit të shoqërisë. Programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, megjithëse ka ndjekur procedurat dhe afatet e përcaktuara në udhëzimin përkatës, nuk ka pasqyruar tregues të mirë-harmonizuar midis tyre.

Në disa zëra të llogarive për shpenzimet operative dhe të ardhurat për mallra dhe shërbime konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar. Në disa zëra të llogarive konstatohet angazhim më i ulët gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar. Në të dy rastet, situata tregon për një planifikim jo të saktë në fillim të vitit dhe shpenzimin më të madh për disa llogari në krahasim me llogari të tjera pavarësisht ruajtjes në total të limitit për angazhim fondi.

-Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se volumi i punës ka ardhur në rënie, për sa i përket përpunimit të mallrave (deri në momentin që i ka kaluar koncensionarit) ndërsa në përpunimin e pasagjerëve ka ardhur në rritje të ndjeshme. Konstatohet se programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, megjithëse ka ndjekur procedurat dhe afatet përcaktuar në udhëzimin përkatës, nuk ka pasqyruar tregues të harmonizuar mirë midis tyre dhe nuk ka pasur planifikim të saktë të treguesve ekonomikë dhe financiar të bazuar në rezultatet e viteve paraardhëse.

-Shoqëria në aspektin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i programit dhe detyrimet e tjera tregtare dhe ato mbështetëse, nuk ka bërë një punë të vlerësueshme në realizimin e tyre, ndjekja e shpenzimeve duhet ndjekur me përgjegjësi si për zërat me devijime nga plani ashtu edhe për shpenzimet të cilat janë në masën 100% me planifikimin, pasi shpenzimet duhet të kryhen vetëm për qëllime të domosdoshme të aktivitetit.



Titulli i Gjetjes:	Mosrealizimi i investimeve dhe tejkalim shpenzimesh
Situata:	Investimet për vitin 2018, janë realizuar në masën 72 %, për vitin 2019 janë realizuar në masën 30.8 %, për vitin 2020 janë realizuar në masën 73.5 %, për vitin 2021 nuk janë realizuar megjithëse janë programuar në vlerën 6,200 mijë lekë dhe për vitin 2022 janë realizuar në masën 29.7 %. Niveli i ulët i realizimit të investimeve flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese për realizimin e investimeve të programuara. Programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, megjithëse ka ndjekur procedurat dhe afatet përcaktuar në udhëzimin përkatës, nuk ka pasqyruar tregues të harmonizuar mirë midis tyre dhe nuk ka pasur planifikim të saktë të treguesve ekonomikë dhe financiar të bazuar në rezultatet e viteve paraardhëse si edhe në mundësitë reale të shoqërisë. Shoqëria në aspektin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i programit dhe detyrimet e tjera tregtare dhe ato mbështetëse, nuk ka bërë një punë të vlerësueshme në realizimin e tyre, niveli i realizimit të shpenzimeve duhej ndjekur me përgjegjësi si për zërat me devijime nga plani ashtu edhe për shpenzimet të cilat janë në masën 100% me planifikimin, pasi shpenzimet duhet të kryhen vetëm për qëllime të domosdoshme të aktivitetit.
Kriteri:	Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Programi ekonomik (treguesit e programuar).
Ndikimi/Efekti:	Nuk janë arritur treguesit e programuar për Investime si edhe tejkalim i shpenzimeve.
Shkaku:	Parashikime më të larta krahasuar me mundësitë e shoqërisë.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Programim Investimeve dhe Teknikës, të marrin masa për hartimin e programeve ekonomike bazuar në treguesit e realizuar në vitet e mëparshëm, në mundësitë dhe kapacitetet reale të shoqërisë dhe analizave ekonomike, të nivelit të investimeve, nivelit të shpenzimeve, numrit të punonjësve, etj, zëra të cilët duhen rishikuar dhe analizuar referuar uljes së volumit të punës, pasi shoqëria nuk kryen përpunim mallrash por vetëm pasagjerë, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara për drejtimin e shoqërisë.

4. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve. Rekrutimet dhe largimet nga puna.

Në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë për marrëdhëniet e punës dhe pagave, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e shoqërisë.
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.
- Statuti i Shoqërisë.
- Vendimet e marra për miratimin e strukturës dhe përcaktimin e pagave.
- Dosjet e punonjësve.



- Zbatimi i kriterëve për rekrutimin në punë të punonjësve.
- Vendimet e marra për shpërblimin vjetor, etj.
- Respektimi i strukturës organike të miratuar për periudhën objekt auditimi.
- Respektimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e punonjësve.
- Rregullshmeria e llogaritjes dhe shlyerjes së detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve, etj.
- Rregullshmëria e pagesave për punë jashtë kohës normale, shtesat mbi pagë, orët jashtë orarit.
- Rregullshmëria në krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.
Dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma për fatkeqësi, etj.
- Rregullshmëria e pranimit dhe pagesave të punëtorëve sezonale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Statuti, Struktura dhe niveli referues i pagave për vitet 2018-2022

Sipas Statutit të miratuar me nr. 4063/1 Prot., datë 15.06.2012, për miratimin e statutit të shoqërisë aksionare “Porti Detar” SHA Sarandë, ligji mbi të cilën operon “Porti Detar” SHA Sarandë, është Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me aksionar Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe organe drejtuese Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Në shoqërinë “Porti Detar” SHA, Sarandë, marrëdhëniet e punës rregullohen në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar. Statuti i shoqërisë është ndryshuar në datën 13.10.2020, me vendimin e Asamblesë nr.7, datë 23.09.2020 dhe me vendimin e Asamblesë nr.14, datë 04.03.2021.

Për Vitin 2018, Me vendimin nr.10, datë 08.09.2017 të Këshillit Mbikëqyrës, është miratuar struktura organizative e Porti Detar Sarandë, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe nivelit arsimor. Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune. Numri punonjësve i miratuar është 49 persona.

Për Vitin 2019, Me vendimin nr.5, datë 07.04.2019 të Këshillit Mbikëqyrës, është miratuar struktura organizative e Porti Detar Sarandë, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe nivelit arsimor. Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 6 pozicione pune. Numri punonjësve i miratuar është 49 persona.

-Rregullorja e Brendshme është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 07.04.2019.

Për Vitin 2020, Me vendimin nr.3, datë 04.08.2020 të Këshillit Mbikëqyrës, është miratuar struktura organizative e Porti Detar Sarandë, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe nivelit arsimor. Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune si edhe me Vendimin nr.11, datë 30.10.2020 është ndryshuar struktura numri punonjësve nga 56 në 49. Numri punonjësve i miratuar është 49 persona. Numri mesatar i punonjësve në fakt ka qenë 49, pra struktura rezulton e realizuar 100%. Për muajin Shtator struktura nga 59 punonjës të miratuar ka funksionuar në fakt me 52 punonjës dhe për periudhën tjetër të vitit ka funksionuar me 49 punonjës. Përveç numrit të punonjësve të mësipërm për vitin 2020 janë miratuar 6 punonjës me kontratë të përkohshme (punëtor sezonal), me pozicion pune 3 punonjës ngarkim shkarkimi, 1 sanitare dhe 2 punonjës për sistemim arkive (kërkesë e DPA). Rregullorja e Brendshme është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.6, datë 04.08.2020 si edhe ndryshuar me Vendimin nr.14, datë 30.10.2020.



Për Vitin 2021, Me vendimin nr.16, datë 30.12.2021 të Këshillit Mbikëqyrës, është miratuar struktura organizative e Porti Detar Sarandë, sipas kritereve të pozicionit të punës dhe nivelit arsimor. Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune. Numri i punonjësve i miratuar është 49 persona. Numri mesatar i punonjësve në fakt ka qenë 49, pra struktura rezulton e realizuar 100 %. Për vitin 2021, janë miratuar 8 punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), me pozicion pune sanitare dhe punonjës për sistemim arkive (kërkesë e DPA dhe Forcës së Sigurisë). Punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), nuk janë miratuar me akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës, por janë miratuar me vendimet e miratimit të Planit të Zhvillimit dhe buxhetit vjetor të shoqërisë. Plane, të cilat janë të miratuar si nga Këshilli Mbikëqyrës dhe MFE. Për secilin vend pune sipas strukturës së mësipërme janë të miratuara detyrat përkatëse në rregulloren e brendshme, e cila është e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Rregullorja e Brendshme është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.18, datë 30.12.2021.

Për Vitin 2022, Me vendimin nr.7, datë 01.07.2022 të Këshillit Mbikëqyrës, është miratuar struktura organizative e Porti Detar Sarandë, sipas kritereve të pozicionit të punës dhe nivelit arsimor. Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune. Numri i punonjësve i miratuar është 49 persona. Rregullorja e Brendshme është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.9, datë 01.07.2022, është hartuar në mbështetje të Ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare me ndryshimet përkatëse, Statusit të Shoqërisë Anonime “Porti Detar” SHA Sarandë, Kodit të Punës, Kodit Civil nenet 686-703.

Për Vitin 2023, Me vendimin nr.20, datë 28.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës, është miratuar struktura organizative e Portit Detar Sarandë, sipas kritereve të pozicionit të punës dhe nivelit arsimor. Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune. Numri i punonjësve i miratuar është 49 persona.

-Numri i miratuar në strukturë për periudhën objekt auditimi është respektuar, por numri mesatar i punonjësve për vitet 2018, 2019 dhe 2021, rezulton me tejkallim 4-5 punonjës, si pasojë e rekrutimit të punonjësve me kontratë në periudhën e verës.

-Nga viti 2018 - 2022, baza ligjore e përdorur për përcaktimin e niveleve referuese të pagave për pozicionet e punëve mbështetëse janë Vendimet nr. 589, datë 17.07.2013 dhe nr. 717, datë 23.06.2009. Këto baza ligjore përdoren për përcaktimin e niveleve referuese të pagave në institucionet buxhetore dhe SHA “Portit Detar” Sarandë, nuk është institucion buxhetor dhe në këto kushte nuk mund të përdorë lidhjet e përcaktuara në këtë legjislacion. Vendimet nuk korrespondojnë me natyrën e shoqërisë.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligji nr. 791 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar si dhe ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” neni 6, pika 1, germa (a).

-Struktura dhe niveli i pagave paraqitet me pozicione pune për 49 të punësuar. Struktura jep të dhëna në vlerë për shtesën për vjetërsi e cila i korrespondon personave të punësuar në shoqëri. Nga auditimi i kontratave individuale të punës rezulton se për personat objekt auditimi aktualisht të punësuar pranë Portit Detar Sarandë, nuk janë përcaktuar në kontratë të gjithë elementët përbërës të pagës por vetëm paga bruto e punonjësit, në kundërshtim me Ligjin nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, Neni 21-Forma e kontratës së Punës, Pika 3h si dhe VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit”

-Struktura e miratuar me vendimin nr. 20, datë 28.12.2022, përveç nivelit arsimor nuk pasqyron kërkesat mbi profesionin sipas vendit të punës, niveli arsimor është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune dhe për forcën e sigurisë ku kërkohet sipas udhëzimit.

-Janë audituar procedurat e punësimit për 7 persona të punësuar për periudhën objekt auditimi dhe rezulton se në të gjitha rastet e marra në shqyrtim punësimi kryhet në bazë të Ligjit të Nxitjes së Punësimit nr. 7995, datë 20.09.1995 (i ndryshuar), neni 21 “Detyrimi për të raportuar” pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Sarandë, ku fillimisht kryhet deklarimi i vendeve të lira të punës që ka institucioni dhe më pas bëhet deklarimi për plotësimin e vendeve të lira të punës të institucionit me të dhënat përkatëse të personave të punësuar. Gjithashtu, procedura e punësimit mbështetet në nenin 19, pika 1 të Kodit të Punës “*Punëdhënësi punëson në mënyrë të drejtpërdrejt punëmarrësin*” ndryshuar me Ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 i cili citohet në Urdhrin e Brendshëm të Emërimit për punëmarrësin.

Për periudhën objekt auditimi, janë kryer punësime dhe largime sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 14 Lëvisjet e punonjësve për periudhën e auditimit

Viti	Punësime	Largime	Procese Gjyqësore
2018	3	2	1
2019	2	4	
2020	6	10	
2021	6	4	
2022	4	4	

Burimi: Të dhënat e shoqërisë

Për periudhën objekt auditimi, është larguar nga puna z. G.XH, me detyrë prerës biletash. Ky punonjës, ka hapur proces gjyqësor për të cilin është marrë **1 vendim i formës së prerë** në vitin 2019 për dëmshpërblim në shumën **556,300 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar për shoqërinë**.

Në lidhje me shpërblimin e punonjësve për rezultatet e fundvitit për:

-*Vitin 2018*, me Urdhrin e Brendshëm nr.78, datë 31.07.2019, Drejtori i “Portit Detar” SHA Sarandë, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 11.10.2019, ka shpërndarë shpërblim për punonjësit e shoqërisë një pagë mujore pas daljes së rezultatit vjetor të vitit *2018 në shumën 2,632,691 lekë në referencë të Kodi i Punës, Neni 114 - Shpërblimi (Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996)*.

-*Vitin 2019*, me Urdhrin e Brendshëm nr. 122, datë 14.12.2020, Drejtori i “Portit Detar” SHA Sarandë, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 11.10.2019 dhe vendimit të Asamblesë nr. 17874, datë 15.10.2020, është vendosur shpërndarja e shpërblimit për punonjësit e shoqërisë një pagë mujore pas daljes së rezultatit vjetor të vitit *2019, në referencë të Kodi i Punës, Neni 114 - Shpërblimi (Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996)*. Drejtoria e Shoqërisë ende nuk ka shpërndarë masën e shpërblimit si pasojë e mbylljes nga Pandemia Covid-19.

-*Për vitet 2020 dhe 2021*, nga Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës nuk janë dhënë shpërblime për punonjësit pasi shoqëria ka dalë me rezultat negativ.

-*Vitin 2022*, ende nuk është nxjerrë rezultati financiar i shoqërisë dhe nuk janë shpërndarë shpërblime.

Me urdhrin e drejtorit nr. 99, datë 21.12.2022 dhe vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.18, datë 22.09.2022 është dhënë shpërblim për punonjësit në masën 20,000 lekë për performancë dhe arritje të rezultateve të kënaqshme gjatë vitit 2022.

Administrimi i dosjeve të punonjësve.



Lidhur me këtë pikë u auditua rregullshmëria e mbajtjes dhe administrimit të regjistrit qëndror të personelit, rregullshmëria e krijimit dhe administrimit si dhe përmbajtjen e dosjes së personelit. Për këtë nga 12 punonjës të emëruar rishtas, u përzgjedhën 7 dosje personeli duke përfshirë gjithë periudhën objekt auditimi për të testuar respektimin e kriterëve të saktësisë konform VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, nga ku rezultoi se regjistri është i plotësuar me të gjitha të dhënat e nëpunësve, konform VKM dhe dosjet e nëpunësve, janë të plotësuara me dokumentacionin e përcaktuar në Kreun II, pika 1 të VKM së.

Respektimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e punonjësve për punë jashtë kohës normale, shtesat mbi pagë, orët jashtë orarit.

Në lidhje me evidentimin e pjesëmarrjes në punë, saktësinë e përlllogaritjes së elementëve të pagës, ndalesat mbi pagë dhe derdhja e tyre në llogari, u auditua me zgjedhje dokumentacioni i muajve Janar-Mars 2018, Qershor-Gusht 2019, Shkurt, Shtator, Dhjetor 2020 dhe Janar, Qershor, Nëntor 2021 dhe Nëntor - Dhjetor 2022.

-Listëpagesat e punonjësve, janë hartuar me të gjithë elementët e nevojshëm (emër, mbiemër, emërtesa sipas strukturës, ditë pune, kategoria/klasa, paga e grupit, raportet, shtesat e pagës për vjetërsi në punë, shtesat për vështirësi, ndalesat për tatim page, sig.shoqërore, shëndetësore, etj). Listëpagesat janë mbështetur në listëprezencat mujore dhe nuk rezultojnë të ketë mospërputhje. Informacioni i dërgohej Zyrës së Financës për të kryer veprimet, i shoqëruar rast pas rasti me shkresat për lejet vjetore, me raporte për paaftësi të përkohshme në punë, për emërime të reja etj.

Rregullshmeria e llogaritjes dhe shlyerjes së detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve, etj.

Nga auditimi i përlllogaritjeve dhe derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, në të gjitha listë pagesat e punonjësve që u përzgjedhën për periudhën objekt auditimi, u konstatua se është respektuar kufiri minimal dhe maksimal si dhe përlllogaritja dhe ndalesat si për detyrimet që ka punëdhënësi ndaj organeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore dhe ato që ka punëmarrësi, janë llogaritur saktë në zbatim të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar. Për çdo muaj detyrimet tatimore dhe sigurimeve shoqërore shëndetësore janë raportuar saktësisht dhe brenda afateve ligjore pranë institucioneve përkatëse.

Rregullshmëria në krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë. Dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

Për periudhën objekt auditimi shoqëria ka planifikuar shpenzime në zërin “Fondi i veçantë” i cili është përdorur për:

- Shpërblim për daljen në pension pleqërie për 1 punonjës në masën e një page mujore.
- Për rezultate të mira në punë.
- Për dhënie ndihme ekonomike.
- Ndihmë ekonomike për rast fatkeqësie.

Pagesat për shpërblime janë dhënë bazuar në Urdhërat e Brendshëm rast pas rasti, në përputhje me pikën 7, gërmën c, të VKM nr.493, datë 06.07.2011 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” si dhe Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për çdo rast.



Titulli i Gjetjes:	Përcaktim i nivelit të pagave dhe strukturës
Situata:	<p>Nga viti 2018 - 2022, baza ligjore e përdorur për përcaktimin e niveleve referuese të pagave për pozicionet e punëve mbështetëse, janë Vendimet nr. 589, datë 17.07.2013 dhe nr. 717, datë 23.06.2009. Kjo bazë ligjore përdoret për përcaktimin e niveleve referuese të pagave në institucionet buxhetore dhe “Portit Detar” SHA Sarandë, nuk është institucion buxhetor, pra në këto kushte nuk mund të përdorë lidhjet e përcaktuara në këtë legjislacion pasi vendimet nuk korrespondojnë me natyrën e shoqërisë.</p> <p>Struktura dhe niveli i pagave paraqitet me pozicione pune për 49 të punësuar, Struktura jep të dhëna në vlerë për shtesën për vjetërsi e cila i korrespondon personave të punësuar në shoqëri.</p> <p>Nga auditimi i kontratave individuale të punës nga viti 2018-2022, rezulton se për personat objekt auditimi aktualisht të punësuar pranë Portit Detar Sarandë, nuk janë përcaktuar në kontratë të gjithë elementët përbërës të pagës por vetëm paga bruto e punonjësit.</p> <p>Për vitin 2021, janë miratuar 8 punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), me pozicion pune sanitare dhe punonjës për sistemim arkive (kërkesë e DPA dhe Forcës së Sigurisë). Punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), nuk janë miratuar me akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës, por janë miratuar me vendimet e miratimit të Planit të Zhvillimit dhe buxhetit vjetor të shoqërisë. Viti 2021, rezulton me tejkalim 4-5 punonjës, si pasojë e rekrutimit të punonjësve me kontratë në periudhën e verës.</p> <p>Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune, po kështu edhe struktura e miratuar me vendimin nr.20, datë 28.12.2022, përveç nivelit arsimor nuk pasqyron kërkesat mbi profesionin sipas vendit të punës, niveli arsimor është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune dhe për forcën e sigurisë ku kërkohet sipas udhëzimit.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligji nr. 791, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, neni 6, pika 1a. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, neni 21, forma e kontratës së punës, pika 3h si dhe VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit”.
Ndikimi/Efekti:	Riskon rekrutime me profesione jashtë natyrës së punës.
Shkaku:	Nuk është zbatuar legjislacioni.
Rëndësia:	E Mesme.
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për përcaktimin në strukturë të nivelit arsimor të çdo kategorie punonjësish sipas kërkesave të vendit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	të punës, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe realizimin e objektivave të shoqërisë në nivele cilësore.
--	--

Titulli i Gjetjes:	Efekt negativ, largim padrejtë nga puna (vendim gjyqësor)
Situata:	Për periudhën objekt auditimi, është larguar nga puna z. G.XH, me detyrë prerës biletash. Ky punonjës ka hapur proces gjyqësor për të cilin është marrë 1 vendim i formës së prerë në vitin 2019, për dëmshpërblim në shumën 556,300 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar për shoqërinë.
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Ulje e të ardhurave të shoqërisë.
Shkaku:	Largim i padrejte nga puna.
Rëndësia:	E Mesme.
Rekomandim:	Këshilli Mbikqyrës i Portit Detar SHA Sarandë, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive nga Strukturat Drejtuese, lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve.
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.

Titulli i Gjetjes:	Shpërndarja e shpërblimit
Situata:	Për vitin 2019, me Urdhrin e Brendshëm nr. 122, datë 14.12.2020, Drejtori i SHA “Portit Detar” Sarandë, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 11.10.2019 dhe vendimit të Asamblesë nr.17874, datë 15.10.2020 ka vendosur shpërndarjen e shpërblimit për punonjësit e shoqërisë në vlerën e një page mujore pas daljes së rezultatit vjetor të vitit 2019. Drejtoria e Shoqërisë ende nuk ka shpërndarë masën e shpërblimit si pasojë e mbylljes nga Pandemia Covid-19.
Kriteri:	Kodi i Punës, Neni 114 - Shpërblimi (ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996), Ligjin nr. 10405 datë 24.03.2011 “Për kompetencat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve” neni 6 pika b.
Ndikimi/Efekti:	Ndikon në performancën në punë
Shkaku:	Pandemia covid-19
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrin masa që shpërndarja e shpërblimeve për punonjësit të kryhet në bazë të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë, me qëllim motivimin e punonjësve për arritjen e rezultateve pozitive në punë, respektimin e kërkesave të Kodit të Punës duke ndikuar në rritjen e performancës pozitive të treguesve ekonomiko-financiar të shoqërisë.



5. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve.

Për mbajtjen e evidencës kontabile, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Organizimi i mbajtjes, azhornimit, regjistrimit kronologjik të transaksioneve në ditarë dhe librat e kontabilitetit.
- Rregullshmëria e raportimit financiar. Bilanci kontabël dhe dhënia e opinionit për saktësinë dhe vërtetësinë e posteve të tij dhe pasqyrave financiare.
- Rregullshmëria e dokumentimit të kërkesave për arkëtim dhe masat e marra për arkëtimin e tyre.
- Rregullshmëria e dokumentimit të detyrimeve financiare të prapambetura në kontabilitet.
- Rregullshmëria e evidentimit dhe pasqyrimin të Aktiveve afatgjata materiale të institucionit në regjistrin e asetëve dhe në pasqyrat financiare të tij.
- Rregullshmëria e kryerjes së inventarizimit fizik të aktiveve, dokumentimit të marrjes në dorëzim të aktiveve dhe lëvizjeve të tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

“Porti Detar” SHA Sarandë, është një shoqëri aksionare e themeluar më 20.10.2000 me kohëzgjatje pa afat. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë është aksionare me 100% të aksioneve me vlerë nominale 440.399.000 lekë, i cili përbën 440.399 aksione me vlerë 1,000 lekë secili. Objekti i shoqërisë është ngarkime, shkarkime portuale dhe shërbime të tjera.

Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile është në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit.

SHA “Porti Detar” Sarandë, për mbajtjen e llogarive kontabile, përdor sistemin e kompjuterizuar. Ditarët regjistrohen në mënyrë kronologjike në programin “Alfa”. Regjistrimet kontabël janë pajisur me evidencë mbështetëse që sigurojnë besueshmërinë e tyre dhe regjistrimet kontabël janë bazuar në dokumentacionin bazë. Shumat në bilanc janë të barabarta me mbetjet e llogarive që mbahen në ditarë dhe në librin e madh, totalët e aktivitetit dhe pasivitetit janë të barabarta. Regjistrat janë mbajtur në gjuhën shqipe dhe vlerat në njësinë monetare shqiptare “lekë”. Veprimet në valutë janë konvertuar në lekë, sipas standardit kontabël përkatës. Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë, janë mbajtur dhe kontabilizuar sipas metodës së konstatimit të të drejtave dhe detyrimeve.

Shoqëria ka plotësuar pasqyrat e raportimit financiar ku janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse për pozicionet e llogarive dhe veprimet ekonomiko financiare për vitet 2020 dhe 2021.

Pasqyrat Financiare për periudhën objekt auditimi janë mbyllur më datë 30.03.2022, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 25/2018, neni 22 “Depozitimi dhe publikimi i pasqyrave financiare”.

Pasqyrat financiare për gjithë periudhën objekt auditimi, evidentohet se janë audituar nga Auditues ligjor, të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë për vitin 2020 me shkresë nr. 2802 Prot., datë 10.02.2021 “Mbi caktimin e audituesve ligjor për pasqyrat financiare 2020” dhe për vitin 2021 me shkresën nr. 22369 Prot., datë 14.12.2021 “Mbi caktimin e audituesve ligjor për pasqyrat financiare 2021”, të cilët kanë paraqitur “Raportin e Auditimit të pasqyrave financiare të PDS-së për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2020” me shkresën nr. 89/1 Prot., datë 05.04.2021 si dhe “Raport i Auditimit të pasqyrave financiare të PDS-së për periudhën 1 Janar -31 Dhjetor 2021”, me shkresën nr. 267/1 Prot., datë 26.09.2022.

Është lidhur kontratë shërbimi për auditimin e pasqyrave financiare midis Administratorit dhe Audituesit Ligjor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe Raporti i ekspertëve ligjor të pavarur, kanë kaluar për miratim në Këshillin Mbikqyrës, nga Drejtuesi i shoqërisë; dhe evidentohen të miratuara. Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr.68, datë 30.07.2022; përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë; është bërë miratimi i pasqyrave financiare dhe rezultati i shoqërisë humbja e vitit ushtrimor prej -64,208,462 lekë të sistemohen me kapitalin.

Gjithashtu, pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe Raporti i ekspertëve ligjor të pavarur, kanë kaluar për miratim në Këshillin Mbikqyrës, nga Drejtuesi i shoqërisë; dhe evidentohen të miratuara. Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr.92, datë 26.08.2022 përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, është bërë miratimi i pasqyrave financiare dhe rezultati i shoqërisë humbja e vitit ushtrimor prej -51,084,025 lekë të sistemohen me kapitalin.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike dhe parimit të drejtave të konstatuara dhe janë të paraqitura në monedhë vendase “lekë”, paraqitja e tyre është në përputhje me formatin SKK-2.

*Parimet kontabile, që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:
Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve.*

-Të ardhurat dhe shpenzimet janë njohur sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat janë njohur, kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet. Të ardhurat janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtueshme. Shpenzimet janë njohur atëherë, kur ato janë siguruar nga të tretët në të njëjtin ushtrim kontabël të lidhur me realizimin e të ardhurave.

-Fluksi parasë është paraqitur me metodën indirekte.

-Tatimi mbi fitimin e pagueshëm për vitin ushtrimor bazohet mbi fitimin e tatueshëm. Norma aktuale e tij është 10%, e cili ka lidhje me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

-Kërkesat për tu arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afat shkurtër dhe afatgjatë, në para janë regjistruar në bilanc sipas vlerës së faturës së shitjes dhe e përfaqësuar me inventaret e fundvitit.

-Huatë e marra, furnitoret, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afat shkurtër dhe afatgjatë, për tu shlyer në para, në përgjithësi janë mbajtur me koston e amortizuar në bilanc, pasivët financiarë afatshkurtër janë mbajtur në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme, të vërtetuar nga një faturë apo kontratë.

-Aktivet afat gjatë materiale janë bazuar me kosto ato në bilanc janë paraqitur kosto minus amortizimin e akumuluar. Analiza e posteve të bilancit dhe pasqyrat financiare sipas viteve paraqitet si më poshtë:

Rregullshmëria e evidentimit dhe pasqyrimit në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të aktiveve.

Në shoqëri, është organizuar struktura përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin periodik e vjetor të realizimit të treguesve ekonomik dhe pasqyrave financiare. Kjo strukturë evidentohet se është organizuar në nivel zyre, me përgjegjës zyre, llogaritar/arketar. Struktura ka të përcaktuar dhe miratuar në rregulloren e brendshme të funksionimit të shoqërisë, misionin, detyrat funksionale e përgjegjësite, varësine dhe mbikqyrjen, si dhe format e raportimit për mjedisin menaxherial dhe organet e tjera. Punonjësit kanë azhurnim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të mbajtjes të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, me dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe me udhëzimet specifike në fushën e financave. Për periudhën objekt auditimi nga struktura përgjegjëse e shoqërisë është realizuar mbajtja e kontabilitetit, kontrolli i dokumentacionit, monitorimi i hallkave si dhe raportimi i treguesve ekonomik dhe pasqyrave financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Mbajtja e kontabilitetit dhe raportimi i pasqyrave financiare.

Në drejtim të mbajtjes të kontabilitetit në perputhje me kërkesat e ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, konstatohet se nga njësia dhe zyra e financës është mbajtur, administruar dhe përpunuar rregullisht dokumentacioni ekonomik financiar dhe kontabël konform kërkesave ligjore. Në mbajtjen e kontabilitetit dhe regjistrimin e veprimeve ekonomiko-financiare, është ruajtur vijimësia e pasqyrimin në mënyrë kronologjike e ngjarjeve ekonomiko-financiare sipas parimit “të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara”. Është ruajtur krahasueshmëria e të dhenave midis dy periudhave raportuese, është ruajtur e njëjta politikë kontabël për të gjithë periudhën ushtrimore duke respektuar klasifikimin kontabël të llogarive në paraqitjen e aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë. Aktivet janë njohur me vlerën fillestare dhe janë amortizuar gjatë kohës së përdorimit me normat e amortizimit të përdorura për entitetet portuale.

Sipas pasqyrave financiare të raportuara për periudhën ushtrimore kontabël të vitit 2021 të mbyllur dhe periudhën e vitit 2020, gjendja pasurore, detyrimet dhe kapitali i shoqërisë “Porti Detar” SHA Sarandë dhe ndryshimet përkatëse paraqiten si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar

në lekë

Nr	AKTIVET	Viti 2021	Viti 2020	Ndryshimi
	Aktivët afatshkurtra			
1	Mjetet monetare	68,987,084	77,211,469	-8,224,385
	1. Në bankë	68,950,796	77,211,162	8,260,366
	2. Në arkë	36,288	20,307	15,981
2	Investime:	0	0	0
3	Të drejta të arkëtueshme:	43,955,525	61,015,480	-17,059,961
	1. Nga aktiviteti i shfrytëzimit	15,493,546	17,876,624	-2,383,078
	2. Nga njësitë ekonomike brenda grupit			
	3. Nga njësitë eko ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4. Të tjera (TVSH, tat.f.it,e D.C)	28,461,979	43,138,862	-14,676,883
	5. Kapitali i nënshkruar i papaguar			
4	Inventarët:	93,268	1,115,611	-1,022,343
	1. Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme(inventar në përdorim)	93,268	1,115,611	-1,022,343
	2. Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte			
	3. mallra			
5	Shpenzime të shtyra	404,667	404,667	0
6	Të arkët. nga të ardhurat e konstatuara			
I	Totali Aktive Afatshkurtëra	113,440,544	139,747,233	-26,306,689
1	Aktive afatgjate.			
2	Aktive financiare	0	0	
3	Aktivët materiale:	1,137,528,546	1,139,675,386	-2,146,840
	Toka dhe ndërtesa	1,091,937,052	9,142,887	-1,082,794,165
	Impjante dhe makineri	9,342,805	9,142,887	199,918
	Të tjera Instalime dhe paisje informatike			
	Të tjera Instalime dhe paisjeInv.Ekonomik	3,560,216	5,583,619	-2,023,403
	Parapagime per AM dhe në proces	32,688,473	3,288,504	29,399,969
4	Aktive biologjike	0	0	0
5	Aktive jo materiale:	1,140,035	1,781,306	-641,271
	Të drejta dhe akte të ngjashme(cert.sig & mjedis)	1,140,035	1,781,306	-641,271
II	Totali Aktive Afatgjata	1,138,668,581	1,141,456,692	-2,788,111
III	Aktive Totale	1,252,121,530	1,281,203,925	-29,082,395

Nr	PASIVET	Viti 2021	Viti 2020	Ndryshimi
	Detyrime dhe Kapitali			
1	Detyrime afatshkurtëra:	6,753,833	4,801,445	1,952,388
	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	5,003,917	3,345,947	1,657,972
	Të pagueshme ndaj sigurimeve shoq.shëndetsore	1,044,078	748,288	295,790
	Të pagueshme për detyrimet tatimore	705,836	707,210	-1,374
	Totali i detyrimeve afatshkurtëra	6,753,833	4,801,445	1,952,388
2	Detyrime afatgjata:	298,935,253	278,890,565	20,036,837
	Të tjera të pagueshme(grande dhe të ardhura të shtyra)	298,927,402	278,890,565	20,036,837



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	Provizjone:	7,851	7,851	0
	<i>Provizjone të tjera</i>	7,851	7,851	0
	Totali i detyrimeve afatgjata	298,935,253	278,898,416	20,036,837
I	Totali Detyrimeve	305,689,086	283,699,861	21,989,225
	Kapitali dhe Rezervat	1,061,712,526	1,061,712,526	0
	Kapitali i nënshkruar	440,399,000	440,399,000	0
	Primi i lidhur me kapitalin	345,833,410	345,833,410	0
	Rezerva rivlerësimi	0	0	0
	Rezerva të tjera:	275,480,116	275,480,116	0
	Rezerva ligjore	11,370,064	11,370,064	0
	Rezerva statutore	145,297,783	145,297,783	0
	Rezerva të tjera (rivlerësimi)	118,812,269	118,812,269	0
	Fitimi i pashpërndarë (Humbja)	-64,208,462	0	-64,208,462
	Fitimi/humbja e vitit	-51,084,024	-64,208,462	13,124,438
II	Totali i kapitalit	946,420,040	997,504,064	-51,084,024
III	Totali i Det. dhe Kapitalit	1,252,109,125	1,281,203,925	-29,094,800

Nga analiza mbi raportimin financiar, evidentohet si më poshtë:

Aktivët e shoqërisë.

Mjetet monetare paraqiten me analizë, për gjendjen, bankat, dhe valutës:

në lekë

Nr	Mjete monetare	31.12.2021	31.12.2020
I	Në arkë	36,288	20,287
II	Në bankë	68,950,796	77,191,182
	Llogarirrjedhese në Leke	13,858,831	17,504,984
	Llogarirrjedhese në monedhë	55,091,965	59,686,198
	Totali	68,987,084	77,211,469

Shoqëria ka të evidentuar me analizë emërtimet e bankave dhe shumat përkatëse të konfirmuara në datën 31.12.2021 të gjendjes në llogari në vlerën 68,950,796 lekë, konkretisht:

Llogari rrjedhse në lekë për vlerën totale 13,858,831 lekë, paraqitet me analizë për gjendjet respektive në banka.

Llogari rrjedhse në Euro për vlerën totale 343,876 Euro, me analizë për bankat respektive dhe konvertuar me kursin 120.76 leke/1 euro, raportuar në pasqyrat financiare për vlerën totale në lekë për 41,526,465 lekë.

Llogari rrjedhse në USD për vlerën totale 127,328 USD, me analizë për bankat respektive dhe konvertuar me kursin 106.54/1 USD, raportuar në pasqyrat financiare për vlerën totale në lekë për 13,565,525 lekë.

Të drejta të arkëtueshme. Evidentohet se zyra e kontabilitetit ka mbajtur me analizë, të drejtat e arkëtueshme për të cilat paraqitet kjo situatë:

në lekë

Nr	Të drejtat e arkëtueshme	31.12.2021	31.12.2020
I	Nga klientë	15,493,546	17,876,624
II	Të tjera të arkëtueshme	28,461,976	43,138,862
	Totali	43,955,522	61,015,486

Krahasuar me një vit më parë, të drejtat e arkëtueshme në total paraqiten me ulje për vlerën 17,059,961 lekë.

Paraqitet e analizuar vlera e raportuar në aktive “Klientë” për 15,493,546 lekë, e cila përbëhet nga 71 klientë të krijuara për më shumë se një vit. Vlera prej 10,223,646 lekë, i përket viteve të kaluara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Grupi i auditimit konstaton se krahasuar me një vit më parë ky zë ka rënie në vlerën 2,383,078 lekë, që tregon se nga shoqëria janë bërë përpjekje për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitore.

Në grupin Të tjera të arkëtueshme, evidentohet se:

Grupi “Të tjera të arkëtueshme” në fund të vitit 2021 paraqitet për vlerën 28,461,976 lekë nga 43,138,862 lekë në fund të vitit 2020 dhe me rënie për 14,676,883 lekë gjatë vitit 2021.

Rënia në këtë grup ka ardhur si pasojë e rimbursimit të TVSH në vlerën 16,326,312 lekë gjatë vitit 2021.

Grupi “Të tjera të arkëtueshme”, rezulton i raportuar me analizë, për:

Nr	Tetjeratëarkëtueshme	31.12.2021	31.12.2020
	Tatim fitimi parapaguar	5,967,917	5,967,917
	TVSH e Arkëtueshmë(Kërkesa për rimbursim)	8,946,602	23,612,859
	Tëtjeratëarkëtueshme	13,547,460	13,558,086
	Totali	28,461,976	43,138,862

Në total grupi “Të tjera të arkëtueshme”, në vitin 2021 krahasuar me një vit më parë paraqitet me rënie, në vlerën 14,676,883 lekë, në zërin kërkesa për rimbursim TVSH.

Nga analiza e mësipërme rezulton se pjesa më e madhe e kërkesave përfaqëson detyrimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve për rimbursimin e tatim fitimit të parapaguar dhe rimbursimit të TVSH-së të kreditueshme nga blerjet me TVSH. Pa ndryshime dhe e mbartur ndër vite, paraqitet zëri tatim mbi fitimin në vlerën 5,967,917 lekë dhe zëri të tjera të arkëtueshme 13,547,460 lekë.

Shuma e TVSH prej 8,946,602 lekë, e mbartur për tu rimbursuar prej vitit 2014 nuk është rimbursuar nga Drejtoria e Tatimeve Sarandë e pasqyruar në llog 445 "TVSH për tu marrë" megjithë korespondencat e vazhdueshme prej nëntorit të vitit 2014. Vlera e TVSH për tu rimbursuar prej vitit 2020 është 9,433,098 lekë.

Aktivet e raportuara në postin “Inventari”, zëri “materiale konsumi”, në krahasim me një vit më parë paraqiten me rënie për vlerën 1,022,343 lekë, nga 1,115,611 lekë, në fund të vitit 2020 në vlerën 93,268 lekë në fund të vitit 2021.

Shoqëria gjëndjen e raportuar e ka të analizuar dhe raportuar në paqyrat financiare:

Nr	Inventari	31.12.2021	31.12.2020
	Materialekonsumi	93,268	1,115,611
	Totali	93,268	1,115,611

Aktivet e raportuara në postin “Shpenzime të shtyra”, paraqitet e pa ndryshuar në vlerën 404,667 lekë.

Nr	Shpenzimetështyra	31.12.2021	31.12.2020
	Shpenzime të shtyra	404,667	404,667
	Totali	404,667	404,667

Aktivet afatgjata, paraqiten të analiza si më poshtë:

Nr	Aktiveafatgjatamateriale	31.12.2021	31.12.2020
1	Toka	474,276,600	474,276,600
2	Ndertesa	617,660,452	647,383,776
3	MakineridhePajisje	4,027,992	2,779,194
4	Mobiljedhepajisjezyre	5,800,200	4,959,459
5	Pajisje informatike	495,213	624,159
6	Mjete transporti	2,223,355	2,779,194
7	Asetenë process	32,688,473	3,288,504
	Totalii AAM	1,137,172,285	1,139,675,386
	Aktive jo Materiale	1,140,035	1,781,306
	TOTALI I AAM	1,138,668,581	1,141,456,692



Shoqëria, ka llogaritur amortizim të AAM-ve. Në përlllogaritjen e amortizimit, njësia ka përcaktuar si metode të amortizimit të AAM, metodën e amortizimit mbi bazën e vlerës së mbetur, ndërsa normat e amortizimit janë përdorur të njëjlojta me ato të përdorura për entitetet portuale e konkretisht për ndërtesat 5% e vlerës së mbetur, për kompjutera e sisteme informacioni me 25% të vlerës së mbetur dhe të gjitha AAM e tjera me 20% të vlerës së mbetur. Raportimi i AAM-ve në pasqyrën e pozicionit financiar për 2020 dhe 2021, përputhet me vlerën neto të aktiveve të raportuara në pasqyrën e lëvizjes të aktiveve dhe amortizimit.

Njësia ka evidentuar sipas grupimeve kontabël, aktivet e trupëzuara me vlerën fillestare dhe me vlerën neto si dhe ka raportuar pasqyrat përkatëse të lëvizjes dhe ndryshimit të gjendjes të aktiveve si dhe amortizimin e akumuluar.

Sipas raportimit financiar, shoqëria paraqitet në fund të vitit 2021, me gjendje në total të AAM-ve me vlerë fillestare për 1,382,664,881 lekë, blerje gjatë vitit 32,185,089 lekë, pakësim në vlerën 1,053,454 lekë (dalje makineri e shitur për skrap), nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 4,234,199 lekë, amortizimi i akumuluar në vlerën 272,390,032 lekë dhe me AAM në total me vlerë neto për 1,137,528,546 lekë.

Aktivitet jo materiale zëri “Të drejtat dhe akte të ngjashme (cert.sig & mjedis)” krahasuar me një vit më parë paraqitet me rënie në vlerën 641,271 lekë, e cila përfaqëson amortizimin e vitit.

Pasivet e shoqërisë.

Në analizë të dinamikës së detyrimeve afatshkurtëra të shoqërisë evidentohet se në fund të vitit 2021, situata paraqitet për 6,753,833 lekë nga 4,801,445 lekë në fund të vitit 2020, me një rritje prej 1,952,388 lekë. Këto përfaqësojnë detyrimet ndaj furnitorëve dhe punonjësve dhjetor 2021, detyrime këto që do të likuidohen gjatë vitit 2022.

Evidentohet se grupi “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit/furnitorë”, krahasuar me një vit më parë paraqitet me rritje për 1,657,972 lekë, nga 3,345,947 lekë në fund të vitit 2020, në 5,003,919 lekë në fund të vitit 2021.

–“Të pagueshme ndaj tatimeve dhe sig.shoq& shënd.”, në fund të vitit 2021 evidentohen me rënie në vlerën 12,683 për lekë, nga 1,056,761 lekë në fund të vitit 2020, në vlerën 1,044,078 lekë në fund të vitit 2021.

–“Të tjera detyrime” në fund të vitit 2021, evidentohen me rritje në vlerën 307,099 lekë, nga 398,737 lekë në fund të vitit 2020, në vlerën 705,836 lekë në fund të vitit 2021.

Shoqëria ka mbajtur të klasifikuar kontabilisht detyrimet si dhe me analiza për çdo llogari, me të dhëna për subjektet, shumat dhe periudhat e krijimit. Vlerat e raportuara në pasqyrat financiare në llogaritë sintetike rakordojnë me llogaritë analitike sipas grupeve.

Detyrimet Afatgjata

Shoqëria për vitin 2021, ka raportuar gjendje të detyrimeve afatgjata në zërin “të tjera të pagueshme/grande nga Buxheti Shtetit”, në fund të vitit 2021 evidentohen me rritje në vlerën 20,036,837 për lekë, nga 278,890,565 lekë në fund të vitit 2020, në vlerën 298,927,402 lekë në fund të vitit 2021.

Zëri “Provigjone” paraqitet i pa ndryshuar në vlerën 7,851 lekë.

Detyrimet totale afatgjata, në fund të vitit 2021 evidentohen me rritje në vlerën 21,989,225 lekë, nga 283,699,861 lekë në fund të vitit 2020, në vlerën 305,689,086 lekë në fund të vitit 2021. Kjo rritje ka ardhur nga detyrimi i kontratës së lidhur për rikonstrukcionin e kalatës e cila është financuar nga Buxheti Shtetit dhe do likuidohet për 3 vite.

Kapitali i shoqërisë në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 946,420,039 lekë nga 997,504,064 lekë që ishte në fillim të vitit.

Kapitali themeltar i shoqërisë, zotërohet me 100% të kuotave nga shteti dhe më 31.12.2021 ky kapital është në vlerën 1,061,712,525 lekë i cili nuk ka ndryshuar.



Primi i shoqërisë nuk ka ndryshuar, është në vlerën 345,833,410 lekë.

Rezervat, gjithashtu nuk kanë ndryshuar dhe paraqiten në vlerën totale 275,480,116 lekë, si:

- Rezerva ligjore në vlerën 11,370,064 lekë;
- Rezerva statutoare në vlerën 145,297,783 lekë;
- Rezerva të tjera (rivlerësimi) në vlerën 118,812,269 lekë.

Shoqëria në fund të vitit 2021 rezulton me një rezultat me humbje në vlerën -51,084,024 lekë në të cilin ka ndikuar situata e krijuar si pasojë e pandemisë së covidit.

Pasqyrat financiare për vitet 2020 dhe 2021, evidentohet se janë të kompletuara me anekset përkatëse për dhënien e shpjegimeve, informacione të përgjithshme si dhe shënime dhe dhënie shpjegimesh për zëra të ndryshëm.

-Vlera e llogarisë 4671 "Debitorë" në shumën 13,544,581 lekë, pasqyruar në debi përfaqëson kalimin e fondit nga Porti detar SHA, Sarandë në llogarinë e shoqërisë "D.C", Shkodër, për të cilën nga strukturat drejtuese nuk na u vu në dispozicion komunikim shkresor/ marrëveshje mbi afatet për kthimin e kësaj vlere.

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatuan mangësi në lidhje me regjistrimin e Aktiveve Afatgjata materiale, pasi bazuar në vendimin e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë datë 24.02.2020, është kërkuar nga shoqëria të regjistrohet investimi i kryer për objektin "Ndërtimi i kalatës dhe terminalit" me fondet e Bankës Botërore në vlerën 345,33,410 lekë. Shoqëria ka regjistruar këtë vlerë në Aktive Afatgjata materiale në kundërparti të zërit prime të lidhura me kapitalin. Ky zë nuk plotëson kushtet për tu konsideruar i tillë pasi primi i lidhur me kapitalin përfaqëson diferencën midis çmimit të emetimit të aksioneve dhe vlerës nominale.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Veprimet dhe ngjarjet ekonomike të ndodhura, janë regjistruar në mënyrë kronologjike dhe janë të mbështetura me dokumente urdhërues justifikuese.

-Llogaritë sintetike rakordojnë me saldot e llogarive analitike dhe aktivi i bilancit viti-2020 dhe viti-2021 është i barabartë me pasivin.

-Pasqyrat financiare për fund vitin 2020 dhe 2021, rezultojnë të mbyllura dhe me shënimet shpjeguese përkatëse nga struktura drejtuese dhe hartuese.

-Pasqyrat financiare janë raportuar rregullisht në organet tatimore dhe në organin epror të varësisë direkte.

-Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë, me rezervë për gjetjet trajtuara më sipër.

-Shoqëria nuk ka bërë një zhvlerësim për njohjen e llogarive të arkëtueshme, e cila duhet të bazohet në një analizë të plotë mbi të dhëna historike.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare",

-Ligjin nr. 92/2014, datë 28.08.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 12.

Titulli i Gjetjes:	Shoqëria nuk ka bërë një zhvlerësim për njohjen e llogarive të arkëtueshme
Situata:	Gjendja e llogarisë sintetike "Të drejta të arkëtueshme" në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 43,955,522 lekë, e cila përbëhet nga:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p>-Gjendja e llogarisë “Klientë” në vlerën 15,493,546 lekë, e cila përbëhet nga 71 klientë të krijuar për më shumë se një vit ku pjesën më të madhe e zënë detyrimet e klientëve në vitet e kaluara prej 10,223,646 lekë.</p> <p>-Gjendja e llogarisë “Të tjera të arkëtueshme”, në fund të vitit 2021 është në vlerën 28,461,979 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pjesa më e madhe e kërkesave përfaqëson detyrimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve për rimbursimin e tatim fitimit të parapaguar në vlerën 5,967,917 lekë, 2,879 lekë ndalesë për diferencë page, në vlerën 13,544,581 lekë, përfaqëson kalimin e fondit nga Porti Detar SHA Sarandë, në llogarinë e shoqërisë “D.C” Shkodër, si edhe vlerën 8,946,602 lekë që i përket TVSH së mbartur për tu rimbursuar prej vitit 2014 e pasqyruar në llog 445 “TVSH për tu marrë”. Vlera e llogarisë 445, nga 8,946,602 lekë në fund të vitit 2022 është rritur me 496,496 lekë. Vlera e TVSH për tu rimbursuar deri në fund të vitit 2022, është 9,433,098 lekë. Me gjithë korespondencat e vazhdueshme me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Sarandë, kjo vlerë ende nuk është rimbursuar.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligji nr. 92/2014, datë 28.08.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 12.
Ndikimi/Efekti:	Ulje e të ardhurave
Shkaku:	Mos zbatim i legjislacionit në fuqi
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori Ekonomik, të marrin masa duke ndjekur procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të të tretëve ndaj shoqërisë, si “Klientë” në vlerën 15,493,546 lekë dhe “të drejtave të tjera të arkëtueshme” në vlerën 28,461,979 lekë (rimbursim TVSH dhe detyrimi i shoqërisë “D.C” Shkodër), me qëllim mbledhjen e të ardhurave dhe përmirësimin e situatës financiare.

6. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për menaxhimin e aktiveve materiale, procedurat e ndjekura për inventarizimet, nxjerrjen jashtë përdorimi si dhe asgjësimin e tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

“Shoqëria Porti Detar SHA Sarandë” për vitin **2019** ka kryer inventarizimin e plotë sipas urdhërit të ngritur nga Drejtor i Përgjithëm me Nr.879Prot., datë 18.12.2019 me përbërje z. K.Sh, z. Th. Th. dhe z. P.J.

Nga komisioni i inventarizimit janë mbajtur fletë inventarizimi me sasi të kontrolluara duke u bërë krahasimi me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale por nuk janë mbajtur me znj. A.Sh person me përgjegjësi materiale e cila ka në përdorim disa nga aktivet. Në momentin e mbajtjes së flet-inventarizimeve, rezulton se nuk ka firmosur znj. A.Sh në cilësinë e përgjegjësit të materialeve.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenet 83 e 85 ku përcaktohet: “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe



dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë që: Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues”.

Me urdhërin nr. 487 Prot., datë 31.12.2020, Administratori i Shoqërisë ka krijuar komisionin e asgjësimit të aktiveve që kanë dalë jashtë përdorimit për vitin 2019 me përbërje znj. M.J, z. P.J dhe znj. D.K.

-Porti Detar SHA Sarandë, për vitin 2020, ka kryer inventarizimin e plotë sipas urdhërit të ngritur nga Titullari me nr. 450 Prot., datë 04.12.2020 me përbërje z. K.B, znj. H.I dhe z. Th.M.

-Me urdhërin nr. 450/2 Prot., datë 04.12.2020, Drejtori i Shoqërisë ka krijuar komisionin e asgjësimit të aktiveve që kanë dalë jashtë përdorimit për vitin 2020 me përbërje znj. D.K, znj. M.J dhe znj. F.J.

Me urdhërin nr. 344 Prot., datë 10.12.2021 për vitin 2021 është ngritur komisioni i inventarizimit me përbërje z. K.B, znj. H.I dhe znj. F.J.

Me urdhërin nr. 346 Prot., datë 10.12.2021, Drejtori i Shoqërisë ka krijuar komisionin e asgjësimit të aktiveve që kanë dalë jashtë përdorimit për vitin 2021 me përbërje znj. M.J, z. Th.TH dhe znj. D.K.

Me urdhërin nr. 487 Prot., datë 19.12.2022 për vitin 2022, është ngritur komisioni i inventarizimit me përbërje z. K.B, znj. H.I dhe znj. F.J.

Me urdhërin nr. 489 Prot., datë 19.12.2022, Drejtori i Shoqërisë ka krijuar komisionin e asgjësimit të aktiveve që kanë dalë jashtë përdorimit për vitin 2022 me përbërje znj. M.J, z. Th.TH dhe znj. R.A.

Nga komisionet e inventarizimit janë mbajtur fletë inventarizimet me sasi të kontrolluara duke u bërë krahasimi me të dhënat përkatëse të librave por këto fletë inventarizime, nuk janë mbajtur me personat me përgjegjësi materiale të cilët kanë në përdorim disa nga aktivet. Në momentin e mbajtjes së flet-inventarizimeve, rezulton se këto persona nuk kanë firmosur.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- Udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Titulli i gjetjes	Mangësi në procesin e inventarizimit.
Situata:	Nga auditimi i kryer për inventarizimin në vitet 2018-2022, u konstatua se komisioni i ngritur për vlerësimin e mallrave jashtë përdorimit përbëhet nga 3 anëtarë dhe komisioni i asgjësimit është i njëjti i përbërë nga 3 anëtarë, ndërsa referuar legjislacionit në fuqi komisioni i vlerësimit duhet të përbëhet nga 5 anëtarë dhe asgjësimit nga 7 anëtarë. Për vitin 2022 u konstatua se komisioni inventarizimit është i njëjti me komisionin e vitit 2021.
Kriteri:	Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 neni 100,101.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në pasqyrimin e saktë të menaxhimit të aktiveve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Shkaku:	Mos zbatim i legjislacionit.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marri masa për përcaktimin e drejtë të komisioneve të inventarizimit duke respektuar edhe numrin e tyre sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim arritjen e rezultave të sakta të inventarizimit dhe pasqyrim të drejtë të rezultave në pasqyrat financiare.

7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve, zbatimin e kontratave të punimeve civile, mallra dhe shërbime si dhe të ngarkim-shkarkimit.

1- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale dhe higjienosantare në zbatim të protokollit të përballimit të Covid-19” me të dhëna si më poshtë :

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale dhe higjienosantare në zbatim të protokollit të përballimit të Covid-19” REF-63562-07-01-2020		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 241 Prot., Datë 30.06.2020	3. Hartuesit e Dokumentave të Tenderit (NJP) 1. K.B (Kryetar) 2. Th.TH (Anëtar) 3. A.K (Anëtare)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.248 datë 03.07.2020 1. K.Sh (Kryetar) 2. Th.M (Anëtar) 3. F.J (Anëtare)
2. Lloji i procedurës së prokurimit “Kërkesë për Propozim” (Mallra) Elektronike		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4.100.000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) S.C SHPK 3,820,350 lekë	7. Diferenca me fondin limit 279,650 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 14.07.2020	9. Burimi i financimit Vetëfinancim	10. Operatorët ekonomikë a) Pjesmarrës në tender: 9 (nëntë) OE b) Skualifikuar 6 (gjashtë) mos paraqitje mostrash 2 (dy) mos plotësimit dokumentacioni c) Kualifikuar 1 (një) OE
11. Ankimime AK- s'ka; APP s'ka; KPP s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP, KPP S'ka

Përshkrimi i procedurës

Agjencia e prokurimit publik, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mbështetje të Ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin Publik”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 15, datë 10.03.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive”, të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të vecanta Administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit shkaktuar nga Covid-19” dhe të VKM nr. 343, datë 27.04.2020 “Për përcaktimin e Autoriteteve Kontraktore që do prokurojnë me procedurë negociim pa shpallje paraprake” mallra ose shërbime të nevojshme për përballimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19, me qëllim garantimin nga insitucioneve publike të kushteve dhe arikujve higjienosantare të nevojshme për kufizimin e përhapjes së Covid-19 si dhe në kuadër të bashkëpunimit institucional, hartuan një udhëzim të përbashkët me nr. 2857 Prot., & nr. 2163 Prot., datë 06.05.2020.

Në zbatim të këtij udhëzimi të përbashkët, referuar dhe situatës së vështirë të shkaktuar nga Covid-19, AK “Porti Detar SHA Sarandë” si dhe urdhërit nr. 169, datë 05.06.2020, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë “Për zbatimin e protokolleve të operimit për transportin rrugor, ajror dhe detar, në kuadër të parandalimit dhe të kontrollit të Pandemisë Covid-19 si dhe botimit në Fletoren Zyrtare, u ngrit grupi punës i cili nëpërmjet një relacioni bëri kërkesën për mbulimin e nevojave për përballimin e situatës së shkaktuar nga Covid. Relacioni iu dërgua Drejtorit të Portit Detar SHA Sarandë me shkresën me nr. 214 Prot., datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

19.06.2020, nga ku ishte përcaktuar sasia e listës së mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për përballimin e kësaj situate. Grupi i punës i ngritur me urdhërin nr. 41 Prot., datë 15.05.2020, i cili ka bërë kërkesën dhe ka përpiluar relacionin, është i përbërë nga z. A.H, znj. A.K, znj. L.E, z. K.Sh, z. K.B, znj. A.Sh, z. Th.TH, z. S.A dhe z. Th.M. Në vazhdim në bazë të urdhrit të brendshëm me nr. 230 Prot., datë 26.06.2020, është miratuar ndryshimi në rregjistrër ku është përcaktuar procedura “Kërkesë për Propozim” me objekt “Blerje materiale të nevojshme për mbrojtje personale dhe higjieno-sanitare, në zbatim të Protokollit të përballimit të Covid-19”. -Fondi limit i përlogaritur është 4,100,000 lekë pa TVSH.

Ndërkohë që në lidhje me të dhënat teknike dhe cilësore të mallrave të kërkuar grupi punës ka vepruar drejtë pasi është mbështetur në Udhëzimin e Përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, udhëzim i cili nëpërmjet një aneksi të vecantë ka të përshkruara të dhënat teknike dhe cilësorë mbi produktet, mallrat që do blihen sipas standarteve Europiane (EN 149:2001+A1:2009) ose standartit amerikan (NIOSH 95). Këto mallra duhet të kenë certifikimin CE, FDA ose ekuivalent.

Deklaratat e konfliktit të interesave, janë bërë nga anëtarët e NJP dhe të KVO-së brenda afatit. Me procesverbal të NJP është bërë miratimi i DST ku është përcaktuar data e zhvillimit të procedurës, janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së OE që do të marrin pjesë, kriteret e përgjithshme e të vecanta për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit të OE fitues. Janë argumentuar kriteret e vecanta të vendosura nëpërmjet procerverbalit të mbajtur.

Zhvillimi i procedurës.

Në datën 14.07 2020 në përputhje me DST u bë hapja e ofertave në sistemin elektronik. Në raportin përfundimtar të hartuar nga KVO rezultoi se kanë marr pjesë 9(nëntë) operatorë ekonomikë(OE). Janë skualifikuar 6 (gjashtë) OE pasi nuk u paraqitën në fazën e dorëzimit të mostrave. KVO vazhdoi me shqyrtimin e dokumentacionit të OE të cilët kishin paraqitur mostrat, “S.C” SHPK me ofertë 3,820,350 lekë, “M.V” SHPK me ofertë 2,875,750 lekë, “F” SHPK me ofertë 3,200,000 lekë. U skualifikuan OE “M.V” SHPK si dhe OE “F” SHPK pasi dokumentacioni i tyre u konsiderua jo në përputhje me DST. U shpall fitues OE “S.C” SHPK. Me OE fitues është lidhur kontrata nr. 321/16 Prot., datë 28.08.2020 me vlerë kontrate 3,820,350 lekë. Përmbajtja e kontratës nuk është hartuar në përputhje me DST. Në kontratë nuk ka të hartuar specifikimet teknike si dhe termat e referencës. Janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, sanksionet për përmbushje të detyrimeve jashtë afatit dhe jashtë cilësisë së përcaktuar, etj. Ka formular për njoftim kontrate të nënshkruar i cili është dërguar në APP për botim.

-Përlllogaritja e fondit limit, nuk është bërë bazuar në një analizë të thellë në lidhje me sasinë e materialeve për mbrojtje nga covid që do prokurohen. Komisioni duhej të ishte mbështetur në numrin e punonjësve të institucionit, plan shpërndarjen e materialeve, sasinë ditore për një person, jetëgjatësinë e tyre nga ku do kishim një përlllogaritje të saktë të vlerës limit të kontratës. Nisur nga sa më sipër, disa nga zërat për të cilat duhej të ishte bërë një analizë më e detajuar, janë në tabelën më poshtë.

Artikulli	Sasia	Vlera
1.Maska mbrojtëse Kn95 FFP2	2500 copë	1,600,000 lekë
2.Maska të thjeshta kirurgjikale	5000 copë	750,000 lekë
3.Doreza mbrojtëse	110 pako (100 copë/pako)	88,000 lekë

Përcaktimi i cmimit është bërë nga Kryetari Degës së Programimit dhe Investimit K.B, i cili ka administruar 2 oferta ekonomike i vetëm pa ngritur një grup punë me 3(tre) anëtare. Ofertat e marra nga OE “F.B” SHPK si dhe oferta e OE “I.P” SHPK, ndërkohë që duhet të ishin administruar 3(tre) oferta. Operatori “F.B” SHPK pas verifikimit në QKB në statusin e saj rezulton se është e pezulluar dhe si rrjedhojë nuk ushtron aktivitetin e saj, ndërkohë që Operatori “I.P” SHPK rezulton se nuk e ka në veprimtarinë e tij objektin e prokurimit dhe si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

rjedhje kemi të bëjmë me një përlllogaritje fondi limit me testim tregu pa asnjë ofertë ekonomike të rregullt të administruar. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

Nga auditimi u konstatua se: Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit, nuk ka hartuar specifikime teknike. Mungojnë termat e referencës të cilat përshkruajnë kërkesat, parametrat dhe karakteristikat kryesore të llojit të punës, mallit apo shërbimit të caktuar. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 23, ku cilësohet: “*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.....*”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Ligjin Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Komisioni i ngritur për përlllogaritjen e nevojave dhe listës së materialeve për prokurim dhe njësia e prokurimit.

Titulli i gjetjes	Mangësi në argumentimin dhe dokumentimin e mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit krahasuar me nevojat reale të Shoqërisë.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “<i>Blerje materiale të nevojshme për mbrojtje personale dhe higjeno-sanitare për mbrojtje nga Covid-19</i>” zhvilluar në vitin 2020, me vlerë kontrate 4,920,000 lekë me TVSH, u konstatua se:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Sasitë e materialeve për mbrojtjen personale anti Covid nuk ishin nxjerrë në bazë të nevojave reale të Shoqërisë. Konkretisht, janë kërkuar 5000 copë Maska të thjeshta kirurgjikale, 2500 copë Maska mbrojtëse Kn95 FFP2 dhe 11000 copë Doreza mbrojtëse. Sasitë e mësipërme janë të ekzagjeruara krahasuar me nevojat e një stafi të reduktuar por mbi të gjitha edhe për arsye të mos kryerjes së aktivitetit të transportit detar për shkak të situatës të shkaktuar nga Covid-19. Vlera prej 2,925,600 lekë me TVSH që korrespondon me vlerën e materialeve të mësipërme, konsiderohet si vlerë e investuar në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës së fondeve publike.2. Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit, nuk u konstatua dokumentacioni i plotë lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit të procedurës. Përlllogaritja e vlerës së fondit limit për procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm nuk i referohet mesatares së 3 ofertave të marra nga tregu por Njësia e Prokurimit është bazuar për nxjerrjen e fondit limit vetëm tek 1 ofertë ekonomike.
Kriteri:	VKM Nr.914. datë 29.12.2014 neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.
Ndikimi/Efekti:	Bëhet precedent për keqmenaxhim të fondeve në të ardhmen.
Shkaku:	Mos respektimi i ligjeve dhe rregullave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masat që në të ardhmen në procedurat e prokurimit, njësia e prokurimit ti referohet minimumi tre ofertave të tregut dhe në të njëjtën kohë, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja e sasive të mallrave që do të prokurohen, duke i krahasuar ato me të dhënat reale të Shoqërisë me qëllim shmangien e investimeve me pasoja negative financiare në të ardhmen.
--------------------	--

Për sa më lart, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Përlllogaritjes së vlerës së fondit limit dhe kërkesës për prokurim me përbërje: A.H, A.Sh, A.K, L.E, K.Sh, K.B, Th.M, S.A dhe Th.TH.

2- Procedura e prokurimit me objekt “Zbatim i projektit për hyrjen e Portit Detar SHA Sarandë” me të dhëna si më poshtë :

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Zbatim i projektit për hyrjen e portit Detar SHA Sarandë” REF-43163-09-23-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 361 Prot., Datë 21.09.2022	3. Hartuesit e Dokumentave të Tenderit (NJP) 1. K.B (Kryetar) 2. F.J (Anëtar) 3. Th.Th (Anëtar)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.403 Prot. datë 17.10.2022 1. M.J (Kryetar) 2. K.Sh (Anëtar) 3. R.A (Anëtar)
2. Lloji i procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”	6. Oferta fituese (pa TVSH) A.A <u>14,706,560 lekë</u>	7. Diferenca me fondin limit <u>2,152,759 lekë</u>
5. Fondi Limit (pa TVSH) <u>16,859,319 lekë</u>	8. Data e hapjes së tenderit 17.10.2022	9. Burimi i financimit Buxheti i Shtetit
11. Ankimime AK- s'ka; APP s'ka; KPP s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka	10. Operatorët ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender : 2(dy) OE b) Skualifikuar asnjë OE c) Kualifikuar 2(dy) OE
		13. Përgjigje Ankesës nga APP, KPP S'ka

Nga auditimi rezultoi se:

Përshkrimi procedurës

Në kuadër të programit të zhvillimit ekonomik dhe financiar të shoqërisë, bazuar dhe në ligjin nr. 168, datë 31.10.2013 “Për sigurinë në anije dhe porte, planin e sigurisë të portit, Kodit të ISPS-së, Rregullores së brendshme të Forcës së Sigurisë, Rekomandimeve të Icitapit Amerikan, Rojes Bregdetare Amerikane, Drejtorisë së Autoriteve Shtetërore të Sigurisë Portuale, Kodit të Punës për krijimin e kushteve të punonjësve gjatë orarit të punës me qëllim rritjen e sigurisë në portin e Sarandës mbështetur dhe në eksperiencën e porteve të tjera, është parë e domosdoshme që të realizohet një projekt ku të parashikohet mbulimi i hyrjes së portit me elemente estetikë, pajisje me tabela informuese për operimin dhe tarifatat që ushtron Porti ku të jetë funksionale dhe sistemimi i qarkullimit të automjeteve dhe pasagjerëve dhe turistëve nëpërmjet barrave dhe sistemit elektronik. Pajisjet me sistemin e prerjeve të biletave të hyrjes dhe daljeve të automjeteve në mënyrë elektronike duke eliminuar abuzimet e mundshme me hyrjet dhe daljet nga territori Portit. Mendojmë se të gjitha këto ndërhyrje do të kenë një efekt në plotësimin e kushteve të punës për punonjësit e sigurisë portuale dhe punonjësve prerës biletash gjatë kryerjes së detyrës në orarin e punës, si dhe kushtet e një strukture estetike për hyrjen dhe daljen e Portit me imazhin e tij.

Përlllogaritja e fondit limit.

Përlllogaritja e vlerës së fondit limit, është bërë duke u mbështetur në projektin kompanisë së projektimit A.V.E.C, zhvilluar me procedurë prokurimi me vlerë të vogël. Në bazë të projektimit të bërë, preventivit total të punimeve që do të kryhen, është hartuar preventivi përmbledhës i cili ka të përshkuar punimet ndërtimore si dhe elektrike të saj. Në bazë të sasisë zërave që do realizohen ka dalë vlera limit e përlllogaritur 16,859,319 lekë pa TVSH. Zgjedhja



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

e procedurës së prokurimit publik është “E hapur-Punë”, Elektronike dhe është në përputhje me VKM nr.285, datë 19.06.2021, neni 47, Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, nenin 42, pika 1. Deklaratat e konfliktit të interesit, janë bërë nga anëtarët e NJP dhe të KVO-së brenda afatit. Me procesverbal të NJP është bërë miratimi i DST ku është data e zhvillimit të procedurës, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit, dokumentacioni kualifikues. Janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së OE që do të marrin pjesë, kriteret e përgjithshme e të vecanta për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit të OE fitues (cmimi më i ulët).

Janë argumentuar kriteret e vecanta si dhe specifikimet teknike të vendosura nëpërmjet procesverbalit të mbajtur.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se vendosja e tyre është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

Zhvillimi i procedurës.

Në datën 17 Tetor 2022, bazuar në kriteret e DST, u bë hapja e ofertave në sistemin elektronik ku sipas procesverbalit të KVO u paraqitën 2(dy) OE “A” SHPK me vlerë 15,336,846 lekë si dhe “A.A” SHPK me vlerë 14,706,560 lekë. KVO i ka kualifikuar OE pasi dokumentacioni tekniko-ligjor i tyre ishte i rregullt dhe në përputhje me DST. Është shpallur fitues “A.A” SHPK si oferta më e ulët. Është zbatuar afati ankimit 7 ditë dhe nuk ka pasur ankesa mbi operatorin e shpallur fitues. Është hartuar raporti përmbledhës me nr. 361/10 Prot., datë 01.11.2022 dhe është miratuar nga titullari. Me OE fitues është lidhur kontrata nr. 361/12 Prot., datë 08.11.2022 me vlerë 14,706,560 lekë e shoqëruar me sigurim kontrate deri në zbatim të plotë të saj. Kontrata është në proces zbatimi me afat 3 muaj nga nënshkrimi i saj.

3- Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtimi i tualeteve në kalatë” me të dhëna si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i tualeteve në kalatë”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 29 Dt. 26.07.2019	3 Hartuesit e Dokumentave të Tenderit Urdhër Nr. 29 Dt. 26.07.2019 Znj. A.Sh Z. K.B Z. Th.Th	4 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 111 Dt. 11.11.2019 Z. K.Sh Z. A.H Z. Th.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 3,000,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSH) 2,785,120 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 214,880 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 13.08.2019, ora 13:00	9. Burimi Financimit Buxheti PDS SHA	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 b) S’kualifikuar 4, c) Fitues “A&P” SHPK
11. Ankime AK- nr. 13 Prot., datë 10.01.2020. APP-s’ka KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK. -Shkresa nr. 13/3 Prot., datë 16.01.2020.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Shkresa S’KA
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e Kontratës Datë 17.02.2020	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 3,342,144 lekë	16. Likuiduar: Komplet

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të PDS SHA, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 3,000,000 lekë pa TVSH (sipas DST) me objekt “Ndërtimi i tualeteve në kalatë”. Tek i njëjti urdhër, përcaktohet dhe njësia e prokurimit. Fondi limit është përlllogaritur nga “N.S” SHPK, me procedurë prokurimi blerje e vogël.

-Procesverbali i hartimit të kriterëve të kualifikimit është mbajtur nga njësia e prokurimit në datën 30.07.2019.



- Njoftimi i kontratës është me nr. 585 Prot., datë 30.07.2019 publikuar në buletin e APP me nr. 31, datë 05.08.2019.
- Me procesverbalin e datës 13.08.2019 dhe nr. 626 Prot., njësia e prokurimit informon Titullarin e PDS SHA, lidhur me ankesën e ardhur në sistem dhe sqaron se ankesa nuk merret në konsideratë pasi ka ardhur jashtë afateve ligjore. Në të njëjtën shkresë, njësia e prokurimit cilëson: *“Tenderi do të pezullohet, shiko shtojcën me ndryshimet, dhe do të jeni përsëri më të qartë për veprimet tona në respekt të ligjit”*. Ankesa në sistem është shfaqur në datën 13.08.2019, ora 12:52, pra 8 minuta përpara përfundimit të afatit të hapjes së ofertave. Ankesa në sistem është anonim.
- Me urdhrin e brendshëm nr. 83 dhe nr. 628 Prot., datë 13.08.2019, Titullari i PDS SHA, urdhëron pezullimin e procedurës së prokurimit deri në korrigjimin e DST. Njëkohësisht, nga “N.S” SHPK, është kërkuar korrigjimi i DST.
- Me procesverbalin e datës 19.08.2019 nr. 694 Prot., njësia e prokurimit, kryen korrigjimet e sygjera nga ankimuesi.
- Me urdhrin nr. 110 dhe nr. 824 Prot., datë 08.11.2019, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të projektit të rishikuar nga “N.S” SHPK.
- Me urdhrin nr 111 dhe nr. 827 Prot., datë 11.11.2019, është ngritur KVO. (Është anuluar urdhri nr. 77, datë 26.07.2019 për KVO i mëparshëm).
- KVO me procesverbalin e datës 06.12.2019 nr. 860 Prot., kryen verifikimin e ofertave të ardhura dhe konstaton 5 oferta, “C” SHPK me 2,183,347 lekë, “J” SHPK me 2,284,773 lekë, “M/S” SHPK me 2,622,061 lekë, “A&P” SHPK me 2,785,120 lekë dhe “K” SHPK me 2,965,471 lekë.
- Me procesverbalin me nr. 866 Prot., datë 10.12.2019, KVO kërkon nga Titullari i PDS SHA, ndërprerjen e përkohëshme të vlerësimit të ofertave duke kërkuar më shumë kohë për shqyrtimin e tyre. Kërkesa është miratuar nga Titullari i PDS SHA.
- Me procesverbalin me nr. 866/1 Prot., datë 31.12.2019, KVO rifillon procesin e vlerësimit të ofertave.
- Me procesverbalin me nr. 10 Prot., datë 09.01.2020, KVO kryen vlerësimin e ofertave dhe kualifikon operatorin ekonomik “A&P” SHPK me 2,785,120 lekë pa TVSH.
- Ankesa e ardhur në PDS SHA, për dijeni KLSH dhe KPP, nga OE “M/S” SHPK, është me nr. 13 Prot., datë 10.01.2020.
- Me urdhrin nr. 2 dhe nr. 13/1 Prot., datë 13.01.2020, Titullari i PDS SHA, ngre grupin e verifikimit të ankesës së ardhur. Në vazhdim me procesverbalin me nr. 13/2 Prot., datë 16.01.2020, grupi i ngritur, pas shqyrtimit të ankesës, ka vendosur mos pranimin e ankesës së ardhur duke arsyetuar dhe argumentuar mbi të gjitha pretendimet e ankimuesit.
- Me shkresën nr. 13/1 Prot., datë 16.01.2020, i është kthyer përgjigjia ankimuesit.
- Raporti përmbledhës është me nr. 30 Prot., datë 30.01.2020. Me anë të këtij raporti, shpallet fitues OE “A&P” SHPK me ofertën me vlerë 2,785,120 lekë pa TVSH.
- Kontrata midis OE “A&P” SHPK dhe PDS SHA, është lidhur në datën 17.02.2020. Është me afat 75 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe vlerë 2,785,120 lekë pa TVSH.
- Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është me nr. 83 Prot., datë 26.02.2020.
- Njoftimi për fillimin e punimeve është me nr. 83/2 Prot., datë 26.02.2020. Në të njëjtën datë është mbajtur procesverbali i fillimit të punimeve dhe Akti piketimi.
- Me urdhrin nr. 117 Prot., datë 13.03.2020, është pezulluar nga Titullari i PDS SHA, vijimi i punimeve për arsye të situatës së krijuar nga COVID-19. Në vazhdim me shkresën me nr. 117/1 Prot., datë 13.03.2020, është njoftuar nga PDS SHA, sipërmarrësi i punimeve për pezullimin e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

-Me urdhrin nr. 149 Prot., datë 16.04.2020, është dhënë leja për vijimin e punimeve nga PDS SHA.

-Me shkresën nr. 160 Prot., datë 07.05.2020, është lidhur kontrata shtesë midis PDS SHA dhe OE “A&P” SHPK me afat zbatimi deri në datën 16.06.2020.

-Me shkresën nr. 32 Prot., datë 16.06.2020, njoftohet PDS SHA nga “N.S” SHPK, për përfundimin e punimeve. Akti i kolaudit është mbajtur nga kolaudatori, mbikqyrësi, sipërmarrësi dhe investitori, në datën 22.06.2019.

-Certifikata e marrjes së përhershme në dorëzim të punimeve, është me nr. 219/3 Prot., datë 22.06.2020 dhe e nënshkruar nga supervizori, kontraktori, kolaudatori dhe përfaqësuesit e subjektit Th.M, A.K dhe S.A.

-Lidhur me zbatimin e punimeve sipas zërave të preventivuar.

-Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, u konstatua se nuk janë ekzekutuar zërat si më poshtë.

-Punime ndërtimi:

1. Nr. 24, An 2.404/1, Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë, në vlerën 73.905 lekë pa TVSH.
2. Nr. 28, An 2.209, Ulluk shkarkimi me llamarinë xingat në vlerën 1.701 lekë pa TVSH.

-Punime elektrike:

3. Nr. 16, An 2.a-133, Ndriçues elektrik tavanor 1x 18 Ë, copë 5, në vlerën 7.250 lekë pa TVSH.
4. Nr. 22, An, Zëri F.V Aparat matës për EE, elektronik i përdorshëm me kartë në vlerën 150,000 lekë pa TVSH.
5. Nr. 23, An, Zëri Aparat matës për ujin elektronik i përdorshëm me kartë (përfshi lexuesin elektronik) në vlerën 105,000 lekë pa TVSH.

-Sa më sipër, vlera totale e punimeve të pa kryera është **405,427.2 lekë**.



Titulli i Gjetjes:	Zëra punimesh të pa kryera.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të punimeve me objekt “Ndërtimi i tualeteve në kalatë” sipas kontratës me datë 17.02.2020, të lidhur midis OE “A&P” SHPK dhe Portit Detar SHA Sarandë, u konstatuan mangësi në zëra punimesh dhe konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p><u>-Punime ndërtimi:</u></p> <p>1. Nr. 24, An 2.404/1, Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë, në vlerën 73.905 lekë pa TVSH.</p> <p>2. Nr. 28, An 2.209, Ulluk shkarkimi me llamarinë xingat në vlerën 1.701 lekë pa TVSH.</p> <p><u>-Punime elektrike:</u></p> <p>3. Nr. 16, An 2.a-133, Ndriçues elektrik tavanor 1x 18 W, copë 5, në vlerën 7.250 lekë pa TVSH.</p> <p>4. Nr. 22, An, Zëri F.V Aparat matës për EE, elektronik i përdorshëm me kartë në vlerën 150,000 lekë pa TVSH.</p> <p>5. Nr. 23, An, Zëri Aparat matës për ujin elektronik i përdorshëm me kartë (përfshi lexuesin elektronik) në vlerën 105,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Vlera totale e punimeve të pa kryera, është 405,427.2 lekë.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
Shkaku:	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 405,427.2 lekë, nga “A&P” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likujduar por të pa kryer nga OE.

4- Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës” me të dhëna si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 17 Dt. 07.06.2019	3 Hartuesit e Dokumentave të Tenderit Urdhër Nr. 29 Dt. 26.07.2019 Znj. A.Sh Z. K.B Z. Th.TH	4 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 64 Dt. 07.06.2019 Z. A.H Znj. F.J Z. Th.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,950,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,406,870 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 543,130 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 24.06.2019	9. Burimi Financimit Buxheti PDS SHA	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 8 b) S’kualifikuar 7, c) Fitues “N” SHPK
11. Ankimime AK- nr. 496 Prot., datë 05.07.2019. AK- nr. 537 Prot., datë 16.07.2019. APP-s’ka KPP- Datë 22.07.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK. -Shkresa nr. 497 Prot., datë 05.07.2019.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP: Vendimi nr. 595/2019, KPP.
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e Kontratës Datë 22.07.2019	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 1,683,526 lekë	16. Likuiduar: Komplet

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të PDS SHA, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 1,950,000 lekë pa TVSH (sipas DST) me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”. Tek i njëjti urdhër, përcaktohet dhe njësia e prokurimit. Fondi limit është përlllogaritur nga inxhinier A.H.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

- Procesverbali i hartimit të kriterëve të kualifikimit është mbajtur nga njësia e prokurimit në datën 10.06.2019.
- Njoftimi i kontratës është me nr. 417 Prot., datë 10.06.2019.
- KVO me procesverbalin e datës 24.06.2019, kryen verifikimin e ofertave të ardhura dhe konstaton 8 oferta, “6.P” SHPK me 1,546,600 lekë, “M/S” SHPK me 1,686,865 lekë, “S” SHPK me 1,713,776 lekë, “V.K” SHPK me 1,753,380 lekë, “SH.07” SHPK me 1,800,912 lekë, “N” SHPK me 1,406,870 lekë, “SH” SHPK me 1,498,130 lekë dhe “E.V” SHPK me 0 lekë. Janë skualifikuar tre ofertuesit e fundit për mangësi në ofertat e dhëna.
- Me procesverbalin me nr. 469 Prot., datë 24.06.2019, KVO kryen vlerësimin e ofertave dhe kualifikon 5 operatorët e parë duke skualifikuar 3 operatorët e fundit.
- Në datën 04.07.2019, OE “N” SHPK, plotëson formularin e ankesës lidhur me skualifikimin e padrejtë nga PDS SHA. Në vazhdim, është kryer rivlerësimi nga KVO me nr. 497 Prot., datë 05.07.2019 dhe është marrë parasysh ankesa e ardhur duke e kualifikuar ankimuesin.
- Me shkresën nr. 537 Prot., datë 16.07.2019, është paraqitur ankesë nga OE “6.P” SHPK për skualifikim të padrejtë nga PDS SHA.
- Me urdhrin nr. 586 Prot., datë 30.07.2019, Titullari i PDS SHA, vendos pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e ankesës së ardhur.
- Me vendimin nr. 1285/1 Prot., datë 26.07.2019, KPP ka dërguar në PDS SHA, kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit për procedurën e prokurimit të mësipërme.
- Në vijim, me vendimin K.P.P 595/2019, KPP njofton PDS SHA për vazhdimin e procedurës së prokurimit dhe mospranimin e ankesës së ardhur nga ankimuesi.
- Formulari i njoftimit të fituesit, është me nr. 527 Prot., datë 15.07.2019, publikuar në buletinin e APP nr. 29, datë 22.07.2019.
- Kontrata midis OE “N” SHPK dhe PDS SHA, është lidhur në datën 22.07.2019. Është me afat 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është me datë 22.07.2019.
- Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 22.07.2019. Në të njëjtën datë është mbajtur procesverbali i fillimit të punimeve dhe Akti piketimi. Në vazhdim, është ndërprerë ekzekutimi i kontratës së punimeve për arsye të pritjes së përgjigjes nga KPP (trajtuar më lart). Punimet kanë rifilluar pas ardhjes së përgjigjes nga KPP, pra në datën 18.09.2019.
- Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datën 13.10.2019.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit, rezultoi si vijon:*
- Më shkresën nr. 520 Prot., datë 12.07.2019, operatori ekonomik ankimues “6.P” SHPK, është vënë në dijeni nga PDS SHA për mospranimin e ankesës së bërë.
- Në datën 22.07.2019, operatori ekonomik ankimues “6.P” SHPK, dërgon ankesën në KPP dhe pas shqyrtimit, KPP vendos mospranimin e ankesës së ardhur dhe lejimin e PDS SHA për vazhdimin e procedurës së prokurimit.
- Në datën 22.07.2019, është lidhur kontrata midis OE “N” SHPK dhe PDS SHA (trajtuar më lart).
- Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë **22.07.2019**.
- Me vendimin nr. 1285/1 Prot., datë 26.07.2019, KPP ka dërguar në PDS SHA, kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit për procedurën e prokurimit të mësipërme.
- Me shkresën nr. 586 Prot., datë **30.07.2019**, Titullari i AK, nxjerr urdhrin e brendshëm për pezullimin e procedurës deri në marrjen e vendimit nga KPP.
- Me shkresën nr. 671 Prot., datë 13.09.2019, NJP e PDS SHA, vihet në dijeni për vendimin e marrë nga KPP dhe njofton Titullarin e AK për anulimin e pezullimit të procedurës dhe vazhdimin e punimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

-Punimet kanë rifilluar pas ardhjes së përgjigjes nga KPP, pra në datën **18.09.2019**, sipas procesverbalit të mbajtur nga Mbikqyrësi i punimeve.

-Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datën **13.10.2019**.

-Sa më sipër, nga data 22.07.2019 deri në datën 30.07.2019, janë 9 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N” SHPK. Nga data 18.09.2019 deri në datën 13.10.2019, janë 25 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N” SHPK. Në total, operatori ekonomik “N” SHPK, ka punuar 34 ditë pune dhe jo 30 ditë sa është afati i ekzekutimit të kontratës. Pra punimet kanë përfunduar me 4 ditë vonesë.

-Referuar kontratës së lidhur midis Portit Detar Sarandë SHA dhe operatorit ekonomik “N” SHPK, asaj me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019, tek neni 3 “Kohëzgjatja”, cilësohet se: *“Kontrata do të konsiderohet e përfunduar me kalimin e 30 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit”*.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit por dhe nga inventaret e dosjeve të dorëzuara, nuk u konstatua të jetë miratuar midis AK dhe operatorit ekonomik ndonjë amendament kontrate në kuptim të nenit 13 të kontratës së lidhur. Si rezultat, punimet janë ekzekutuar me 4 ditë vonesë dhe në këtë rast duhej të ekzekutohej neni 15 i kontratës *“Penalitetet”*. Vlera përfundimtare e punimeve është 1,683,526 lekë. Referuar nenit 15 të kontratës së lidhur, operatorit ekonomik “N” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti për vonesa në ekzekutimin e kontratës në vlerën e kalkuluar sipas formulës $1,683,526 \text{ lekë} \times 4/1000 \times 4$ ditë vonesë ose **269,365 lekë**.

Lidhur me zbatimin e punimeve sipas zërave të preventivuar.

-Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri si më poshtë sipas situacionit përfundimtar:

-Nr.28, An 2.404/1, “Bojë hidroplastike importi, cilësia e I-rë” me vlerë 361,680 lekë me TVSH. (Sqarim, u verifikua me metoda të thjeshta me spërkatje me ujë ose gërvishje të sipërfaqes së murit konkretisht në ambientet e brendëshme dhe u konkludua se boja nuk është Hidroplastike).

-Sa më sipër, vlera totale e punimeve të pa kryera është **361,680 lekë**.

Në total, vlera e dëmshpërblimit që operatori ekonomik “N” SHPK, duhet ti kthejë Portit Detar Sarandë SHA, është **631,045 Lekë**.

Titulli i Gjetjes:	Punime të kryera me vonesë jashtë afatit të kontratës.
Situata:	Kontrata midis OE “N” SHPK dhe Portit Detar SHA Sarandë, është lidhur në datën 22.07.2019. Është me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës” dhe afat 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është me datë 22.07.2019. -Me vendimin nr. 1285/1 Prot., datë 26.07.2019, KPP ka dërguar pranë PDS SHA, kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit për procedurën e prokurimit të mësipërme. Me shkresën nr. 586 Prot., datë 30.07.2019, Titullari i AK, nxjerr urdhrin e brendshëm për pezullimin e procedurës deri në marrjen e vendimit nga KPP. Me shkresën nr. 671 Prot., datë 13.09.2019, NJP e PDS SHA, vihet në dijeni për vendimin e marrë nga KPP dhe njofton Titullarin e AK për anulimin e pezullimit të procedurës dhe vazhdimin e punimeve. Punimet kanë rifilluar pas ardhjes së përgjigjes nga KPP, pra në datën 18.09.2019, sipas procesverbalit të mbajtur nga Mbikqyrësi i punimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p>Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datën 13.10.2019. Sa më sipër, nga data 22.07.2019 deri në datën 30.07.2019, janë 9 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N” SHPK. Nga data 18.09.2019 deri në datën 13.10.2019, janë 25 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N” SHPK. Në total, operatori ekonomik “N” SHPK, ka punuar 34 ditë pune dhe jo 30 ditë sa është afati i ekzekutimit të kontratës. Pra punimet kanë përfunduar me 4 ditë vonesë. Referuar kontratës së lidhur midis Portit Detar Sarandë SHA dhe operatorit ekonomik “N” SHPK, asaj me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019, tek neni 3 “Kohëzgjatja”, cilësohet se: <i>“Kontrata do të konsiderohet e përfunduar me kalimin e 30 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit”</i>. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit por dhe nga inventaret e dosjeve të dorëzuara, nuk u konstatua të jetë miratuar midis AK dhe operatorit ekonomik ndonjë amendament kontrate në kuptim të nenit 13 të kontratës së lidhur. Si rezultat, punimet janë ekzekutuar me 4 ditë vonesë dhe në këtë rast duhej të ekzekutohej neni 15 i kontratës “Penalitetet”. Vlera përfundimtare e punimeve është 1,683,526 lekë. Referuar nenit 15 të kontratës së lidhur, operatorit ekonomik “N” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti për vonesa në ekzekutimin e kontratës në vlerën e kalkuluar sipas formulës 1,683,526 lekë x 4/1000 x 4 ditë vonesë ose 269,365 lekë.</p>
Kriteri:	Kontrata me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019, neni 3 “Kohëzgjatja.
Ndikimi/Efekti:	Ekzekutimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara.
Shkaku:	Mos respektimi i nenit 15 “Penalitetet” i kontratës nr. 550 Prot., datë 22.07.2019
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 269,365 lekë, nga “N” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve ligjore.

Titulli i Gjetjes:	Zëra punimesh të pa kryera.
Situata:	Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019 dhe objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri: Nr.28, An 2.404/1, “Bojë hidroplastike importi, cilësia e I-rë” me vlerë 361,680 lekë me TVSH. Si rezultat, vlera totale e punimeve të pa kryera është 361,680 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
Shkaku:	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 361,680 lekë, nga “N” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga OE
--	---

5- Procedura e prokurimit me objekt “Kabinë elektrike 20 kV” me të dhëna si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Kabinë elektrike 20 kV”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 9 Dt. 10.04.2019	3 Hartuesit e Dokumentave të Tenderit Urdhër Nr. 9 Dt. 10.04.2019 Znj. A.Sh Z. K.B Z. Th.TH	4 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 28 Dt. 10.04.2019 Z. Gj.K Z. A.H Z. F.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 5,592,831 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSH) 4,811,595 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 778,236 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 21.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti PDS SHA	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 b) S’kualifikuar 2, c) Fitues “A&P” SHPK
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
11. Lidhja e Kontratës Datë 21.06.2019	12. Vlera e kontratës (me TVSH) 5,773,914 lekë	13. Likuiduar: Komplet

Mbi realizimin e kontratës.

-Kontrata midis OE “A&P” SHPK dhe PDS SHA, është lidhur në datën 21.06.2019. Është me afat 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

-Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është me datë 25.06.2019.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 25.06.2019. Në të njëjtën datë është mbajtur procesverbali i fillimit të punimeve. Është mbajtur nga Mbikqyrësi punimeve, dokumentacioni teknik lidhur me kontrollet e punimeve dhe procesverbalet periodike për ecurinë e punimeve.

-Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datën 20.07.2019.

-Akt Kolaudimi është mbajtur në datën 21.07.2019 dhe është i nënshkruar nga Mbikqyrësi punimeve “A.E” SHPK me përfaqësues ing. A.Sh, nga Sipërmarrësi Punimeve “A&P” SHPK dhe Kolaudatori “XH&M” SHPK me përfaqësues znj. Xh.D.

-Nga verifikimi i dokumentacionit teknik në dosje dhe punimeve të kryera në terren, rezultoi si vijon:


-Në dosjen teknike të dorëzuar nga Mbikqyrësi punimeve, ka mungesë të theksuar të saktësisimit të vendndodhjeve ekzakte të punimeve të kryera. Jepen të dhëna të gërmimeve dhe të shtresave të ndryshme me rërë apo materiale të tjera por nuk saktësohet në asnjë rast kordinatat e këtyre punimeve pasi seksionet e tyre ndryshojnë vazhdimisht dmth njëherë asfalt, pastaj trotuar pastaj prapë asfalt dhe është e pamundur të nxirret një konkluzion i qartë se në cilin seksion janë hedhur p.sh 31.44 m³ rërë, ose në cilin seksion apo aks të një rruge është gërmuar 90 m³. Edhe pse u kërkua nga Mbikqyrësi nëpërmjet përfaqësuesëve të Portit Detar Sarandë SHA, që të dorëzoheshin specifikimet e qarta të punimeve të kryera, përsëri ato u sollën të pa qarta. Këto të dhëna të nevojshme për kryerjen e auditimit e bëjnë të pamundur nxjerrjen e një konkluzioni lidhur me volumin e saktë të punimeve të kryera nga sipërmarrësi. Në këto kushte, ajo që ishte e mundur nga grupi i auditimit, ishte vetëm matja e gjatësisë së kabllit AL 20 kV 1x240/25mm iz.XLPE.

-Nga matja e distancës midis kabinës së montuar brenda ambienteve të Portit Detar Sarandë SHA dhe kabinës së OSHEE të vendosur mbi zonën e Portit, rezultoi se kishte një diferencë 90 metra më tepër të deklaruar nga Mbikqyrësi për gjatësinë e Kabllit AL 20 kV 1x240/25mm iz.XLPE.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË



-E matur në fakt dhe me google map, distanca është 150 metra linear. Në total, 150 metra linear shumzim për 5 kablo, rezulton se janë shtrirë në total 750 metra Kabell AL 20 kV $1 \times 240/25 \text{mm}^2$ iz.XLPE dhe jo 840 metra sa deklarohet në situacionin përfundimtar. Si rezultat janë deklaruar 90 metra kabell më shumë. $90 \text{ metra kabell} \times 990 \text{ lekë/metri} = 106,920 \text{ lekë}$ me TVSH të deklaruar më shumë në situacionin përfundimtar. Edhe për puntorinë, janë deklaruar të njëjtat metra me cmim 90 lekë shtrimi i 1 metri linear. Si rezultat $90 \text{ metra shtrim} \times 90 \text{ lekë/metri} = 9720 \text{ lekë}$ me TVSH. Në total, vlera e faturuar më tepër në situacionin përfundimtar dhe që duhet të dëmshpërblehet nga OE “A&P” SHPK, është **116,640 lekë**.

-Për veprimet e mësipërme, për mos pasqyrimin me saktësi të volumeve të punimeve në librezën e masave dhe mos rakordimin e saktë të volumeve të punimeve duke pasqyruar në situacionin përfundimtar volume të tjera dhe jo ato reale, mban përgjegjësi Mbikqyrësi Punimeve “A.E” SHPK pasi ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 7 si dhe Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pikat 3.2, pika 3.3.

Shënim: Nga verifikimet dhe hulumtimet në manualët e sigurimit teknik dhe standartet ndërkombëtare lidhur me llojin e kabllit elektrik që mund të përdoret nën tokë, rezultoi se kablli i shtrirë nën tokë (AL 20 kV $1 \times 240/25 \text{mm}^2$ iz.XLPE) është kabell alumini dhe i përshtatshëm për tu instaluar në ajër dhe jo nën tokë. Kjo kabinë është vendosur në kohën që në Portin Detar Sarandë SHA, operonte dhe kalata e mallrave dhe prezenca e makinerive për kryerjen e ngarkim-shkarkimit, ka bërë të domosdoshme edhe instalimin e një transformatori të ri për të përballuar ngarkesat elektrike të Portit. Në këto momente që kjo kabinë nuk shfrytëzohet të gjithë kapacitetin e saj për arsye se në Portin Detar Sarandë SHA nuk kryhet më transport mallrash por vetëm transport pasagjerësh, është e pamundur që të nxirret një konkluzion dhe një rezultat nga grupi i auditimit nëse ky kabell i vendosur nëntokë do të arrijë të punojë me kapacitetin maksimal të ngarkesës elektrike pa u nxehur dhe pa krijuar probleme. Si rrjedhojë, Porti Detar Sarandë SHA, duhet të kryejë një verifikim nga specialistë të fushës përkatëse për të konkluduar nëse ky kabell AL 20 kV $1 \times 240/25 \text{mm}^2$ iz.XLPE, duhet të ishte vendosur me linjë ajrore apo nëntokësore dhe nëse ky kabell mund të punojë normalisht në kushte të ngarkesave të plota elektrike pa shfaqur asnjë problem teknik.



Titulli i Gjetjes:	Zëra punimesh të pa kryera.
Situata:	Kontrata midis OE “A&P” SHPK dhe PDS SHA, me objekt “Kabinë elektrike 20 kV”, vlerë 5,773,914 lekë me TVSH, është lidhur në datën 21.06.2019 dhe me afat 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Nga auditimi në terren i punimeve të kryera, u konstatua se kablli i aluminit AL 20 kV x 240/25mm iz.XLPE, ishte më i shkurtër se gjatësia e deklaruar në situacionin përfundimtar. Nga matja e distancës midis kabinës së montuar brenda ambienteve të Portit Detar SHA Sarandë dhe kabinës së OSHEE të vendosur mbi zonën e Portit, rezultoi se kishte një diferencë 90 metra më tepër të deklaruar në situacionin përfundimtar. E matur në fakt dhe me google map, distanca është 150 metra linear. Në total janë shtrirë: 150 ml (kabëll) x 5 (kablllo)=750 ml Kabëll AL 20 kV 1x240/25mm ² iz.XLPE dhe jo 840 metra sa deklarohet në situacionin përfundimtar. Si rezultat janë deklaruar 90 metra kabëll më shumë ose në vlerë 90 metra kabëll x 990 lekë/metri = 106,920 lekë me TVSH të deklaruara më shumë në situacionin përfundimtar. Edhe për puntorinë, janë deklaruar të njëjtat metra me çmim 90 lekë shtrimi i 1 metri linear. Si rezultat 90 metra shtrim * 90 lekë/metri = 9720 lekë me TVSH. Në total, vlera e faturuar më tepër në situacionin përfundimtar dhe që duhet të dëmshpërblehet nga OE “A&P” SHPK, është 116,640 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
Shkaku:	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 116,640 lekë, nga “A&P” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likujduar por të pa kryer nga OE.

8. Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël.

Në lidhje me zbatimin e legjislacionit për veprimet e kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i pagesave të bankës
- Dokumentacioni i pagesave të arkës
- Ditarët dhe llogaritë përkatëse
- Dokumentacioni për marrjen në dorëzim të furnizimeve
- Dokumentacioni justifikues për pagesat e kryera, etj.

Për veprimet e kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, konstatohet se ato janë kryer referuar urdhrave dhe dokumenteve justifikuese për kryerjen e shpenzimit dhe janë evidentuar,



regjistruar kronologjikisht dhe sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së vlerave monetare nga arka, shoqërohet me dokumentacionin justifikues për çdo veprim të kryer si edhe janë kryer kontrole mujore periodike për gjendjen e arkës. Veprimet nëpërmjet arkës në këtë shoqëri janë të kufizuara. Kontabilizimet janë kryer rregullisht dhe të regjistruara kronologjikisht në ditarët përkatës, sipas programit informatik të kontabilitetit “Alpha”. Pagesat janë kryer kryesisht për paga, shpenzime të ndryshme për uje, drita dhe detyrime kontraktuale, udhëtime e dieta, etj.

-Për këtë periudhë konstatohet se nga shoqëria janë paguar në 2 raste gjopa ndaj tatim Taksave në shumën 25,000 lek, për deklarime të vonuar të vendimit të ortakëve dhe deklarime në QKB, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Nëpërmjet bankës, janë kryer transfertat në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër, në shumën 13,544,581 lek, 3 transfertat nga Banka “C”. Shuma e mësipërme është likuiduar bazuar në 3 vendime të Asamblesë, si më poshtë:

-Vendimi i Asamblesë nr. 49, datë 19.06.2019 “Për kalim fondi” ku është vendosur kalimi i fondit 1,778,079 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore proporcionalisht për 6 punonjës.

-Vendimi i Asamblesë nr. 62, datë 30.07.2019 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 9,766,502 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për përballimin e detyrimeve sipas shkresës nr. 31, datë 23.07.2017, të Administratorit të shoqërisë.

-Vendimi i Asamblesë nr. 3, datë 09.01.2020 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 2,000,000 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore deri në muajin Mars 2020.

Referuar Vendimeve të Asamblesë, nga Drejtoria e Portit Detar Sarandë, janë nxjerrë Urdhërat e Brendshëm nr. 64, datë 24.06.2019, nr. 82, datë 08.08.2019 dhe nr. 2, datë 14.01.2020 për kalimin e fondit sipas vendimeve të Asamblesë.

Në vendimet e Asamblesë citohet baza ligjore neni 102, pika 4 Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë Porti Detar Sarandë dhe aksionarit mazhoritar të shoqërisë “D.C” Shkodër.

Konstatohet se këto veprime janë kryer në kundërshtim me Kreun I “Asambleja e Përgjithshme” neni 135 pika 4, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statutin e shoqërisë miratuar në 15.06.2012, Kreun III “Asambleja e Përgjithshme” neni 11 “Të drejtat dhe detyrimet”, në të cilat nuk ka të përcaktuar transferim fondesh për shpenzime.

Transferimi i shumës në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër, është kryer në kushtet kur kjo shoqëri ka qenë në likuidim e sipër (sot e privatizuar) si edhe pa marrë në analizë situatën ekonomike të shoqërisë “Porti Detar” Sarandë, e cila në vitet 2020-2021 ka paraqitur vështirësi financiare, për efekt se Porti i Limionit që ishte aset i vetëm i kësaj shoqërie ku përpunohen mallrat nga anijet tregëtare, i ka kaluar firmës koncensionare në 24.07.2020 si edhe situata e bllokimit të pasagjerëve nga pandemia.

Rezultati financiar i shoqërisë në këtë periudhë paraqitet me humbje për vitin 2020 në shumën 64,208 mijë lekë dhe për vitin 2021 në shumën 51,084 mijë lekë. Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi A.M.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Shpenzimet për udhëtime e dieta dhe shpenzimet e karburantit për periudhën objekt auditimi paraqiten si më poshtë:

Vitet	Shpenzime Dieta		Shpenzime karburant	
	Plan	Realizim	Plan	Realizim
2018	2400	2400	1200	1199
2019	2500	2441	1200	1000
2020	2000	1191	1000	900
2021	1700	1692	950	950
2022	1700	1700	450	450

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se shpenzimet e kaburantit dhe shpenzimet për udhëtime e dieta nuk janë tejkaluar por ende mbetet vend për uljen e shpenzimeve referuar volumit të punës. Shpenzime karburanti, Fletë udhëtimet janë mbajtur për shpenzimet mujore, ku janë përshkruar data, vendi i nisjes dhe mbërritjes, distanca për km e përshkuara dhe normativa e mjetit për 100 km. Fletë udhëtimet janë firmosur nga titullari duke përcaktuar qëllimin e shërbimit, personat udhëtues, programin e shërbimit, etj. Për periudhën objekt auditimi shpenzimet e karburantit nuk kanë tejkaluar nivelin e programuar. Shpenzime udhëtimi e dieta brenda dhe jashtë vendit, janë kryer bazuar në vendimin e këshillit mbikëqyrës nr.19, datë 11.10.2018 "Për shpenzimet e dietave dhe udhëtimit për punonjësit që shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", bazuar në VKM nr. 329, datë 20.04.2018 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit" ku janë përcaktuar kriteret e përfitimit të dietave për qëllime shërbimi si edhe masa e përfitimit prej 5500 lekë/ditë dhe 1200 lekë/ditë për shërbimet me largësi mbi 50 km, si edhe vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 15, datë 06.06.2018, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".

Nga auditimi i shpenzimeve të udhëtimit, u konstatua se urdhër shërbimet janë plotësuar korrekt referuar dokumentacionit justifikues bashkëlidhur.

Titulli i Gjetjes:	Deklarim jashtë afateve ligjore.
Situata	Për periudhën objekt auditimi në Portin Detar SHA Sarandë, konstatohet se nga shoqëria janë paguar në 2 raste gjoba ndaj tatim Taksave në shumën 25,000 lekë, për deklaram të vonuar të vendimit të ortakëve dhe deklarime në QKB.
Kriteri:	Ligji nr .9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Ulje e të ardhurave
Shkaku:	Mos zbatimi i legjislacionit
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Sektori i Financës, të marrin masa për të deklaruar brenda afateve ligjore detyrimet në QKB, Tatime, etj, me qëllim eliminimin e gjobave në të ardhmen.

Titulli i Gjetjes:	Transferim fondi në favor të shoqërisë D.C, Shkodër
Situata:	Nëpërmjet bankës, janë kryer transfertat në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër, në shumën 13,544,581 lekë , 3 transfertat nga Banka “C”. Shuma e mësipërme është likuiduar bazuar në 3 vendime të Asamblesë, si më poshtë: a) Vendimi i Asamblesë nr.49, datë 19.06.2019 “Për kalim fondi” ku është vendosur kalimi i fondit 1,778,079 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	<p>përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore proporcionalisht për 6 punonjës.</p> <p>b) Vendimi i Asamblesë nr.62, datë 30.07.2019 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 9,766,502 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, në favour të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për përballimin e detyrimeve sipas shkresës nr.31 Prot., datë 23.07.2017 të Administratorit të shoqërisë.</p> <p>c) Vendimi i Asamblesë nr.3, datë 09.01.2020 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 2,000,000 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore deri në muajin Mars 2020.</p> <p>Referuar Vendimeve të Asamblesë, nga Drejtoria e Portit Detar Sarandë, janë nxjerrë Urdhërat e Brendshëm nr.64, datë 24.06.2019, nr.82, datë 08.08.2019 dhe nr.2, datë 14.01.2020 për kalimin e fondit sipas vendimeve të Asamblesë. Në vendimet e Asamblesë citohet baza ligjore neni 102, pika 4 Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë Porti Detar Sarandë dhe aksionarit mazhoritar të shoqërisë “D.C” Shkodër.</p> <p>Transferimi i shumës në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër (sot e privatizuar), është kryer në kundërshtim me Kreun I “Asambleja e Përgjithshme”, neni 135, pika 4, të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statutin e shoqërisë, miratuar në 15.06.2012, Kreun III “Asambleja e Përgjithshme”, neni 11, “Të drejtat dhe detyrimet”, në të cilat nuk ka të përcaktuar transferim fondesh për shpenzime, duke mos marrë në analizë situatën ekonomike të shoqërisë SHA “Porti Detar” Sarandë, e cila në vitet 2020-2021 ka paraqitur vështirësi financiare.</p>
Kriteri:	Kreu I, “Asambleja e Përgjithshme”, neni 135, pika 4 i Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statuti i shoqërisë, miratuar në 15.06.2012, Kreu III, “Asambleja e Përgjithshme”, neni 11, “Të drejtat dhe detyrimet”, në të cilat nuk ka të përcaktuar transferim fondesh për shpenzime.
Ndikimi/Efekti:	Ulje e nivelit të të ardhurave të shoqërisë dhe pozicionimi në vështirësi financiare.
Shkaku:	Vendim jo ligjor
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të kërkojnë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar) kthimin në llogari të Portit Detar SHA Sarandë, të shumës 13,544,581 lekë , shumë kjo e miratuar në mënyrë të kundraligjshme nga Aksionari Mazhoritar dhe përfituar nga Shoqëria “D.C” Shkodër në vitin 2020, për detyrimet e pagave ndaj punonjësve të saj.
Rekomandim:	Ministria e Financave, në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar të SHA “Porti Detar” Sarandë, të nxjerrë përgjegjësitë, lidhur me efektin negativ të krijuar në buxhetin e SHA “Porti Detar” Sarandë, në shumën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

	13,544,581 lekë , të konstatuar nga KLSH si pasojë e 3 vendimeve të kundraligjshme, të marra nga Asambleja e SHA “Porti Detar” Sarandë, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike.
Rekomandim:	Ministria e Financave, Drejtoria e Inspektimit Financiar, të ushtrojë kontroll në shoqërinë “D.C” Shkodër, mbi destinacionin e përdorimit të fondit 13,544,581 lekë dhe përfituesve duke bërë me dije Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi rezultatet e kontrollit nga Drejtoria e Inspektimit Financiar. Gjithashtu, të përcillet në KLSH, edhe lista emërore e përfituesve si dhe pozicionet e tyre përkatëse, në shoqërinë “D.C” Shkodër.

Procedurat e auditimit për blerje të vogla.

-Për vitin 2018 është nxjerr urdhëri me Nr.149 Prot., datë 07.03.2018 i komisionit të blerjeve të vogla me përbërje: (L.E, N.K dhe D.K).

-Për vitin 2019 është nxjerr urdhëri me Nr.94 Prot., datë 25.02.2019 i komisionit të blerjeve të vogla me përbërje: (L.E, Th.M dhe D.K).

-Për vitin 2020 është nxjerr urdhëri me Nr.70 Prot., datë 21.02.2020 i komisionit të blerjeve të vogla me përbërje: (L.E, A.Sh dhe D.K).

-Për vitin 2021 është nxjerr urdhëri me Nr.22 Prot., datë 25.01.2021 i komisionit të blerjeve të vogla me përbërje: (L.E, K.Sh dhe D.K).

-Për vitin 2022 është nxjerr urdhëri me Nr.44 Prot., datë 01.02.2022 i komisionit të blerjeve të vogla me përbërje: (L.E, K.Sh dhe D.K).

Nga auditimi i dokumentacionit dhe sistemit elektronik të APP për vitin 2021 dhe 2022, Autoriteti Kontraktor Porti Detar SHA Sarandë, ka realizuar 12 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël, si dhe 9 procedura me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSH me prokurim të drejtpërdrejtë disa nga të cilat të pasqyruara si më poshtë:

Procedurat e blerjeve të vogla për vitin 2021

Blerje Kancelari

Në datë 12.02.2021, nga ana e Kryetarit të Degës së Burimeve Njerëzore, është bërë një memo e cila në hartimin e saj është aprovuar nga Titullari. Me shkresën me nr. 53 Prot., datë 12.02.2021, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përllogaritur vlerën e fondit limit. Përllogaritja e vlerës së fondit limit, është bërë me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku janë marr ofertat e 3(tre) operatorëve ekonomikë, konkretisht OE “E.M” SHPK, “M.” SHPK dhe “I.” SHPK. Fondi limit i përllogaritur është 650,000 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër Prokurimi me nr. 53/1 Prot., datë 12.02.2021, ku ka të përcaktuar fondin limit. Është hartuar ftesa për ofertë nga ku është përcaktuar datë e zhvillimit të procedurës 18.02.2021 ora 14.00. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike.

Në këtë procedurë morën pjesë 22 operatorë ekonomik ku 1(një) ofertë është mbi fondin limit. Janë tërhequr nga procedura 5(pesë) OE të cilët nëpërmjet sistemit elektronik kanë të dokumentuar arsyet e tërheqjes ndërkohë që OE “L.D” SHPK nëpërmjet sistemit elektronik ka njoftuar se do paraqitet për të lidhur kontratën por më pas nuk ka dhënë arsyet se përse nuk është paraqitur. Është shpallur fitues OE “I.o” SHPK me ofertë ekonomike 460,000 lekë pa TVSH. Me faturën tatimore nr. 7549/2022, datë 07.06.2022 është likuiduar operatori ekonomik “I.o” SHPK me vlerën 460,000 lekë.



Nga auditimi u konstatuan se:

Sasia e përllogaritur nuk është mbështetur në gjendjen në magazinë, konsumin mesatar mujor, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimit si dhe nevojën, eksperincën e kaluar. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 pika 7.

Në urdhërin e prokurimit është përcaktuar fondi limit. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56 si dhe Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021, pika 8.

Në ftesen për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56, pika 4.

Anëtarët e komisionit nuk kanë dokumentuar që në datën dhe orën e përcaktuar 3 (tre) anëtarët në mënyrë individuale sipas Manualit Teknik, udhëzimit nr.5, datë 25.06.2021, seksioni Manuali Teknik, Hapja e ofertave. Kjo duhet të shoqërohej me procesverbalin përkatës.

Pastrim i njësive të brendshme dhe të jashtme 2021

Me datë 22.07.2021, nga ana e Kryetarit të Degës së Burimeve Njerëzore, është bërë një memo e cila në hartimin e saj është aprovuar nga Titullari. Me shkresën me nr. 221 Prot., datë 11.08.2021, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përllogaritur fondin limit. Përllogaritja e fondit limit është bërë me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku janë marr ofertat e 3(tre) operatorëve ekonomikë (OE). Fondi limit i përllogaritur është 99,999 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër Prokurimi me nr. 221/1 Prot., datë 11.08.2021, ku ka të përcaktuar fondin limit. Është bërë Ak-Marrja në dorëzim me nr.221/4 Prot., datë 06.12.2021. Me faturën tatimore nr. 22/2021, datë 09.02.2022 është likuiduar operatori “D.N” me vlerën 98,000 lekë pa TVSH.

F.V Mermete Mekanike në gardhet rrethuese, derë rrëshqitëse 9 ml, vijëzim territori etj.

Me shkresën me nr. 211 Prot., datë 05.08.2021, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përllogaritur fondin limit. Përllogaritja e fondit limit është bërë me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku janë marr ofertat e 3(tre) operatorëve ekonomikë (OE). Fondi limit i përllogaritur është 99,308 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër Prokurimi me nr. 211/1 Prot., datë 05.08.2021 ku ka të përcaktuar fondin limit. Është bërë Ak-Marrja në dorëzim me Nr.211/4Prot., datë 15.08.2021.

Riparim i njësive të brendshme dhe të jashtme të sistemit të kondicionimit VRF në Terminalin e Udhëtarëve.

Me shkresën me nr. 324 Prot., datë 26.11.2021, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përllogaritur fondin limit. Përllogaritja e fondit limit është bërë me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku janë marr ofertat e 3(tre) operatorëve ekonomikë (OE). Fondi limit i përllogaritur është 96,250 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër prokurimi me nr. 324/1 Prot., datë 26.11.2021 ku ka të përcaktuar fondin limit. Është bërë Ak-Marrja në dorëzim me nr. 324/4 Prot., datë 09.12.2021.

Procedurat e blerjeve të vogla për vitin 2022

Blerje Kancelari

Me datë 20.04.2022, nga ana e Kryetarit të Degës së Burimeve Njerëzore, është bërë një memo e cila në hartimin e saj është aprovuar nga Titullari. Me shkresën me nr. 168 Prot., datë 26.04.2022, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përllogaritur fondin limit në kërkesë. Përllogaritja e fondit limit është bërë me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku janë marr ofertat e 3(tre) operatorëve ekonomikë (OE), konkretisht OE “A.M” me ofertë ekonomike 656,875 lekë me TVSH, “M.O” me ofertë ekonomike 517,000 lekë me TVSH, “M” me ofertë ekonomike 779,250 lekë me TVSH. Fondi limit i përllogaritur është 550,000 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër Prokurimi me nr. 168/2 Prot., datë



26.04.2022, ku ka të përcaktuar fondin limit. Është hartuar ftesa për ofertë nga ku është përcaktuar datë e zhvillimit të procedurës data 04.05.2022, ora 14.00. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Në këtë procedurë morën pjesë 17 (shtatëmbëdhjetë) operatorë ekonomike ku 1 (një) ofertë është klasifikuar anomalisht e ulët. Janë tërhequr nga procedura 6 (gjashtë) OE të cilët nëpërmjet sistemit elektronik kanë të dokumentuar arsyet e tërheqjes ndërkohë që OE “B.S” SHPK nuk ka dhënë arsyet se përse nuk është paraqitur. Është shpallur fitues OE “I.o” SHPK me ofertë ekonomike 460,000 lekë pa TVSH. Me faturën tatimore nr.7549/2022, datë 07.06.2022, është likuiduar operatori “I.o” SHPK me vlerën 460,000 lekë me pa TVSH.

Nga auditimi, rezultoi:

Memo e dërguar për aprovim apo miratim nga ana e titullarit është bërë përpara kërkesës së Kryetarit të degës së Programimit dhe Investimit. Miratimi i titullarit në cdo rast bëhet pas kërkesës nga dega përkatëse. Në kërkesë është pasqyruar edhe përllogaritja e fondit limit. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël përllogarit fondin limit për sasinë e mallrave që prokuron. Kjo në kundërshtim me VKM Nr.285 datë 19.05.2021 neni 56 pika 4 si dhe Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 pika 7 ku citon:

Në përllogaritjen e bërë dokumentacioni i administruar nga 3 OE rezulton se janë dërguar ofertat ekonomike ku kanë të përllogaritur dhe TVSH. Ndërkohë që në mesataren e 3 (tre) ofertave të administruara, Kryetari i Degës, ka përllogaritur fondin limit 550,000 lekë pa TVSH. Në përllogaritjen e fondit limit administrimi i ofertave ekonomike bëhet pa përllogaritur TVSH. Sasia e përllogaritur nuk është mbështetur në gjendjen në magazinë, konsumin mesatar mujor, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimit si dhe nevojën, eksperincën e kaluar. Kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7. Në urdhërin e prokurimit, është përcaktuar fondi limit. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56 si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 8. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56 pika 4.

Anëtarët e komisionit nuk kanë dokumentuar që në datën dhe orën e përcaktuar 3 (tre) anëtarët në mënyrë individuale sipas Manualit Teknik, udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021, seksioni Manuali Teknik, Hapja e ofertave. Kjo duhet të shoqërohej me procesverbalin përkatës.

Blerje materiale elektrike

Me datë 03.05.2022, nga ana e Kryetarit të Degës së Burimeve Njerëzore, është bërë një memo e cila në hartimin e saj është aprovuar nga Titullari. Me shkresën me nr. 183 Prot., datë 09.05.2022, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përllogaritur fondin limit në kërkesë. Përllogaritja e fondit limit është bërë me testim tregu me 3 (tre) oferta nga ku janë marrë ofertat e 3 (tre) operatorëve ekonomikë, konkretisht OE “M.Gj” PF me ofertë ekonomike 240,000 lekë pa TVSH, “N” SHPK me ofertë ekonomike 336,820 lekë pa TVSH, “S.V ” PF me ofertë ekonomike 283,600 lekë pa TVSH. Fondi limit i përllogaritur është 310,000 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër Prokurimi me nr.183/2 Prot., datë 10.05.2022, ku ka të përcaktuar fondin limit. Është hartuar ftesa për ofertë nga ku është përcaktuar data e zhvillimit të procedurës data 16.05.2022, ora 14.00. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike.

Në këtë procedurë morën pjesë 23 (njëzetëtre) operatorë ekonomike ku 11 (njëmbëdhjetë) oferta janë mbi fondin limit. Është shpallur fitues OE “T.P” SHPK i renditur i pari me ofertë ekonomike 210,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi rezultoi se:

Memo e dërguar për aprovim apo miratim nga ana e titullarit është bërë përpara kërkesës së Kryetarit të degës së Programimit dhe Investimit. Në kërkesën e bërë, pasqyrohet dhe



përlllogaritja e vlerës së fondit limit. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, përlllogarit fondin limit për sasinë e mallrave që prokuron. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56, pika 4 si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7.

Sasia e përlllogaritur nuk është mbështetur në gjendjen në magazinë, konsumin mesatar mujor, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimit si dhe nevojën, eksperincën e kaluar. Kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7. Në urdhërin e prokurimit është përcaktuar fondi limit. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56 si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 8. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56. Anëtarët e komisionit nuk kanë dokumentuar që në datën dhe orën e përcaktuar 3 (tre) anëtarët në mënyrë individuale sipas Manualit Teknik, *udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021*, seksioni Manuali Teknik, Hapja e ofertave. Kjo duhet të shoqërohet me procesverbalin përkatës. Magazinieri, nuk është anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave të procedurës prokurimit. Kjo në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, neni 37, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

Blerje materiale hidraulike

Me datë 03.05.2022, nga ana e Kryetarit të Degës së Përpunimit të Anijeve/Trageteve dhe Zhvillimit të Projekteve, është bërë një memo e cila në hartimin e saj është aprovuar nga Titullari. Me shkresën nr. 179 Prot., datë 06.05.2022, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përlllogaritur fondin limit. Përlllogaritja e fondit limit është bërë me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku janë marr ofertat e 3(tre) operatorëve ekonomikë, konkretisht “M.Gj” PF me ofertë ekonomike 240,000 lekë pa TVSH, “N” SHPK me ofertë ekonomike 241,700 lekë pa TVSH, “A” SHPK me ofertë ekonomike 238,310 lekë pa TVSH. Fondi limit i përlllogaritur është 310,000 lekë pa TVSH. Është nxjerr Urdhër Prokurimi me nr. 179/2 Prot., datë 10.05.2022, ku ka të përcaktuar fondin limit. Është hartuar ftesa për ofertë nga ku është përcaktuar datë e zhvillimit të procedurës, data 13.05.2022, ora 14.00. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Në këtë procedurë morën pjesë 18(tetëmbëdhjetë) operatorë ekonomikë ku 9(njëmbëdhjetë) oferta janë mbi fondin limit. Janë tërhequr nga procedura 7 (OE) të cilët nëpërmjet sistemit elektronik kanë njoftuar tërheqjen me arsyet përkatëse. OE “J.G” ka njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik se do paraqitet në kohë për realizimin e procedurës. Është skualifikuar ky OE nga komisioni pasi sipas komisionit nëpërmjet një procesverbali të mbajtur nga anëtarët e saj bëjnë me dije se skualifikimi ka ndodhur sepse OE nuk ka sjellë mallin brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Procedura është anuluar me shkresën nr. 179/5 Prot., datë 03.06.2022. Është zhvilluar përsëri procedura e cila me faturën tatimore nr. 26/2022, datë 24.06.2022, është likuiduar operatori “P.N” me vlerën 235,000 lekë pa TVSH për shërbimin e kryer

Nga auditimi rezultoi se:

Memo e dërguar për aprovim apo miratim nga ana e titullarit është bërë përpara kërkesës së Kryetarit të degës së Programimit dhe Investimit. Në kërkesën e bërë është pasqyruar edhe përlllogaritja e vlerës së fondit limit. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël përlllogarit fondin limit për sasinë e mallrave që prokuron, kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56, pika 4 si dhe udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7. Sasia e përlllogaritur nuk është mbështetur në gjendjen në magazinë, konsumin mesatar mujor, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimit si dhe nevojën, eksperincën e kaluar, kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7. Në urdhërin e prokurimit është përcaktuar fondi limit, kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56 si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 8. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Specifikimet i shërbejnë Autoritet Kontraktor (AK) për të vertetuar se mallrat e lëvruar janë cilësorë dhe në përputhje me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

standartet kombëtarë dhe ndërkombëtarë, kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56, pika 4. Anëtarët e komisionit nuk kanë dokumentuar që në datën dhe orën e përcaktuar 3 (tre) anëtarët në mënyrë individuale sipas Manualit Teknik, udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021, seksioni Manuali Teknik, Hapja e ofertave. Magazinieri nuk është anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, neni 37, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

Blerje karburant për automjetet

Me datë 06.09.2022 nga Kryetari i Degës së Burimeve Njerëzore, është bërë një memo e cila në hartimin e saj është aprovuar nga Titullari. Me shkresën nr. 340/1 Prot., datë 09.09.2022, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përlllogaritur fondin limit. Përlllogaritja e fondit limit është bërë referuar cmimit në bursë sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF në Shqipëri i cili është i publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave duke përfshirë dhe elementet fiskalë, përfshi akcizën, taksën e karbonit si dhe cdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi si dhe marzhit më të ulët të fitimit të shprehur në përqindje. Fondi limit i përlllogaritur është 450,000 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër Prokurimi me nr. 340/2 Prot., datë 12.09.2022, ku ka të përcaktuar fondin limit. Është hartuar ftesa për ofertë nga ku është përcaktuar data e zhvillimit të procedurës, data 22.09.2022, ora 14.00. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Në kërkesën e bërë, Kryetari i Degës nuk duhet të kishte bërë përlllogaritjen e fondit limit. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël përlllogarit fondin limit për sasinë e mallrave që prokuron. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56, pika 4 si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021. Sasia e përlllogaritur nuk është mbështetur në gjendjen në magazinë, konsumin mesatar mujor, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimit si dhe nevojën e eksperincës së kaluar. Kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7. Në urdhërin e prokurimit është përcaktuar fondi limit. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56 si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 8. Anëtarët e komisionit nuk kanë dokumentuar që në datën dhe orën e përcaktuar 3 (tre) anëtarët në mënyrë individuale. Kjo duhet të shoqërohej me procesverbalin përkatës.

Blerje veshmbathje

Me datë 27.06.2022, nga ana e Kryetarit të Degës së Burimeve Njerëzore, është bërë një memo e cila në hartimin e saj është aprovuar nga Titullari. Me shkresën nr. 11 Prot., datë 28.06.2022, Kryetari i degës së Programimit dhe Investimit, ka bërë kërkesën dhe njëkohësisht ka përlllogaritur fondin limit në kërkesë. Përlllogaritja e fondit limit është bërë me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku janë marrë ofertat e 3(tre) operatorëve ekonomikë, konkretisht OE “B.S”, “D” dhe “A.R”. Fondi limit i përlllogaritur është 250,000 lekë pa TVSH. Është nxjerr urdhër Prokurimi me nr. 258/2 Prot., datë 28.06.2022 ku ka të përcaktuar fondin limit. Është hartuar ftesa për ofertë nga ku është përcaktuar datë e zhvillimit të procedurës. Në ftesën për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Në këtë procedurë morën pjesë 8(tetë) operatorë ekonomik ku 4 oferta janë mbi fondin limit. Janë tërhequr 3(tre) OE të cilët nëpërmjet sistemit elektronik kanë njoftuar tërheqjen me arsyet përkatëse. Është shpallur fitues OE “G.S” me ofertë ekonomike 242,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi rezultoi se:

Sasia e përlllogaritur nuk është mbështetur në gjendjen në magazinë, konsumin mesatar mujor, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimit si dhe nevojën, eksperincën e kaluar. Kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7.

Në urdhërin e prokurimit është përcaktuar fondi limit. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

datë 19.05.2021, neni 56 si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 8. Në ftesen për ofertë nuk janë hartuar specifikimet teknike. Specifikimet i shërbejnë Autoritet Kontraktor për të vërtetuar se mallrat e lëvruar janë cilësorë dhe në përputhje me standartet kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56, pika 4.

Për sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Memot e dërguara për aprovim apo miratim nga ana e titullarit bëhen përpara kërkesës së Kryetarit të degës së Programimit dhe Investimit.

-Përlllogaritja e fondit limit nuk i ngarkohet strukturës së posacme por bëhet nga kryetari i degës së programimit dhe investimit.

-Sasia e përlllogaritur në të gjitha procedurat e audituara, nuk mbështetet në gjendjen në magazinë, konsumin mesatar mujor, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimit si dhe nevojën, eksperincën e kaluar.

-Në urdhërin e prokurimit përcaktohet fondit limit.

-Në ftesen për ofertë nuk hartohen specifikimet teknike.

-Anëtarët e komisionit nuk dokumentojnë që në datën dhe orën e përcaktuar 3 (tre) anëtarët në mënyrë individuale sipas Manualit Teknik.

-Magazineri nuk është anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Udhëzimin nr. 5, datë 26.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, komisioni i blerjeve të vogla.

Titulli i gjetjes	Mangësi në argumentimin dhe dokumentimin e mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi, grupi i auditimit konstatoi se në shumicën e rasteve, komisionet e blerjeve të vogla nuk kanë argumentuar nevojën e blerjes së mallrave/materialeve duke mos e krahasuar me sasinë e mallrave në magazinë ose konsumin mesatar mujor. Konkretisht për procedurat me objekte, “Blerje kancelari”, “Blerje goma”, “Blerje veshmbathje”, “Blerje karburant”, “Blerje materiale hidraulike”, “Blerje materiale elektrike”, etj, të zhvilluara në për periudhën objekt auditimi, në praktikat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua mungesë dokumentacioni dhe argumentimi lidhur me nevojat reale të Portit Detar SHA Sarandë për sasinë e mallrave ose materialeve të prokuruar. Në kërkesat e bëra në hartimin e nevojave ishte përlllogaritur dhe fondi limit në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.
Kriteri:	VKM Nr.285 datë 19.05.2021 neni 56 pika 4 (Procedura e prokurimit me vlerë të vogël) Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 neni 7 (Mbi përdorimin e e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike)
Ndikimi/Efekti:	Bëhet precedent për fryrjen fiktive të sasisë të mallrave/materialeve në të ardhmen përtej nevojave të institucionit.
Shkaku:	Nuk është zbatuar legjislacioni i prokurimit publik.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Rëndësia:	E Mesme.
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, komisionet e prokurimit për blerje të vogla, në të ardhmen të marrin masa që përpara zhvillimit të procedurave me vlera të vogla të argumentojnë dhe dokumentojnë nevojat e materialeve/mallrave që do të prokurohen duke i krahasuar ato me gjendjen aktuale në magazinë konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti:

- Lista e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën 2018-2020.
- Dosjet e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Komisionet e prokurimeve për blerjet e vogla të ngritura gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, kanë hartuar regjistrin e blerjeve me vlera të vogla, i cili bashkuar me regjistrat e parashikimit të blerjeve është dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Për Vitin 2018.

-Porti Detar Sarandë SHA, ka ngritur komisionin e prokurimit me vlerë të vogël me shkresën me nr. 149 Prot., datë 07.03.2018 me përbërje L.E, N.K dhe D.K. Për këtë vit, Porti Detar Sarandë SHA ka zhvilluar në total 21 procedura prokurimi me vlerë të vogël. Vlera totale e prokuruar për të gjitha procedurat është 6,933,802 lekë pa TVSH.

-Nga auditimi me zgjedhje i procedurave me vlerë të vogël të zhvilluara në vitin 2018, rezultoi si në vijim:

-Në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje materiale hidraulike dhe elektrike*” me fond limit të përlloritur në vlerën 750,000 lekë pa TVSH dhe vlerë të ofertuar dhe të likujduar për blerjen e mallrave në 528,500 lekë pa TVSH, u konstatua se nga Titullari i Portit Sarandë SHA, nuk ka urdhër për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të materialeve. Personat që kanë marrë në dorëzim materialet sipas procesverbalit të mbajtur në datën 06.04.2018, janë Th.M, P.J dhe S.A, pra të ndryshëm nga përbërja e komisionit të blerjeve të vogla dhe kanë nënshkruar pa patur më parë një urdhër nga Titullari i Institucionit.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje Veshëmbathje dhe materiale për Forcat e Sigurisë së Portit*” me fond limit të përlloritur në vlerën 700,000 lekë pa TVSH dhe vlerë të ofertuar dhe të likujduar për blerjen e mallrave në 558,500 lekë pa TVSH, u konstatua se nga Titullari i Portit Sarandë SHA, nuk ka urdhër për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të materialeve. Personat që kanë marrë në dorëzim materialet sipas procesverbalit të mbajtur në datën 19.04.2018, janë A.F, D.B dhe E.K pra të ndryshëm nga përbërja e komisionit të blerjeve të vogla dhe kanë nënshkruar pa patur më parë një urdhër nga Titullari i Institucionit.

-Njësoj është vepruar edhe për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera për procedurën e prokurimit me objekt “*Remont Gjeneratori*”. Edhe në këtë rast grupi i marrjes në dorëzim të shërbimit, ka nënshkruar procesverbalin e marrjes në dorëzim pa patur më parë një urdhër për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim. Njësoj edhe për marrjen në dorëzim të procedurave të tjera si ato me objekt “*Blerje Kancelari*”, “*Blerje materiale hidrosanitare*”, “*Blerje paisje informatike dhe elektronike*”, “*Blerje materiale hidrosanitare*”, etj.

Për Vitin 2019.

-Porti Detar Sarandë SHA, ka ngritur komisionin e prokurimit me vlerë të vogël me shkresën me nr. 94 Prot., datë 25.02.2019 me përbërje L.E, Th.M dhe D.K. Për këtë vit, Porti Detar Sarandë SHA ka zhvilluar në total 25 procedura prokurimi me vlerë të vogël. Vlera totale e prokuruar për të gjitha procedurat është 7,169,936 lekë pa TVSH.



Për Vitin 2020.

-Porti Detar Sarandë SHA, ka ngritur komisionin e prokurimit me vlerë të vogël me shkresën me nr. 70 Prot., datë 21.02.2020 me përbërje L.E, A.Sh dhe D.K. Për këtë vit, Porti Detar Sarandë SHA ka zhvilluar në total 17 procedura prokurimi me vlerë të vogël. Vlera totale e prokuruar për të gjitha procedurat është 3,644,471 lekë pa TVSH.

-Për vitet 2019 dhe 2020, nuk konstatohen mungesa të urdhrave për përcaktimin e komisioneve për marrjen në dorëzim të shërbimeve apo mallrave.

9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve dhe zbatimin e detyrimeve të ndërsjellëta.

Në lidhje me dhënien me qira të pronës publike konstatohet se:

Në lidhje me dhënien me qira të pronës publike konstatohet se:

Për periudhën 2018-2022, Shoqëria “Porti Detar Sarandë” SHA, ka dhënë me qira një bar-verandë dhe 13 ambiente (zyra) subjekteve private, bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurive shtetërore”, si dhe nenet 801/825 të Kodit Civil dhe vendimeve të këshillit mbikëqyrës.

Per vitin 2018 rezulton si me poshte:

1-Kontratë qiraja nr.294 Prot., datë 23.04.2018, data e lidhjes së kontratës 20.04.2018. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e dates 23.04.2018. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "K" mban datën 14.03.2018 .

2-Kontratë qiraja nr.233 Prot., datë 04.04.2018, data e lidhjes së kontratës 20.03.,2018. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi data e marrjes në dorëzim të objektit 04.04.2018. Kërkesa e personit fizik I.H drejtuar shoqërisë, për marrjen me qira të ambientit zyrtë është e kompanise I.A.T and tour me date 28.12.2017.

3-Kontratë qiraja nr.225/1 Prot., datë 04.04.2018, data e lidhjes së kontratës 20.03.2018. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi mungon data e marrjes në dorëzim të objektit. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga personi fizik E.P per rinovim kontrate mban datën 01.04.2018.

4-Kontratë qiraja nr.274 Prot., datë 04.04.2018 data e lidhjes së kontratës 20.03.2018. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi data e marrjes në dorëzim të objektit 04.04.2018. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga personi fizik A.E, mban datën 28.01.2018.

5-Kontratë qiraja nr.225 Prot., datë 04.04.2018 data e lidhjes së kontratës 20.03.2018. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi data e marrjes në dorëzim të objektit 04.04.2018. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga personi B.F, mban datën 12.03.2018.

6-Kontratë qiraja nr. 967 Prot., datë 31.12.2018 data e lidhjes së kontratës 30.12.2018. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi data e marrjes në dorëzim të objektit 01.01.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga personi fizik “L.A” SHPK, mban datën 26.12.2018.

7-Kontratë qiraja nr. 517 Prot., datë 20.06.2018 data e lidhjes së kontratës 19.06.2018. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi data e marrjes në dorëzim të objektit 20.06.2018. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga personi fizik “S.Q” SHPK, mban datën 06.06.2018.

8-Kontratë qiraja nr.968 Prot., datë 31.12.2018, mungon dokumenti i njoftimit të lidhjes së kontratës. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi data e marrjes në dorëzim e objektit mungon. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga personi fizik A.D z.D.M, mban datën 03.12.2018.



Per vitin 2019 rezulton si me poshtë:

- 1-Kontratë qiraja nr.187 prot datë 01.04.2019, data e lidhjes së kontratës 25.03.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e datës 01.04.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "E.P" mban datën 05.03.2019.**
- 2-Kontratë qiraja me Nr.187 Prot datë 01.04.2019, data e lidhjes së kontratës 25.03.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e dates 01.04.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "E.P" mban datën 05.03.2019.**
- 3-Kontratë qiraja nr.236/1 Prot.,datë 15.04.2019, data e lidhjes së kontratës 15.04.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e dates 15.04.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "A.H.S.T" mban datën 20.03.2019.**
- 4-Kontratë qiraja nr.145 Prot.,datë 18.03.2019, data e lidhjes së kontratës 15.03.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e dates 18.03.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "A.D.E.S" mban datën 01.03.2019.**
- 5-Kontratë qiraja nr.307 Prot.,datë 06.05.2019, data e lidhjes së kontratës 03.05.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e dates 06.05.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "E.A" nuk ka të specifikuar datën e kësaj kërkesë.**
- 6-Kontratë qiraja nr.189/2 Prot.,datë 01.04.2019, data e lidhjes së kontratës. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është bërë akt-dorëzimi me datë 06.05.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "A.T.J.P" mban datën 19.03.2019.**
- 7-Kontratë qiraja nr.268/1 Prot.,datë 23.04.2019, data e lidhjes së kontratës 23.04.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e datës 23.04.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "K&M" SHPK mban datën 23.04.2019.**
- 8-Kontratë qiraja nr.900 Prot.,datë 31.12.2019, data e lidhjes së kontratës 27.12.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi data e marrjes në dorëzim të objektit nuk është e saktë. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "L.A" mban datën 03.02.2020.**
- 9-Kontratë qiraja nr.890 Prot.,datë 31.12.2019, data e lidhjes së kontratës 27.12.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e datës 31.12.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "A.C.R" mungon.**
- 10-Kontratë qiraja nr.189 Prot.,datë 01.04.2019, data e lidhjes së kontratës 25.03.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e dates 01.04.2019. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "I.A.T&T" mungon.**
- 11-Kontratë qiraja nr.188 Prot.,datë 01.04.2019, data e lidhjes së kontratës 29.03.2019. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi mungon data. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "C.R.C" SHPK është e datës 01.03.2018.**

Për vitin 2020 rezulton si më poshtë:

- 1-Kontratë qiraja nr.158 Prot.,datë 04.05.2020, data e lidhjes së kontratës 30.04.2020. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi mungon data e marrjes në dorëzim të objektit. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "E.A" nuk ka datë.**
- 2-Kontratë qiraja te ciles i mungon numri i protokollit, datë 17.04.2020, data e lidhjes së kontratës 07.04.2020. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi mungon data e marrjes në dorëzim të objektit. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "A.C.T" mban datën 27.02.2019.**
- 3-Kontratë qiraja nr.131/1 Prot.,datë 30.03.2020, data e lidhjes së kontratës 17.03.2020. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është e datës 30.03.2020. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "J.T" ka datën 30.03.2020.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË "PORTI DETAR" SARANDË

4-Kontratë qiraja nr.131/4 Prot.,datë 20.04.2020, data e lidhjes së kontratës 25.04.2020. Në akt dorëzimin e kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi mungon data e marrjes në dorëzim të objektit. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "K&M" SHPK ka datën 09.06.2020.

5-Kontratë qiraja nr.212/1 Prot., datë 01.07.2020, data e lidhjes së kontratës 19.06.2020. Akt dorëzimi i kësaj kontrate nga shoqëria te qiramarrësi është me datë 01.07.2020. Kërkesa drejtuar shoqërisë nga "A.S.T" ka datën 04.06.2020.

Për vitin 2022, janë lidhur kontrata qiraje si në vijim:

1-Kontrata me nr. 327/2 Prot., datë 23.08.2022. Objekti i kontratës është qira për ambjentin zyrë në katin e dytë, Porti Sarandë, me sipërfaqe totale 13.1 m², lidhur me subjektin A.Sh me lidhje kontrate me nr. 327/1 Prot., datë 22.08.2022.

2-Kontrata me nr. 243 Prot., datë 16.06.2022. Kontratë qiraje për dhënien me qira të objektit zyrë në terminalin e Portit Sarandë, kati i dytë me sipërfaqe 17.8 m², dhënë subjektit G.H me lidhje kontrate me nr. 127 Prot., datë 06.04.2022.

3-Kontrata me nr. 239 Prot., datë 16.06.2022. Kontratë qiraje për dhënien me qira të objektit zyrë në terminalin e Portit Sarandë, kati i dytë me sipërfaqe 11.6 m², dhënë subjektit B.G me lidhjen e kontrates me nr. 127/5 Prot., datë 06.04.2022.

4-Kontrata me nr. 242 Prot., datë 16.06.2022. Kontratë qiraje për dhënien me qira të objektit zyrë në terminalin e Portit Sarandë, kati i dytë me sipërfaqe 9.7 m², dhënë subjektit J.P me lidhje kontrate nr. 127/2 Prot., datë 06.04.2022.

5-Kontrata me nr. 240 Prot., datë 16.06.2022. Kontratë qiraje për dhënien me qira të objektit zyrë në terminalin e Portit Sarandë, kati i dytë me sipërfaqe 13.2 m², dhënë subjektit E.I me lidhje kontrate me nr. 127/4 Prot., datë 06.04.2022.

6-Kontrata me nr. 241 Prot., datë 16.06.2022. Kontratë qiraje për dhënien me qira të objektit zyrë në terminalin e Portit Sarandë, kati i dytë me sipërfaqe 10.3 m², dhënë subjektit J.H me lidhje kontrate nr. 127/1 Prot., datë 06.04.2022.

Sipërfaqet në pronësi të shoqërisë paraqiten si në tabelën më poshtë.

Nr.	Emërtimi	Nj/matje	Sipërfaqe
1	Zyre	m ²	13.1
2	Zyre	m ²	17.8
3	Zyre	m ²	11.6
4	Zyre	m ²	9.7
5	zyre	m ²	13.2
6	zyre	m ²	10.3
Sipërfaqe totale			75.7

Burimi: Të dhënat e shoqërisë.

Në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i vlerësimit të ofertave, me nr. 134, datë 20.03.2017, rezultojnë të dhëna me qira për vitin 2022, 6 ambiente (zyra), të dhëna tek subjektet private të interesuara.

Nga auditimi konstatohet se në datën 03.06.2022, është mbledhur Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë ku si rend dite ka qenë miratimi për dhënien me qira të zyrave në terminalin e udhëtarëve dhe turistëve të Portit Detar Sarandë. Me vendimin nr. 4 të datës 09.06.2022, Këshilli Mbikqyrës, ka miratuar dhënien me qira të zyrave ku cmimi për metër katror do të jetë, 2.200 lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Në dosjet e audituara, nuk gjendet procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit, në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", pika VI "Monitorimi i kontratave", pika 2. Ka parregullsi në



përgatitjen e dokumentacionit për dhënien me qira të ambienteve në disponim, në disa subjekte të cituara më sipër ka dokumente pa datë. Në kontratën e "A.C.T" mungon numri i protokollit. Në vitin 2019, dy subjekteve përkatësisht "I.A.T&T" dhe "A.C.R" u mungon kërkesa për qiramarrjen e objektit, në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriteve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika II “Procedurat e dhënies me qira ose emfiteozë të pasurisë shtetërore”, pika 7 (a).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 389 Prot., datë 24.04.2023 dhe nr. 1080/4 Prot., datë 02.05.2023 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, nga z. A.Q, z. K.Sh, znj. M.J, znj. L.E, znj. A.J, z. Th.Th, znj. R.A, znj. H.I, z. S.A dhe znj. D.K, ku janë shprehur objeksionet lidhur me rekomandimin organizativ nr. 10.1 të Projekt Raportit të auditimit si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *“Për sa më sipër, sqarojmë se sa i përket kontratave të zyrave, kontratat janë lidhur mbi bazën e planimetrisë të objektit. Sa më sipër sqarojmë se bazuar në ligjin nr. 9901/2001 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, statutit të Shoqërisë, Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë si organi me i lartë vendimarrës i shoqërisë, ka nxjerr vendimin nr. 14, datë 12.07.2016, për dhënien e zyrave me qira që ndodhen në Terminalin e udhëtarëve dhe turistëve, Drejtori i Shoqërisë, bazuar përsa më lartë, ka nxjerr urdhërin e brendshëm nr. 6, datë 01.02.2017, për ngritjen e komisionit për dhënien e zyrave me qira në terminalin e udhëtarëve dhe turistëve të Shoqërisë. Gjithashtu Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë, me vendim nr. 4, datë 09.06.2022, ka marrë vendim për miratimin e dhënies me qira të zyrave në terminalin e udhëtarëve dhe turistëve, ku është përcaktuar edhe cmimi për metër katror. Sqarojmë se vlera kontabël e Objekteve (zyra në Terminalin e Udhëtarëve dhe Turistëve, të dhënë me qira), ku vlera kontabël përfshihet në vlerën totale të Objektit të Terminalit të Udhëtarëve dhe Turistëve të Portit Detar Sarandë. Gjithashtu sqarojmë se qiraja mujore për cdo zyrë të dhënë me qira tek subjektet private që operojnë në Portin Detar Sarandë, është e përcaktuar në cdo Kontratë të lidhur me subjektet private, dhe nga ana e Portit Detar Sarandë, u është dhënë në dispozicion gjatë auditimit tuaj të ushtruar në Shoqërinë tonë. Përsa u përket mangësive në dosjet e subjekteve private, sqarojmë se nga ana e Instucionit tonë u janë vënë në dispozicion praktikat për cdo dosje sipas cdo viti dhe zyre të dhënë me qira në subjektet private, sqarojmë se në cdo dosje është shoqëruar me gent-planin e Objektit të Terminalit të Udhëtarëve dhe Turistëve dhe gent-planin e cdo zyre të dhënë me qira dhe për ato mangësi të vogla të konstatuara nga ana e juaj, nga ana e Institucionit tonë do të merren masat menjëherë për realizimin e plotësimin të dosjeve dhe në vazhdimësi nuk do të kemi më probleme të tilla. Bashkëngjitur ju dërgojmë dokumentat, Gent- Plani i Terminalit dhe i zyrave, Vendimi i Këshilli për Sezonalet, Kopje e udhëzimit nr. 7/2015, Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, Struktura Organizative, Praktika e zyrës të dhënë me qira. Për problemet e tjera të paraqitura në projektraport, do të analizohen me përgjegjësi nga ana jonë, me qëllim eliminimin e tyre për të ardhmen dhe forcimin e zbatueshmërisë ligjore në aktivitetet e kësaj shoqërie”.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Referuar pretendimeve të mësipërme, sqarojmë se merret në konsideratë observacioni duke mos ju lënë përgjegjësi pasi nuk keni shkaktuar pasoja negative financiare me mangësitë e vogla të praktikave tuaja por rekomandimi do të jetë pjesë e këtij Raporti Përfundimtar me qëllim pasjen në konsideratë nga ana juaj të plotësimin me rigozitet të dosjeve lidhur me praktikat e dhënies me qira të ambienteve të institucionit në të ardhmen.



Titulli i Gjetjes:	Mangësi dokumentacioni në dosjet e audituara lidhur me dhënien me qira të ambienteve të Portit Detar SHA Sarandë.
Situata:	Për periudhën 2018-2022, Shoqëria “Porti Detar Sarandë” SHA, ka dhënë me qira një bar-verandë dhe 13 ambiente (zyra) subjekteve private, bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurive shtetërore”, si dhe nenet 801/825 të Kodit Civil dhe vendimeve të këshillit mbikëqyrës. Për vitin 2018, janë lidhur 8 kontrata qiraje. Për vitin 2019, janë lidhur 11 kontrata qiraje. Për vitin 2020, janë lidhur 5 kontrata qiraje dhe për vitin 2022, janë lidhur 6 kontrata qiraje. Nga auditimi i dosjeve lidhur me procedurat e ndjekura për dhenien e ambienteve me qira tek të tretët, rezultoi se në asnjë dosje nuk gjendet procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit. Për dhënien me qira të ambienteve, Porti Detar SHA Sarandë, ka lidhur kontrata qiraje bazuar vetëm tek kërkesa e ardhur nga palët e treta në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.
Kriteri:	Vendimi nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kapitulli VI “Monitorimi i kontratave”, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Dosje të pa plota.
Shkaku:	Mos respektimi i vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masa që në të ardhmen, të plotësohen dosjet respektive për procedurat e dhënies me qira të ambienteve, me dokumentacionin përkatës, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

10. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Nga auditimi konstatohet që:

Nga Porti Detar Sarandë SHA, nuk është vënë në funksionim ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Porti Detar Sarandë SHA nuk ka ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin në rregulloren e shoqërisë të miratuar me vendimin nr.6, datë 28.04.2016 të Këshillit Mbikëqyrës, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, hyrë në fuqi në 01.01.2011, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku si parësore është caktimi i nëpunësit autorizues, neni 8, pika 2, si dhe atij zbatues, neni 12. Në shoqërinë Porti Detar Sarandë nuk është caktuar ende nëpunësi autorizues dhe zbatues. Gjithashtu në bazë të këtij ligji, duhej të ishte implementuar Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, i Ministrit të



Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në mënyrë që të kishte një përcaktim më të qartë të përgjegjësive dhe nëpunësit autorizues dhe zbatues. Porti Detar Sarandë SHA, nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2, Pyetësi i vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, gërma “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.8 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësisë të sektorit publik”, gërma “a”, Porti Detar Sarandë SHA, nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, gërma “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, njësia nuk ka një Kod të Brendshëm Etik. Në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe Kap. II “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut. Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave. Nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të vecantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit, që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj. Mangësitë e mësipërme në drejtim të sistemeve të kontrollit dhe të menaxhimit financiar në Portin Detar Sarandë SHA, janë konstatuar dhe nga auditimet e mëparshme ku janë lënë dhe masa rekomanduese për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” por shoqëria Porti Detar Sarandë SHA, vazhdon të mos implementojë këtë ligj.

-Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi Titullarët e Portit Detar Sarandë SHA sipas periudhave Zj. K.S nga data 17.01.2018 deri në datën 17.07.2020 dhe në vazhdim pas kësaj date deri më 31.12.2022, Z. A.Q, pasi nuk kanë vepruar në respekt të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, “Përgjegjshmëria menaxheriale” Neni 8,

Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit:

1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË "PORTI DETAR" SARANDË

të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

2. Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji, caktojnë nëpunësit autorizues, sipas përcaktimeve të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

3. Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikat 2 e 3 të nenit 3 të këtij ligji, mund të caktojnë një nëpunës të nivelit më të lartë drejtues dhe t'i ngarkojnë atij përgjegjësi që janë të barasvlershme me ato të nëpunësit autorizues.

4. Në rast moscaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësive publike.

Titulli i Gjetjes:	Mos plotësimi i kërkesave ligjore për ngritjen e sistemeve të menaxhimit financiar.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, rezultoi se për periudhën objekt auditimi, Administratori i SHA "Porti Detar" Sarandë, nuk ka ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin në rregulloren e shoqërisë të miratuar me vendimin nr. 6, datë 28.04.2016 të Këshillit Mbikëqyrës, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku si parësore është caktimi i nëpunësit autorizues, neni 8, pika 2, si dhe atij zbatues, neni 12. Në shoqërinë Porti Detar SHA Sarandë, nga Administratori i Shoqërisë, nuk është caktuar ende nëpunësi autorizues dhe zbatues, e konstatuar kjo gjetje edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Ndikimi/Efekti:	Nuk garantohet një kontroll i brendshëm efektiv.
Shkaku:	Mos respektim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	Administratori i SHA "Porti Detar" Sarandë, të marri masat e duhura për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të nenit 15 shkronja "j" të ligjit 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, Sh.A Porti detar Sarandë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën me nr. 205 datë 26.03.2018 "Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH" për secilën masë organizative, shpërbllim dëmi, është nxjerr urdher respektiv nga administratori për zbatimin e detyrave të rekomanduara është hartuar plani i veprimit në zbatim të detyrave për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH plan i cili është miratuar me vendimin nr. 9 datë 18.05.2018 nga këshilli mbikëqyrës. Në zbatim të pikës "2" neni 30 të ligjit nr.154 viti 2014 "Për Organizimin e KLSH-së", SHA Porti Detar Sarandë, nuk ka kthyer përgjigje pranë KLSH-së mbi zbatimin e rekomandimeve brenda afatit 6 mujor (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.5, pika.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



1.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masa që në të ardhmen, të raportohet pranë KLSH-së brenda afateve të përcaktuara mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas përcaktimeve ligjore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë sintetike “Të drejta të arkëtueshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 43,955,522 lekë, e cila përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë “Klientë” në vlerën 15,493,546 lekë, e cila përbëhet nga 71 klientë të krijuar për më shumë se një vit ku pjesën më të madhe e zënë detyrimet e klientëve në vitet e kaluara prej 10,223,646 lekë.

-Gjendja e llogarisë “Të tjera të arkëtueshme”, në fund të vitit 2021 është në vlerën 28,461,979 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pjesa më e madhe e kërkesave përfaqëson detyrimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve për rimbursimin e tatim fitimit të parapaguar në vlerën 5,967,917 lekë, 2,879 lekë ndalesë për diferencë page, në vlerën 13,544,581 lekë, përfaqëson kalimin e fondit nga SHA “Porti Detar” Sarandë, në llogarinë e shoqërisë “D.C”, Shkodër, si dhe vlerën 8,946,602 lekë, që i përket TVSH-së mbartur për tu rimbursuar prej vitit 2014 e pasqyruar në llog 445 “TVSH për tu marrë”. Vlera e llogarisë 445, nga 8,946,602 lekë në fund të vitit 2022 është rritur me 496,496 lekë. Vlera e TVSH për tu rimbursuar deri në fund të vitit 2022, është 9,433,098 lekë. Me gjithë korrespondencat e vazhdueshme me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Sarandë, kjo vlerë ende nuk është rimbursuar, në kundërshtim me Ligjin 25/2018, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjin nr. 92/2014, datë 28.08.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 12. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.52, pika 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori Ekonomik, të marrin masa duke ndjekur procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të të tretëve ndaj shoqërisë, si “Klientë” në vlerën 15,493,546 lekë dhe “të drejtave të tjera të arkëtueshme”, në vlerën 28,461,979 lekë (rimbursim TVSH dhe detyrimi i shoqërisë “D.C” Shkodër), me qëllim mbledhjen e të ardhurave dhe përmirësimin e situatës financiare.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019, me Urdhrin e Brendshëm nr.122, datë 14.12.2020, Drejtori i SHA “Portit Detar” Sarandë, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 11.10.2019 dhe vendimit të Asamblesë nr.17874, datë 15.10.2020, është vendosur shpërndarja e shpërblimit për punonjësit e shoqërisë një pagë mujore pas daljes së rezultatit vjetor të vitit 2019. Drejtoria e Shoqërisë ende nuk ka shpërndarë masën e shpërblimit si pasojë e mbylljes nga Pandemia Covid-19, në kundërshtim me Kodi i Punës, neni 114 - Shpërblimi (ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996) dhe Ligjin nr. 10405 datë 24.03.2011 “Për kompetencat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve” neni 6 pika b. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.43, pika 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrin masa që shpërndarja e shpërblimeve për punonjësit të kryhet në bazë të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë, me qëllim motivimin e punonjësve për arritjen e rezultateve pozitive në punë, respektimin e kërkesave të Kodit të Punës duke ndikuar në rritjen e performancës pozitive të treguesve ekonomiko-financiar të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi



4. Gjetje nga auditimi: Baza ligjore e përdorur për përcaktimin e niveleve referuese të pagave për pozicionet e punëve mbështetëse nga viti 2018-2022, janë VKM nr. 589, datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 717, datë 23.06.2009. Kjo bazë ligjore përdoret për përcaktimin e niveleve referuese të pagave në institucionet buxhetore dhe “Portit Detar” Sha Sarandë, nuk është institucion buxhetor, pra në këto kushte nuk mund të përdorë lidhjet e përcaktuara në këtë legjislacion, vendimet nuk korrespondojnë me natyrën e shoqërisë.

-Struktura dhe niveli i pagave paraqitet me pozicione pune për 49 të punësuar. Struktura jep të dhëna në vlerë për shtesën për vjetërsi e cila i korrespondon personave të punësuar në shoqëri. Nga auditimi i kontratave individuale të punës për vitet 2018-2022, rezultoi se nuk janë përcaktuar në kontratë të gjithë elementët përbërës të pagës por vetëm paga bruto e punonjësit.

-Për vitin 2021, janë miratuar 8 punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), me pozicion pune sanitare dhe punonjës për sistemim arkive (kërkesë e DPA dhe Forcës së Sigurisë). Punonjësit me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), nuk janë miratuar me akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës, por janë miratuar me vendimet e miratimit të Planit të Zhvillimit dhe buxhetit vjetor të shoqërisë. Viti 2021, rezulton me tejkalim 4-5 punonjës, si pasojë e rekrutimit të punonjësve me kontratë në periudhën e verës.

-Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune, po kështu edhe struktura e miratuar me vendimin nr.20, datë 28.12.2022, përveç nivelit arsimor nuk pasqyron kërkesat mbi profesionin sipas vendit të punës, niveli arsimor është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune dhe për forcën e sigurisë ku kërkohet sipas udhëzimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin nr. 791 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, neni 21 “Forma e kontratës së Punës”, pika 3, gërma (h) si dhe Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” neni 6, pika 1, gërma (a) si dhe VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit”. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.43, pika 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për përcaktimin në strukturë të nivelit arsimor të çdo kategorie punonjësish sipas kërkesave të vendit të punës, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe realizimin e objektivave të shoqërisë në nivele cilësore.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, megjithëse ka ndjekur procedurat dhe afatet përcaktuar në udhëzimin përkatës, nuk ka pasqyruar tregues të harmonizuar mirë midis tyre dhe nuk ka pasur planifikim të saktë të treguesve ekonomikë dhe financiar të bazuar në rezultatet e viteve paraardhëse si edhe në mundësitë reale të shoqërisë.

Investimet për vitin 2018, janë realizuar në masën 72 %, për vitin 2019, janë realizuar në masën 30.8 % dhe për vitin 2020, janë realizuar në masën 73.5 %. Investimet për vitin 2021, nuk janë realizuar megjithëse janë programuar në vlerën 6,200 mijë lekë. Investimet për vitin 2022, janë realizuar në masën 29.7 %, nivel i ulët i realizimit të investimeve flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese për realizimin e investimeve të programuara. Shoqëria në aspektin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i programit dhe detyrimet e tjera tregtare dhe ato mbështetëse, nuk ka bërë një punë të vlerësueshme në realizimin e tyre, niveli i realizimit të shpenzimeve duhej ndjekur me përgjegjësi si për zërat me devijime nga plani ashtu edhe për shpenzimet të cilat janë në masën 100% me planifikimin, pasi shpenzimet duhet të kryhen vetëm për qëllime të domosdoshme të aktivitetit, në kundërshtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Programi ekonomik (treguesit e



programuar). *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.30, pika 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Programim Investimeve dhe Teknikës, të marrin masa për hartimin e programeve ekonomike bazuar në treguesit e realizuar në vitet e mëparshëm, në mundësitë dhe kapacitetet reale të shoqërisë dhe analizave ekonomike, të nivelit të investimeve, nivelit të shpenzimeve, numrit të punonjësve, etj, zëra të cilët duhen rishikuar dhe analizuar referuar uljes së volumit të punës, pasi shoqëria nuk kryen përpunim mallrash por vetëm pasagjerë, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara për drejtimin e shoqërisë.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, rezultoi se, Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, nuk ka ndërmarrë hapa për implementimin në rregulloren e shoqërisë të miratuar me vendimin nr. 6, datë 28.04.2016 të Këshillit Mbikëqyrës, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku si parësore është caktimi i nëpunësit autorizues, neni 8, pika 2, si dhe atij zbatues, neni 12. Në shoqërinë Porti Detar SHA Sarandë, nga Administratori i Shoqërisë, nuk është caktuar ende nëpunësi autorizues dhe zbatues, e konstatuar kjo gjetje edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.102, pika 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masat e duhura për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për inventarizimin për vitet 2018-2022, u konstatua se komisioni për vlerësimin e mallrave jashtë përdorimit përbëhet nga 3 anëtarë dhe komisioni i asgjësimit është i njëjti i përbërë nga 3 anëtarë, ndërsa referuar legjislacionit në fuqi komisioni i vlerësimit duhet të përbëhet nga 5 anëtarë dhe asgjësimit nga 7 anëtarë. Për vitin 2022 u konstatua se komisioni inventarizimit është i njëjti me komisionin e vitit 2021. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.62, pika 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masa për përcaktimin e drejtë të komisioneve të inventarizimit duke respektuar edhe numrin e tyre sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim arritjen e rezultateve të sakta të inventarizimit dhe pasqyrim të drejtë të rezultateve në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, komisionet e blerjeve të vogla nuk kanë argumentuar nevojën e blerjes së mallrave/materialeve duke mos e krahasuar me sasinë e mallrave në magazinë ose konsumin mesatar mujor. Konkretisht për procedurat me objekte, “Blerje kancelari”, “Blerje goma”, “Blerje veshmbathje”, “Blerje karburant”, “Blerje materiale hidraulike”, “Blerje materiale elektrike”, etj, të zhvilluara për periudhën objekt auditimi, në praktikën e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua mungesë dokumentacioni dhe argumentimi lidhur me nevojat reale të SHA Porti Detar Sarandë për sasinë e mallrave ose materialeve të prokuruar. Në kërkesat e bëra në hartimin e nevojave, ishte përlloritur dhe fondi limit në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.84, pika 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, komisionet e prokurimit për blerje të vogla, në të ardhmen të marrin masa që përpara zhvillimit të procedurave me vlera të



vogla të argumentojnë dhe dokumentojnë nevojat e materialeve/mallrave që do të prokurohen duke i krahasuar ato me gjendjen aktuale në magazinë konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018-2022, Shoqëria “Porti Detar Sarandë” SHA, ka dhënë me qira një bar-verandë dhe 13 ambiente (zyra) subjekteve private, bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe nenet 801/825 të Kodit Civil dhe vendimeve të këshillit mbikëqyrës. Për vitin 2018, janë lidhur 8 kontrata qiraje. Për vitin 2019, janë lidhur 11 kontrata qiraje. Për vitin 2020, janë lidhur 5 kontrata qiraje dhe për vitin 2022, janë lidhur 6 kontrata qiraje. Nga auditimi i dosjeve lidhur me procedurat e ndjekura për dhënien e ambienteve me qira tek të tretët, rezultoi se në asnjë dosje nuk gjendet procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit. Për dhënien me qira të ambienteve, Porti Detar SHA Sarandë, ka lidhur kontrata qiraje bazuar vetëm tek kërkesa e ardhur nga palët e treta. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.98, pika 9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masa që në të ardhmen, të plotësohen dosjet respektive për procedurat e dhënies me qira të ambienteve, me dokumentacionin përkatës, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”, datë 22.07.2019 të lidhur midis “N” SHPK dhe SHA Porti Detar Sarandë, u konstatua se: Afati i ekzekutimit të punimeve, është 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është me datë 22.07.2019. Me vendimin nr. 1285/1 Prot., datë 26.07.2019, KPP ka dërguar pranë PDS SHA, kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit për procedurën e prokurimit të mësipërme. Me shkresën nr. 586 Prot., datë 30.07.2019, Titullari i AK, nxjerr urdhrin e brendshëm për pezullimin e procedurës deri në marrjen e vendimit nga KPP. Me shkresën nr. 671 Prot., datë 13.09.2019, NJP e PDS SHA, vihet në dijeni për vendimin e marrë nga KPP dhe njofton Titullarin e AK për anulimin e pezullimit të procedurës dhe vazhdimin e punimeve. Punimet kanë rifilluar pas ardhjes së përgjigjes nga KPP, pra në datën 18.09.2019, sipas procesverbalit të mbajtur nga Mbikëqyrësi i punimeve. Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datën 13.10.2019. Sa më sipër, nga data 22.07.2019 deri në datën 30.07.2019, janë 9 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N” SHPK. Nga data 18.09.2019 deri në datën 13.10.2019, janë 25 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N” SHPK. Në total, operatori ekonomik “N” SHPK, ka punuar 34 ditë pune dhe jo 30 ditë sa është afati i ekzekutimit të kontratës. Pra punimet kanë përfunduar me 4 ditë vonesë. Referuar kontratës së lidhur midis Portit Detar Sarandë SHA dhe operatorit ekonomik “N” SHPK, asaj me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019, tek neni 3 “Kohëzgjatja”, cilësohet se: *“Kontrata do të konsiderohet e përfunduar me kalimin e 30 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit”*. Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve, nuk u konstatua të jetë miratuar midis AK dhe operatorit ekonomik ndonjë amendament kontrate në kuptim të nenit 13 të kontratës së lidhur. Si rezultat, punimet janë ekzekutuar me 4 ditë vonesë dhe në këtë rast duhej të ekzekutohej neni 15 i kontratës *“Penalitet”*. Vlera përfundimtare e punimeve është 1,683,526 lekë. Referuar nenit 15 të



kontratës së lidhur, operatorit ekonomik “N” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti për vonesa në ekzekutimin e kontratës në vlerën e kalkuluar sipas formulës $1,683,526 \text{ lekë} \times 4/1000 \times 4$ ditë vonesë ose 269,365 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.77, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **269,365 lekë**, nga “N” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve ligjore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës me nr.550 Prot., datë 22.07.2019 dhe objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”, u konstatua se nga “N” SHPK, nuk është ekzekutuar zëri nr.28, An 2.404/1, “Bojë hidroplastike importi, cilësia e I-rë” me vlerë 361,680 lekë me TVSH. Si rezultat, vlera totale e punimeve të pa kryera është 361,680 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.77, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **361,680 lekë**, nga “N” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga OE.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Kabinë elektrike 20 kV”, datë 21.06.2019 të lidhur midis “A&P” SHPK dhe SHA Porti Detar Sarandë, u konstatua se: Afati i ekzekutimit të punimeve, është 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Nga auditimi në terren i punimeve të kryera, u konstatua se kablli i aluminit AL 20 kV x 240/25mm iz.XLPE, ishte më i shkurtër se gjatësia e deklaruar në situacionin përfundimtar. Nga matja e distancës midis kabinës së montuar brenda ambienteve të Portit Detar SHA Sarandë dhe kabinës së OSHEE të vendosur mbi zonën e Portit, rezultoi se kishte një diferencë 90 metra më tepër të deklaruar në situacionin përfundimtar. E matur në fakt dhe me google-map, distanca është 150 metra linear. Në total janë shtrirë: 150 ml (kabëll) x 5 (kabllo)=750 ml Kabëll AL 20 kV 1x240/25mm² iz.XLPE dhe jo 840 metra sa deklarohet në situacionin përfundimtar. Si rezultat janë deklaruar 90 metra kabëll më shumë ose në vlerë 90 metra kabëll x 990 lekë/metri = 106,920 lekë me TVSH të deklaruar më shumë në situacionin përfundimtar. Edhe për punëtorinë, janë deklaruar të njëjtat metra me çmim 90 lekë shtrimi i 1 metri linear. Si rezultat 90 metra shtrim * 90 lekë/metri = 9720 lekë me TVSH. Në total, vlera e faturuar më tepër në situacionin përfundimtar dhe që duhet të dëmshpërblehet nga OE “A&P” SHPK, është 116,640 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.83, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **116,640 lekë**, nga “A&P” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga OE.

Menjëherë



4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve me objekt “Ndërtimi i tualeteve në kalatë” sipas kontratës me datë 17.02.2020, të lidhur midis OE “A&P” SHPK dhe Portit Detar SHA Sarandë, u konstatuan mangësi në zëra punimesh dhe konkretisht:

-Punime ndërtimi:

1. Nr. 24, An 2.404/1, Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë, në vlerën 73.905 lekë pa TVSH.
2. Nr. 28, An 2.209, Ulluk shkarkimi me llamarinë xingat në vlerën 1.701 lekë pa TVSH.

-Punime elektrike:

3. Nr. 16, An 2.a-133, Ndriçues elektrik tavanor 1x 18 W, copë 5, në vlerën 7.250 lekë pa TVSH.
4. Nr. 22, An, Zëri F.V Aparat matës për EE, elektronik i përdorshëm me kartë në vlerën 150,000 lekë pa TVSH.
5. Nr. 23, An, Zëri Aparat matës për ujin elektronik i përdorshëm me kartë (përfshi lexuesin elektronik) në vlerën 105,000 lekë pa TVSH. Vlera totale e punimeve të pa kryera, është 405,427.2 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.73, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **405,427 lekë**, nga “A&P” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga OE.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, është larguar nga puna z. G.XH, me detyrë prerës biletash ky punonjës ka hapur proces gjyqësor për të cilin është marrë 1 vendim i formës së prerë në vitin 2019, për dëmshpërblim në shumën **556,300 lekë**, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar për shoqërinë, në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.43, pika 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës i SHA Portit Detar Sarandë, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve nga Strukturat Drejtuese.

Menjëherë

1.2.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nga shoqëria janë paguar ne 2 raste gjoba ndaj tatim Taksave në shumën 25,000 lekë, për deklarim të vonuar të vendimit të ortakëve dhe deklarime në QKB, në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.84, pika 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



2.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Sektori i Financës, të marrin masa për të deklaruar brenda afateve ligjore detyrimet në QKB, Tatime, etj, me qëllim eliminimin e gjobave në të ardhmen.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transfertave të kryera nëpërmjet bankës nga SHA “Porti Detar” Sarandë, u konstatua se nëpërmjet bankës “C”, janë kryer 3 (tre) transferta, në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër, në shumën 13,544,581 lekë. Shuma e mësipërme është likuiduar bazuar në 3 (tre) vendime të Asamblesë, si më poshtë:

a) Vendimi i Asamblesë nr.49, datë 19.06.2019 “Për kalim fondi” ku është vendosur kalimi i fondit 1,778,079 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” Sarandë në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore proporcionalisht për 6 punonjës.

b) Vendimi i Asamblesë nr.62, datë 30.07.2019 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 9,766,502 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” Sarandë në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për përballimin e detyrimeve sipas shkresës nr.31, datë 23.07.2017 të Administratores së shoqërisë.

c) Vendimi i Asamblesë nr.3, datë 09.01.2020 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 2,000,000 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” Sarandë në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore deri në muajin Mars 2020.

Referuar Vendimeve të Asamblesë, nga Drejtoria e SHA “Porti Detar” Sarandë, janë nxjerrë Urdhrat e Brendshëm nr.64, datë 24.06.2019, nr.82, datë 08.08.2019 dhe nr.2, datë 14.01.2020 për kalimin e fondit sipas vendimeve të Asamblesë. Në vendimet e Asamblesë citohet baza ligjore neni 102, pika 4, Kushtetuta e Shqipërisë dhe Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Porti Detar” Sarandë dhe aksionarit mazhoritar të shoqërisë “D.C” Shkodër.

Transferimi i shumës në favor të shoqërisë “D.C” Shkodër (në proces likuidimi), është kryer në kundërshtim me Kreun I “Asambleja e Përgjithshme” neni 135, pika 4, të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statutin e shoqërisë, miratuar në 15.06.2012, Kreu III “Asambleja e Përgjithshme”, neni 11 “Të drejtat dhe detyrimet”, në të cilat nuk ka të përcaktuar transferim fondesh për shpenzime, duke mos marrë në analizë situatën ekonomike të SHA “Porti Detar” Sarandë, e cila në vitet 2020-2021 ka paraqitur vështirësi financiare. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.52, pika 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të kërkojnë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar), kthimin në llogari të SHA “Porti Detar” Sarandë, të shumës **13,544,581 lekë**, shumë kjo e miratuar në mënyrë të kundraligjshme nga Aksionari Mazhoritar dhe përfituar padrejtësisht nga shoqëria “D.C” Shkodër në vitin 2020, për të likuiduar detyrimet e pagave ndaj punonjësve të saj.

Menjëherë

3.2.Rekomandim: Ministria e Financave, në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar të SHA “Porti Detar” Sarandë, Drejtoria e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave, të marrë masat të nxjerrë përgjegjësitë, lidhur me efektin financiar negativ të krijuar në buxhetin e SHA “Porti Detar” Sarandë, në shumën **13,544,581 lekë**, të konstatuar nga KLSH si pasojë e 3 vendimeve



të kundraligjshme, të marra nga Asambleja e SHA “Porti Detar” Sarandë, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike.

Menjëherë

3.3.Rekomandim: Ministria e Financave, Drejtoria e Inspektimit Financiar, të ushtrojë kontroll në shoqërinë “D.C” Shkodër, mbi destinacionin e përdorimit të fondit **13,544,581 lekë** dhe përfituesve duke bërë me dije Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi rezultatet e kontrollit nga Drejtoria e Inspektimit Financiar. Gjithashtu, të përcillet në KLSH, edhe lista emërore e përfituesve si dhe pozicionet e tyre përkatëse, në shoqërinë “D.C” Shkodër.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje materiale të nevojshme për mbrojtje personale dhe higjieno-sanitare për mbrojtje nga Covid-19*” zhvilluar në vitin 2020, me vlerë kontrate 4,920,000 lekë me TVSH, u konstatua se sasi të materialeve për mbrojtjen personale anti Covid, nuk ishin nxjerrë në bazë të nevojave reale të Shoqërisë. Konkretisht, janë kërkuar 5000 copë Maska të thjeshta kirurgjikale, 2500 copë Maska mbrojtëse Kn95 FFP2 dhe 11000 copë Doreza mbrojtëse. Sasi të mësipërme janë të ekzagjeruara krahasuar me nevojat e një stafi të reduktuar por mbi të gjitha edhe për arsye të mos kryerjes së aktivitetit të transportit detar për shkak të situatës të shkaktuar nga Covid-19. Vlera prej 2,925,600 lekë me TVSH që korrespondon me vlerën e materialeve të mësipërme, konsiderohet si vlerë e investuar në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës së fondeve publike. Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit, nuk u konstatua dokumentacioni i plotë lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit të procedurës. Përlllogaritja e vlerës së fondit limit për procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm nuk i referohet mesatares së 3 (tre) ofertave të marra nga tregu por njësisia e prokurimit është bazuar për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, vetëm tek 1 (një) ofertë ekonomike. (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.66, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masat që në të ardhmen në procedurat e prokurimit, njësisia e prokurimit ti referohet minimumi tre ofertave të tregut dhe në të njëjtën kohë, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja e sasive të mallrave që do të prokurohen, duke i krahasuar ato me të dhënat reale të Shoqërisë me qëllim shmangien e investimeve me pasoja negative financiare për shoqërinë.

Në vijimësi

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare (ISSAI 4100¹) (ISSAI 4200²). Nga auditimi i përputhshmërisë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet buxheti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në SHA “Porti Detar” Sarandë, gjatë auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në zbatimin e kontratave të punimeve me pasojë dëm ekonomik në shumën 1,153,112 lekë si dhe transferime fondesh nga aksionari mazhoritar në kundërshtim me Kreun I “Asambleja e Përgjithshme” neni 135 pika 4, të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statutin e shoqërisë, miratuar në



15.06.2012, Kreu III “Asambleja e Përgjithshme” neni 11 “Të drejtat dhe detyrimet”, ka sjellë si rezultat pasoja negative financiare për shoqërinë në shumën 13,544,581 lekë.

Si konkluzion, në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e SHA “Porti Detar” Sarandë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar për përputhshmërinë³**.

Baza për opinionin e përputhshmërisë:

SHA “Porti Detar” Sarandë, përveç mangësive të identifikuar dhe të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, sistemet e kontrollit dhe menaxhimit të brendshëm, nuk i ka implementuar në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara për vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërisë, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti SHA “Porti Detar” Sarandë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime në:

-Dëm ekonomik me vlerë 1,153,112.2 lekë në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave.

-Efekt negativ financiar me vlerë 17,051,481 lekë si pasojë e largimeve të paligjshme nga puna, apo detyrime të pa arkëtuara nga të tretët.

¹ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

²ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.

³Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet e tjera financiare.



V. ANEKSE

1. Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
KMb	Këshilli Mbikëqyrës
SHA	Shoqëri aksionare
Sh.p.k	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
AQT	Aktivitet e Qëndrueshme të Trupëzuara
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
TAP	Tatimi i të ardhurave nga punësimi
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktor
DT	Dokumentet e Tenderit

VI. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Akt Konstatimi nr. 1, datë 10.03.2023 “Mbi auditimin e pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimit me vlerë të vogël”.

Akt Konstatimi nr. 2, datë 10.03.2023 “Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar”

Akt Konstatimi nr. 3, datë 10.03.2023 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve”.

Akt Konstatimi nr. 4, datë 10.03.2023 “Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe evidentimin, ndjekjen e pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve”.

Akt Konstatimi nr. 5, datë 10.03.2023 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve dhe zbatimi i detyrimeve të ndërsjellta”.

Akt Konstatimi nr. 6, datë 10.03.2023 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për menaxhimin e aktiveve materiale, procedurat e ndjekura për inventarizimet, nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre”.

Akt-Konstatimi nr. 7, datë 10.03.2023 “Mbi auditimin e pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimit me vlerë të vogël”.

Akt-Konstatimi nr. 8, datë 10.03.2023 mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale dhe higjienosantare në zbatim të protokollit të përballimit të Covid-19”.

Akt-Konstatimi nr. 9, datë 10.03.2023 mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Zbatim i projektit për hyrjen e Portit Detar ShA Sarandë”.

Akt-Konstatimi nr. 10, datë 10.03.2023 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “PORTI DETAR” SARANDË

Akt-Konstatimi nr. 11, datë 10.03.2023 mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtimi i tualeteve në kalatë”.

Akt-Konstatimi nr. 12, datë 10.03.2023 mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”.

Akt-Konstatimi nr. 13, datë 10.03.2023 “Mbi auditimin e pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimit me vlerë të vogël”.

Akt-Verifikimi nr. 1, datë 10.03.2023 “Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm”.

Akt-Verifikimi nr. 2, datë 10.03.2023 mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Kabinë elektrike 20 kV”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

A.T

M.B

G.P

Q.M

J.B

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

R.XH